


Shkurt 2018
Numri: 119
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Pa dashur
njëri-tjetrin...

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Shkurt 2018

VITI: XII

NUMRI: 119

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër..." (Huxhurat, 10)

"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë." (Al Imran, 103)

"O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër!" "Të gjithë ju jeni fëmijët e Ademit. Ndërsa Ademi është prej dheut. Arabi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt atij që nuk është arab." (Muhamedi a.s.)

"Njerëzit ose janë vëllezër me ty në fe, ose në krijim." (Aliu r.a.)

Ah sikur ta kapnim për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)!.. Ai i bashkoi arabët dhe ata që nuk ishin arabë! Ai i bënte vëllezër njerëzit e zinj me njerëzit e verdhë. Ai i vëllazëronte edhe njerëzit e vendeve më të largëta...

Vëllazëria është emocioni për t'u kapur përsëri pas litarit të Allahut Teala të gjithë së bashku. Vëllazëria është që duart të zgjaten te litari i Allahut (xh.sh.). Vëllazëria është emocioni për t'u bashkuar nën Livau'l-hamdi (Flamuri nën të cilin do të mblidhet umeti i Muhamedit (a.s.), në Ditën e Gjykimit). Vëllazëria është përpjekja që të gjithë t'i paraqesin xhenetin njëri-tjetrit. Vëllazëria është aksioni për t'u ngopur te burimi i Kuranit Fisnik të gjithë së bashku. Çfarë mund të jenë tjetër myslimanët përveçse vëllezër? Si mund të jetë dhimbja e një myslimani gëzim për një mysliman tjetër? Si të mos i dhembë zemra myslimanit, kur një mysliman tjetër ndjen dhimbje? Si mund ta lënë pa përgjigje myslimanët thirrjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili thotë: "O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër!" Nëse kjo thirrje ka ngelur pa përgjigje, atëherë si mund ta shohim në fytyrë Ditën e Gjykimit përgjatë tubimit të madh të Dërguarin e Allahut (a.s.)?

Atëherë, le t'i drejtohem Allahut Teala! Le të kapemi për litarin e Allahut (xh.sh.). Le ta kapim për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)! Le të pimë nga burimi i Kuranit Fisnik! Le të bëhemi të mëshirshëm! Le të bëhemi të dashur! Le t'i duam vëllezërit! Le ta shporrim urrejtjen nga jeta jonë! Le ta shporrim zemërimin! Le ta pastrojmë gjuhën nga përgojimi! Të mos i vrasim vëllezërit nga brenda! Të mos e përtpim mishin e vëllezërve tanë! Ja, e shikoni sa rëndë që na erdhi? Andaj të mos shajmë dhe ofendojmë! Të mos ua thyejmë dinjitetin të tjerëve! Të mos i përlyejmë duart me gjakun e asnjë besimtari, ndërkohë që nuk është e lejuar të lëndojmë qoftë edhe një milingonë!.. Si mund t'i derdhet gjaku njeriut? Si mund të vriten fëmijët? Si mund të nëpërkëmbet dinjiteti i njerëzve?

Le ta shikojmë një herë zemrën tonë! Allahu e ka bërë atë që ta dojë vëllain besimtar... A është akoma e tillë? A akoma mbart ndopak gjallëri nga mëshira dhe dashuria e Allahut? Mos vallë e ka zënë i ftohti i stinëve larg të Dërguarit të Allahut (a.s.)? Allahu Teala na e ka shpëtuar zemrën nga të shndërruarit e saj në një gropë zjarri. Prandaj, le ta shohim zemrën, mos vallë është shndërruar përsëri në gropë zjarri. Për këtë arsye, le të duam, le të falim dhe le të heqim dorë nga gjërat që nuk na duhen! Kjo botë nuk është e përhershme. Andaj, le të mbetet dashuria dhe vëllazëria për botën e përhershme!

Përmbajtja



10

Hape zemrën
Dr. Adem Ergyl



34


Shkolla e Universit
Osman Nuri Topbash




22

42

Shpreso për më të mirën, përgatitu për më të keqen
Nuredin Nazarko



- 5 Apel për t'u vëllazëruar
Ahmet Tashgetiren
- 8 Vëllazëria është kaderi ynë
Nuredin Jëlldëz
- 13 Besimtarët janë si një trup i vetëm
M. Sami Ramazanollu
- 17 Ata që e duan njëri-tjetrin
Sadik Dana
- 18 Veprimet që çënojnë vëllazërinë
Dr. Mustafa Karabaxhak
- 20 Teuhidi
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 22 Admirali Osman Murat Reis Shqiptari
Dr. Ardian Muhaj
- 24 Pyetja pa përgjigje
Xhafer Durmush



54

- Seleme Ibn Hishami 26
Mustafa Erish
- Populli i Lutit dhe homoseksualiteti 28
Xhihan Tashtan
- Hëna, pjesë e jona 29
Muaz Erdem
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32
- El-Uehhab 40
Ilir Hoxha
- Njeriu që ëndërron për Mekën e vjetër 46
Basma Attasi
- Urtësi 49
- Falënderoje Allahun 50
Ferid Piku
- Fëmijët kuptojnë 54
Betyl Balltaxhë



44
Çdo ide kërkon të bëhet sistem, sistemi
kërkon planifikim dhe pastaj rënia
Edison Çeraj

Mirë se erdhe e dashur bebe
Dr. Fatma Bajraktar Karahan

56

Apel për t'u vëllazëruar

— Ahmet Tashgetiren —

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...” (Huxhurat, 10)

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu ju shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Al Imran, 103)

“O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër!” “Të gjithë ju jeni fëmi-

jët e Ademit. Ndërsa Ademi është prej dheut. Arabi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt atij që nuk është arab.” (Muhamedi a.s.)

“Njerëzit ose janë vëllezër me ty në fe, ose në krijim.” (Aliu r.a.)

Ah sikur ta kapnim për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)!.. Ai i bashkoi arabët dhe ata që nuk ishin arabë! Ai i bënte vëllezër njerëzit e zinj me njerëzit e verdhë. Ai i vëllazëronte edhe njerëzit e vendeve më të largëta...

Vëllazëria është emocioni për t'u kapur përsëri pas litarit të Allahut Teala të gjithë së bashku. Vëllazëria është që duart të zgjaten te litari i Allahut (xh. sh.). Vëllazëria është emocioni për t'u bashkuar nën Livau'l-hamdi (Flamuri nën të cilin do të mblidhet umeti i Muhamedit (a.s.), në Ditën e Gjykimit). Vëllazëria është përpjekja që të gjithë t'i paraqesin xhenetin njëri-tjetrit. Vëllazëria është aksioni për t'u ngopur te burimi i Kuranit Fisnik të gjithë së bashku. Çfarë mund të jenë tjetër myslimanët përveçse vëllezër? Si mund të jetë dhimbja e një myslimani gëzim për një mysliman tjetër? Si të mos i dhe mbë zemra myslimanit, kur një mysliman tjetër ndjen dhimbje? Si mund ta lënë pa përgjigje myslimanët thirrjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili thotë: “O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër!” Nëse kjo thirrje ka ngelur pa përgjigje, atëherë si mund ta shohim në fytyrë Ditën e Gjykimit përgjatë tubimit të madh të Dërguarin e Allahut (a.s.)?

Atëherë, le t'i drejtohem Allahut Teala! Le të kapemi për litarin e Allahut (xh.sh.). Le ta kapim për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)! Le të pimë nga burimi i Kuranit Fisnik! Le të bëhemi të mëshirshëm! Le të bëhemi të dashur! Le t'i duam vëllezërit! Le ta shporrim urrejtjen nga jeta jonë! Le ta shporrim zemërimin! Le ta pastrojmë gjuhën nga përgojimi! Të mos i vrasim vëllezërit nga brenda! Të mos e përtpim mishin e vëllezërve tanë! Ja, e shikoni sa rëndë që na erdhi? Andaj të mos shajmë dhe ofendojmë! Të mos ua thyejmë dinjitetin të tjerëve! Të mos i përlyejmë duart me gjakun e asnjë besimtari,




ndërkohë që nuk është e lejuar të lëndojmë qoftë edhe një milingonë!.. Si mund t'i derdhet gjaku njeriut? Si mund të vriten fëmijët? Si mund të nëpërkëmbet dinjiteti i njerëzve?

Le ta shikojmë një herë zemrën tonë! Allahu e ka bërë atë që ta dojë vëllain besimtar... A është akoma e tillë? A akoma mbart ndopak gjallëri nga mëshira dhe dashuria e Allahut? Mos vallë e ka zënë i ftohti i stinëve larg të Dërguarit të Allahut (a.s.)? Allahu Teala na e ka shpëtuar zemrën nga të shndërruarit e saj në një gropë zjarri. Prandaj, le ta shohim zemrën, mos vallë është shndërruar përsëri në gropë zjarri. Për këtë arsye, le të duam, le të falim dhe le të heqim dorë nga gjërat që nuk na duhen! Kjo botë nuk është e përhershme. Andaj, le të mbetet dashuria dhe vëllazëria për botën e përhershme!

Ah sikur t'i kishte prekur i Dërguari i Allahut (a.s.), të gjitha zemrat një nga një! Ah sikur të frynte flladi i Muhamedit (a.s.), në horizontet e lindjes dhe perëndimit! Ah sikur ta rrethonte të gjithë gjeografi-

Vëllazëria është çështje ligjesh. Këto ligje i ka vendosur Allahu (xh. sh.). Me këto ligje ka jetuar edhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Ne jemi umeti i një Pejgamberi që i ka dashur edhe malet e gurët, që ka dashur Uhudin dhe që ka puthur Haxheru'l-Esvedin / Gurin e Zi dhe që i ka mbrojtur pemët, lulet, zogjtë dhe insektet e Haremit.



në islame zemra e Rasulull-llahut! Madje, të gjithë universin dhe të gjitha zemrat e njerëzve!.. Në këtë mënyrë do të ndërtohej civilizimi i dashurisë në të gjithë universin.

Për këtë arsye, le të mërdhimë bashkë me ata që mërdhijnë! Le të digjemi me ata që digjen! Le të kemi uri bashkë me ata që kanë uri! Le t'i ndajmë dhimbjet, në mënyrë që të pakësohen! Le t'i ndajmë gëzimet, në mënyrë që të shtohen! Le të mbartim mirësi kudo që të shkojmë! Le të bëhemi mëshirë në çdo vend ku të gjendemi! Le të mos mashtrujmë asnjë! Le t'ia dimë vlerën vëllazërisë, nëse jemi vëllezër!

Vëllazëria është çështje ligjesh. Këto ligje i ka vendosur Allahu (xh.sh.). Me këto ligje ka jetuar edhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Ne jemi umeti i një Pejgamberi që i ka dashur edhe malet e gurët, që ka dashur Uhudin dhe që ka puthur Haxheru'l-Esvedin / Gurin e Zi dhe që i ka mbrojtur pemët, lulet, zogjtë dhe insektet e Haremit. Përpara kemi Pejgamberin e mëshirës. Ne jemi në gjurmët e një zemre sublime që i pranoi për vëllezër edhe ata që i vranë më të afërmit dhe që i shkulën mushkëritë xhaxhait të tij... Prandaj, le ta përshtatim zemrën me zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.)!..

Le të mos e shenjtërojmë fisin tonë! Le të mos e shenjtërojmë racën tonë! Le të mos e shenjtërojmë ngjyrën tonë! Le të mos i shenjtërojmë fëmijët, pasurinë dhe pronën tonë!

Arabi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt atij që nuk është arab. Epërsia është vetëm në devotshmëri ndaj Allahut Teala. Epërsia është në humanizëm. Për këtë arsye, le të mos e vendosim pushtetin e kësaj bote para vëllazërisë! Le të mos rrahim, të mos ofendojmë dhe të mos shajmë! Le ta frenojmë zemërimin! Le të mos e ndyjmë zemrën me urrejtje! Le të mos bëjmë padrejtësi! Le ta lëmë smirën! Le ta lëmë mendjemadhësinë! Le të mos përçmojmë dhe ulim askënd! Le të mos luajmë me të drejtat e vëllezërve qoftë edhe me shenjat e syve apo të vetullave! Le ta lëmë xhelozinë! Le ta lëmë armiqësinë e mërinë! Le të mos debatojmë me askënd! Kurrë të mos shpifim! Le të mos e cenojmë pasurinë, jetën dhe nderin e asnjë njeriu! Le t'i mbrojmë duart dhe gojën tonë! Të mos e lejojmë nefsën që të shkelë dinjitetin e asnjë njeriu! Të mos e lëndojmë dinjitetin e ndonjë shoqërie apo populli!

A mund t'ia marrim hallallëkun një populli të madh? A mund ta paguajmë borxhin e një populli? Çfarë do të ndodhë nëse një shoqëri e madhe do të na kapë për fyti Ditën e Mahsherit?.. Cilën urrejtje, cilin zemërim, cilën gënjeshtëri, cilën shpifje apo cilin përgojim mund ta justifikojmë në audiencën e

Zotit (xh.sh.)? Thoni pra, cilën? Le ta pyesim veten se cilën prej këtyre mund ta justifikojmë! Andaj, le t'i futemi punës dhe ta rregullojmë përsëri gjendjen e zemrës! Le t'i drejtohem Allahut Teala! Le të kapemi për litarin e Allahut! Aty le të na bashkohen duart me miliarda duar të tjera! Le t'i shikojmë duart tona se me cilat duar janë takuar dhe se cilin litar kanë kapur!

Le të lutemi siç na ka mësuar Krijuesi! Le ta pastrojmë zemrën nga urrejtja kundrejt vëllezërve tanë dhe le të kërkojmë falje për ta! Le ta shkulum nga zemra zemërimin, urrejtjen dhe smirën! Le ta hedhim mërinë! Le të duam për hir të Allahut! Le t'u themi vëllezërve se i duam! Le të lutemi për vëllezërit! Le t'i lutemi dhe t'i përgjerohem Zotit duke thënë: "O Zoti ynë! "Mos lër urrejtje në zemrat tona kundrejt vëllezërve tanë!" Le të shpëtojmë nga vrasja e vëllezërve brenda nesh dhe nga përtyppja e mishit të tyre në gojën tonë! Le të jemi të mëshirshëm kundrejt vëllezërve! Le t'i kërkojmë falje Zotit për

ata! Le t'i ndihmojmë ata për t'u pastruar! Le t'i mbartim vëllezërit në zemrën tonë me gjendjen më të pastër të tyre! Le ta ndiejmë dhimbjen e tyre në zemrën tonë!

Le të bashkohemi me ata në atë mënyrë, sa që të formohet një memorial vëllazërie në shkallë universale! Le ta përzëmë shejtanin, le ta frenojmë nefsën dhe le ta lëmë vetëm zemrën që të flasë! Gjithmonë le të flasim me zemër! Atëherë do të shikojmë se si do të shndërrohet kjo botë në një parajsë. Prandaj, le ta kapim për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)!

Le ta përrjetojmë vëllazërinë! Le ta përrjetojmë vëllazërinë! Le ta përrjetojmë vëllazërinë!



Xhemal Nar

Një metodë në njohjen e dijes dhe dijetarit



Myslmanët kanë probleme të mëdha në sistemet që nuk përputhen me Islamin. Njëri prej këtyre problemeve është çështja e dijes dhe dijetarit. Kjo është një çështje e rëndësishme dhe e vështirë për t'u kuptuar. Sistemi me të cilin udhëhiqemi për momentin e ka ndaluar edukimin fetar, ngaqë nuk e do dhe e konsideron si të rrezikshëm mësimin e mirë dhe praktikimin e Islamit. Kjo është një tradhti që bëhet me vetëdije. Kështu që i ka dhënë edhe pasojat e tij të këqija.

Ndërkohë që flasim për këtë, aq sa është e rëndësishme të gjejmë gabimet, është e rëndësishme që të gjejmë edhe gjërat e drejta. Sigurisht që ka edhe dijetarë që e kanë edukuar veten dhe që ia tregojnë rrugën umetit. Mbi të gjitha, ne kemi shumë nevojë për ata. Aman kini kujdes! Ndërkohë që i akuzojmë dijetarët që bëjnë dëme, këtë të mos e bëjmë në mënyrë të përgjithshme. Domethënë, të mos i fusim të gjithë në një thes. Përsëri kini kujdes! Gjetja e gabimit është shumë e lehtë. Ndërsa gjetja e të drejtës është shumë e vështirë. Veçanërisht ajo metoda e përcëmimit të dijetarëve duke shfrytëzuar gjendjen e dobët të myslimanëve dhe

duke i vrarë ata të gjithë me një goditje shpate, është shumë e rrezikshme. Në të kaluarën këtë e bënin qafirët perëndimorë të cilët ishin armiq të fesë dhe sheriatit. Ndërsa tani po e bëjnë edhe të rinjtë që emocionohen pasi lexojnë dy-tri libra. Të gjithë i presin dhe i masakrojnë. Për këtë arsye, them: "More, a të gjithë dijetarët e botës islame janë të devijuar?" Sa mohim dhe përcëmim i lig që është ky! Ky është shndërruar në një problem të madh për fat të keq.

A është e mundur të jetosh në këtë vend dhe të mos e shohësh këtë problem? Nëse është kështu, atëherë çfarë duhet të bëjmë?

Sipas mendimit tim, së pari, nëse e njohim gjuhën arabe, duhet të përpiqemi ta lexojmë dhe ta mësojmë Islamin prej veprave klasike që janë shkruar në fillimet e Islamit. Pastaj duhet t'i lexojmë edhe veprat moderne, në mënyrë që të përfitojmë edhe nga dija e shekullit tonë dhe pastaj t'i krahasojmë. Në këtë mënyrë, do të jemi të hapur ndaj gjërave të reja e të dobishme. Nëse nuk e njohim gjuhën arabe, duhet të marrim për udhërrëfyes dijetarët të cilëve u besojmë. Ndërsa këta të rinjtë do t'i testojmë nëse bien apo jo ndesh me ata. Dijetarët e rinj dhe zhvillimet e reja që nuk bien ndesh me dijetarët e vjetër dhe zhvillimet në të kaluarën, duhet t'ia shtojmë trungut tonë të dijes. Në këtë mënyrë, do ta bashkojmë të kaluarën me të tashmen dhe do të arrijmë zhvillime më premtuese.

Për shembull, Omer Nasuhi Bilmen është një dijetar që mund të merret si udhërrëfyes në akaid, kelam, fikh dhe tefsir. Ndoshta këtë periudhë të mbushur plot me furtuna, mund ta kalojmë me një metodë të tillë.

Vëllazëria ËSHTË KADERI YNË

— Nuredin Jëlldëz —

Atë që Zoti (xh.sh.), e ka shkruar për ne dhe nuk ndryshon e quajmë kader. Në këtë botë kemi lindur dhe marrim frymë me të. Çdo gjë që hamë, pimë, shikojmë, ndjejmë, mendojmë dhe bëjmë është shfaqja e atij kaderi.

Kaderi për ne është çështje besimi. Ne besojmë se Allahu Teala me emrin e Tij el-Hakim ka shkruar kaderin e çdo gjëje. Çdo krijesë, duke filluar nga njeriu e deri te ndonjë gur çakëlli, ekziston me atë kader dhe e vazhdon ekzistencën e tij duke iu dorëzuar atij kaderi. Askush

nuk bën, nuk mund të bëjë në fakt, ndonjë gjë jashtë kaderit që ka shkruar Allahu Teala. Kur ne i besojmë kaderit bëhemi besimtarë. Për këtë arsye, nënshtrimi që shfaqim ndaj kaderit që na ka shkruar Zoti (xh.sh.), nuk është një nënshtrim i verbër. Ne i dorëzohemi kaderit dhe shpresojmë që të kemi fund të mirë. Gjithashtu shqetësohemi edhe për të ardhmen e atyre që kanë mangësi në nënshtrimin ndaj kaderit.

Kur dhe ku do të takohemi me jetën? Ku do të marrë fund jeta jonë? Këto dhe pyetje të tjera të ngjashme me to janë prej çështjeve më të njohura të kaderit. Fakti që Muhamedi (a.s.), është pejgamberi ynë, është një çështje kaderi. Edhe kaderi i umetit të Musait (a.s.), ishte që t'i besonin atij. Të gjithë e gjejnë kaderin e tyre ose kaderi i gjen të gjithë. Ne kështu besojmë.

Nëse kaderi është emri i fatit të pandryshueshëm që Zoti (xh.sh.), ka shkruar për ne, që në të vërtetë ashtu është, edhe njëra prej gjërave që është kaderi ynë është e vërteta se ne jemi vëllazër me të gjithë bijtë e Ademit që janë bërë besimtarë duke e thënë shehadetin si ne. Ky është

Muslimanët duhet të bëhen vëllazër duke i lënë pas të gjitha ndryshimet njerëzore e etnike. Ky është një urdhër i Kuranit siç është edhe urdhri për të shkruar në xhami për namazin e mëngjesit.




vullneti i Allahut Teala. Allahu Teala urdhëron që njerëzit, edhe pse mund t'i kenë të ndryshëm prindërit e ngjyrat e lëkurës, të bëhen vëllezër nën çatinë e besimit. Vullneti i Allahut është kaderi ynë. Siç ka dëshiruar të na krijojë me ngjyra të ndryshme lëkure, ka dëshiruar që edhe besimi të na bashkojë krahas këtyre ngjyrave të ndryshme. Ky në të njëjtën kohë është limiti i çadrës gjithëpërfshirëse të Islamit të cilin na e ka zgjedhur për fe.

Myslmanët duhet të bëhen vëllezër duke i lënë pas të gjitha ndryshimet njerëzore e etnike. Ky është një urdhër i Kuranit siç është edhe urdhri për të shkuar në xhami për namazin e mëngjesit. Cilëtdo qofshin argumentet ku bazohet matja e të qenët mysliman me shkuarjen në xhami, të njëjtat argumente mbështetet edhe aplikimi i vëllazërisë së myslimanit me myslimanin si një praktikë e Islamit. Ajetet e Kuranit Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), që urdhërojnë namazin, agjërimin dhe haxhin, urdhërojnë edhe vëllazërinë. Edhe ndërmjet fjalive të hytbes së lamtumirës gjenden detaje që e përforcojnë këtë vëllazëri.

Edhe pse vëllazëria dhe gjërat që kërkon ajo janë ngushtuar në ndjenja që mund të qëndrojnë të fshehta në zemër ndërkohë që ibadetit të namazit i kanë dhënë shumë forma që mund të preken edhe me dorë dhe mund të filmohen me kamera duke filluar që nga sixhadeja e deri te sexhdja, prapë se prapë vëllazërinë nuk do ta bëjnë dot një pjesë të besimit dhe të vërtetës së Islamit prej të cilës mund të heqim dorë. Për shembull, edhe kaderi nuk është një urdhër që mund të preket me dorë si namazi, por ai formon më të paktën një të gjashtë të besimit tonë. Meqë Allahu është Ai që urdhëron, ne nuk kemi të drejtë t'i kushtojmë vëmendje madhësisë fizike/materiale. Aq sa duhet t'i mbushim xhamitë me qëllim për të falur namazin, po aq jemi të detyruar t'i mbushim edhe zemrat me ndjenjën e vëllazërisë. Ky është një urdhër i besimit tonë. Kur ta bëjmë këtë, duhet ta bëjmë pa marrë parasysh dallimet tona etnike. Ne nuk duhet të na bashkojnë nën atë apo tokat, por besimi. Ky është dallimi i të qenët besimtar. Rreziku që formohet nga zbrazja e xhamive duhet të na frikësojë njëllë sa rreziku që formohet nga humbja e ndjenjave të vëllazërisë prej zemrave tona.

Ne si besimtarë nuk mund të bëjmë diferencime



*Aq sa duhet
t'i mbushim xhamitë
me qëllim për të falur namazin,
po aq jemi të detyruar t'i
mbushim edhe zemrat me
ndjenjën e vëllazërisë.*

në vëllazëri nisur nga gabimet e njëri-tjetrit siç nuk mund ta pranojmë gjendjen etnike si faktor ndikues. Logjika themelore e vëllazërisë është e formuar mbi besimin. Përderisa besimi të mos jetë i zhdukur tërësisht, nuk mund të zhduket dhe nuk mund të pranohet si e tillë edhe vëllazëria jonë që është e bazuar te besimi.

Islami që i Dërguari i Allahut, (a.s.), e shfaqti në Medine, është një Islam i tillë. Aq sa e brengosin xhamitë e trishtuara në ditët e sotme cilindo besimtar, po aq duhet ta brengosë edhe tabloja e dy besimtarëve që nuk e kanë konsoliduar dot vëllazërinë ndërmjet tyre, sepse Islami është feja e atyre njerëzve që kanë ndjenja në zemër. Ne si besimtarë që e kemi humbur ndjesinë shpirtërore, vazhdimisht e zgjasim rrugën për të arritur te kënaqësia e Allahut Teala.

Kaderi për të cilin na ka urdhëruar Allahu është që të bëhemi vëllezër. Kjo vëllazëri nuk duhet të jetë në fjalë apo letra, por në praktikë. Tashmë duhet të bëjmë projekte të mëdha për vëllazërimin e grupeve siç bëjmë projekte për të ndërtuar xhami madhështore. Dhe këtë duhet ta konsiderojmë si pjesë të fesë.

Hape zemrën

DHE SHTOJE DASHURINË

— Dr. Adem Ergyl —

Ekzistenca e besimit së pari fillon në zemër. Ajo qëndron mbi bazën e dashurisë.¹ Dashuria ndaj Allahut Teala është qendra e kësaj pune. Të gjitha përkatësitë në lidhje me këtë dashuri qëndrore marrin pjesë nga kjo dashuri hallkë pas hallke. Çdo vlerë që i atribuohet atij si i Dërguari i Allahut, Libri i Allahut, Shtëpia e Allahut, evliatë e Allahut, robërit e Allahut etj., ka një vend në botën e dashurisë së besimtarit. Për këtë arsye, njëra prej shenjave më të rëndësishme të hyrjes së besimit nëpër zemra, siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), është “dashuria ndaj vëllezërve

1. Surja Huxhurat, 7.

besimtarë”.² Përderisa besimi të reflektojë nga fjalët në zemër dhe në vepra, kryen një funksion që e pjek personalitetin dhe zgjeron zemrën.

Zoti (xh.sh.), e lidh me besimin dashurinë, vëllazërinë dhe paqen ndërmjet besimtarëve. Në këto deklarata të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), hyrja në Xhenet është lidhur me besimin. Ndërsa sinqeriteti dhe përsosmëria e besimit është lidhur me kushtin e dashurisë ndaj vëllezërve besimtarë:

“Betohem në Allahun, i Cili e ka në dorë shpirtin tim, se nuk do të hyni në Xhenet derisa të besoni. Përderisa të mos e doni njëri-tjetrin nuk do të besoni. A t’ju tregoj për diçka që nëse e bëni do ta doni njëri-tjetrin? Përhapeni selamin ndërmjet jush!” (Muslim, Iman, 93-94. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Et’ime, 45, Kiamet 56.)

Ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut

2. Muslim, Iman, 93-93. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Et’ime 45, Kiamet 56.



Teala, Ditën e Gjykimit do të jenë njëri prej shtatë grupeve që do të qëndrojnë nën hijen e Arshit të Zotit (xh.sh.). Nëse çështjen e shohim nga ky aspekt, në të vërtetë kuptohet se ky qëllim ka një shkallë të lartë,³ sepse kjo pjekuri, për të cilën premtohet një shpërblim i barabartë me shpërblimin që do të marrë një kryetar shteti i drejtë, sigurisht se nuk është një shkallë që mund të arrihet lehtë. Kjo gjendje kërkon pajisjen me virtytet si durimi, vendosmëria, modestia, flijimi, besa, falja dhe mbulimi i gabimeve.

Edhe pse farat e para të dashurisë që besimtarët ndjejnë kundrejt njëri-tjetrit hidhen me besimin, këto fara kanë nevojë për shërbimin e të zotit dhe mëshirën e ndihmën e Allahut Teala, në mënyrë që të mbrohen, të rriten dhe të japin frytet e tyre.

Besimi është një pikë mëshire hyjnore që bie në zemër, në mënyrë që të fillojë procesi i pjekjes së njeriut. Shndërrimi i kësaj pike në oqean dhe reflektimi i saj në çdo qelizë të trupit dhe në jetë mund të realizohet me vepra të mira, sjellje të bukura, virtyte morale dhe mirësi hyjnore. Ndërmjet besimtarit të thjeshtë dhe besimtarit të përsosur sigurisht që ka një ndryshim të madh. Ja pra, dashuria e besimtarëve kundrejt njëri-tjetrit për hir të Allahut Teala është njëri prej shkaqeve më të rëndësishëm për përsosjen e besimit.

Nisur nga këto që thamë, shtimi dhe rritja e dashurisë janë detyrë e besimit. Hallka e dashurisë duhet të rritet aq shumë sa që duhet të përfshijë tokën dhe qiellin, përveç armiqtë të Allahut Teala. Kjo dashuri nuk duhet të përfshijë vetëm llojin tonë, por duhet të përfshijë të gjitha krijesat. Ne në këtë shkrim do të përpiqemi të shtjellojmë çështjen se si mund të mbrohet dhe përsoset fara e dashurisë ndaj besimtarëve që fillon me besimin.

Para së gjithash duhet të shërohen sëmundjet si pëlqimi i vetes, mendjemadhësia, smira, urrejtja, përgojimi dhe paragjykimi të cilat mund t'i quajmë pengesa më e madhe e dashurisë nëpër zemra, sepse, përderisa të gjenden në zemra këto pengesa që i radhitëm, do të thotë se nuk ka mundësi për shtimin e dashurisë. Të urtët kanë thënë: “Së pari duhet të pastrohen faktorët e prishjes, pastaj duhet të merren elementet e dobishme.” Ky është një rregull i rëndësishëm i sheriatit. Nisur nga këto, disiplina e përparimit

në mistikë të cilën mund ta shprehim në formën e “pastrimit të nefsit dhe dëlirjes së zemrës”, në të njëjtën kohë është edhe edukim për shtimin e dashurisë dhe për përsosmërinë e pjekurisë së vëllazërisë.

Urdhri i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për ta përhapur selamin të cilin na e ka dhënë me qëllim për të siguruar formimin, vazhdimësinë dhe zhvillimin e dashurisë ndërmjet besimtarëve, padyshim që është një sunnetullah i cili përfshin urtësi të pafundme. Me fjalë të tjera:

Të përhapësh selamin do të thotë të jesh një njeri që mund të të besohet. Domethënë, është një edukim personaliteti që i bën të tjerët të sigurt nga dora e gjuha jote, nga dëmi dhe humbja që mund t'u shkaktosh. Siguria, domethënë, besueshmëria është njëra prej kushteve të domosdoshme për formimin e dashurisë. Çdo lloj tradhtie e shuan zjarrin e dashurisë dhe i nxit ndjenjat e armiqësisë.

Përhapja e selamit është edhe të shprehurit se besimtarët e mbrojnë njëri-tjetrin, në mënyrë që të jetojnë në paqe. Mbrojtja e të tjerëve nga çdo lloj rreziku që dëmton dhe nxjerrja e vëllezërve në bregun e paqes, edhe e bën të vazhdueshme dashurinë, edhe e shton atë. Lënia vetëm e vëllait në kohë të vështirë, dorëzimi i tij te i padrejti dhe të mos i japësh ndihmë ndërkohë që ai ka nevojë për këtë të fundit, sigurisht që do të shkaktojë largimin e begatisë së dashurisë.

Përhapja e selamit është shtimi i dhënies së selamit në mënyrë të ndërsjellë. Me një thënie tjetër, do të thotë të jesh në gjendje komunikimi të vazhdueshëm dhe të mos i shkëpusësh marrëdhëniet. Dhënia e selamit në mënyrë të ndërsjellë është çelësi i miqësisë, domethënë, çelësi i formimit të marrëdhënieve ndërmjet nesh. Gjithashtu është edhe shenja e parë e respektit. Është simboli i vlerësimit të të tjerëve. Është shprehja më e bukur e ndjenjave pozitive që ndjen në zemër kundrejt vëllait tënd. Komunikimi me fjalë i takon sytë. Takimi i syve i takon duart dhe zemrat.

Pema e dashurisë që mbillet me besim dhe vadiet me përhapjen e selamit, duhet të vazhdojë të rritet duke e zbatuar këshillën e të Dashurit të Allahut (a.s.), i cili thotë: “*Jepini dhurata njëri-tjetrit, në mënyrë që t'ju shtohet dashuria ndërmjet jush.*”⁴ Nëse të gjithë e zbatojnë këtë sunet, sipas mundësive që kanë, pa marrë parasyshtë nëse

3. Muslim, Birr 37. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Zuhd, 53.

4. Muvatta, II, 908.

dhurata është e madhe apo e vogël, dashuria do të shtohet dhe me kalimin e kohës do të shndërrohet në oqean. Ai që nuk gjen dot asgjë për të dhuruar, duhet t'ia shprehë dashurinë vëllait të tij duke i thënë një fjalë të mirë apo duke i buzëqeshur ëmbëlsisht, në mënyrë që dashuria të shtohet dhe ndjenjat e këqija të largohen nga zemrat.

Edhe një vepër tjetër që e shton dashurinë ndërmjet besimtarëve është që ata ta vizitojnë njëri-tjetrin për hir të Allahut të Madhëruar. Begatia e vizitës është një ujë i mëshirës hyjnore që e zhvillon më shpejt se çdo gjë pemën e dashurisë. Madje ajo është një fuqi hyjnore që e tërheq dashurinë e Zotit (xh.sh.), drejt robit.

Është transmetuar se i Dërguari i Allahut, (a.s.) ka thënë: *“Një burrë mori rrugën për të vizituar vëllain e tij (në fe) që gjendej në një fshat tjetër. Allahu Teala urdhëroi një engjëll që ta kontrollonte atë në rrugë. Kur burri erdhi pranë engjëllit, engjëlli i tha: “Ku po shkon?” Burri iu përgjigj: “Në këtë fshatin matanë kam një vëlla besimtar. Kështu që po shkoj ta vizitoj.” Engjëlli e pyeti: “Mos ke ndonjë interes prej atij burri?” Burri i tha: “Jo, nuk kam. Unë e dua atë vetëm për hir të Allahut. Për këtë arsye po shkoj ta vizitoj.” Nisur nga kjo, engjëlli i tha: “Siç e do ti atë, ashtu të do edhe Allahu ty. Unë jam një i dërguar i Allahut Teala për të të dhënë këtë sihariq.” (Muslim, Birr, 38.)*

Njëri prej suneteve më të rëndësishëm që në ditët e sotme pothuajse e kemi harruar është suneti i vizitës. Gjallërimi i këtij suneti është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që umeti të bashkohet dhe të marrë begati. Fakti që dashamirësia, dashuria, madje edhe miqësia janë bërë sipërfaqësore, kohëshkurtra dhe kanë hyrë në një proces të mbështetur te interesi, do të thotë se ndërmjet nesh gjendet sëmundja e mospërfitimit nga këto burime të dashurisë.

Edhe një vepër tjetër që e shton dashurinë ndërmjet besimtarëve është fokusimi jo te gabimet e mangësitë e vëllait, por te virtytet dhe mirësitë e tij. Pra, të menduarit mirë për të tjerët dhe dhënia përparësi ndjenjave të vlerësimit. Mbi të gjitha,

ne duhet të arrijmë një pjekuri shpirtërore sa për ta kujtuar me mirësi vëllain besimtar edhe kur ai nuk është prezent. Ne nuk duhet t'i hyjmë rrugës për ta rritur veten duke përçmuar vëllain besimtar. Për këtë arsye, vëllain besimtar duhet ta pranojmë si pjesën tonë, të rritemi të gjithë së bashku dhe t'i besojmë begatisë së zhvillimit.

Virtyti për të qenë të bashkuar edhe në ditë të mira, edhe në ditë të këqija, i jep dashurisë një pjekuri që nuk e lë të shpërbëhet. Nëse solidarizohemi duke u bërë inkurajues dhe ndihmues në mirësi e devotshmëri dhe parandalues e pengues në ligësi e armiqësi, trupat e ndryshëm do t'i bashkojmë në një frymë.

Besnikëria, sinqeriteti dhe sakrifica janë virtytet më të rëndësishme që e forcojnë dashurinë. Këto janë virtyte të larta morale që shfaqen te njerëzit me personalitet.

Të gjitha këto vepra që i rradhitëm janë lutje të reflektuara në jetën reale të cilat bëhen në emër që Zoti (xh.sh.), i Cili është “el-Vedud”, domethënë “Ai që do shumë dhe që duhet shumë” si burimi i të gjitha dashurive, në një kuptim t'u japë dashuri zemrave tona. Nëse këtyre vepërave u shtohen edhe përgjërimet verbale dhe nëse kërkohet nga i Lartmadhërishtëmi që të na japë dashuri edhe për Të, edhe për robërit e dashur të Tij, padyshim se nuk do të kthehemi duarbosh.

Si përfundim mund të themi se ne kemi dashuri aq sa kemi besim. Shtimi i besimit shton edhe dashurinë. Shtimi i dashurisë e shton përsosmërinë e besimit. Gjithëpërfshirja në dashuri është e lidhur drejtpërsëdrejti me gjerësinë e zemrës. Besimi është një dritë hyjnore që e zgjeron zemrën. Ai që ka më shumë dritë, e ka edhe zemrën më të gjerë. Urrejtja dhe armiqësia në një zemër të tillë gjendet vetëm kundrejt armiqve të Allahut Teala. Njerëzit e tillë që në këtë botë ecin në atmosferën e xhenetit bashkë me vëllezërit e tyre besimtarë. Sepse vetëm zemrat që janë të pastruara nga urrejtja dhe mëria kundrejt njëra-tjetrës mund të vëllazërohen. Dhe vetëm njerëzit e tillë mund ta shijojnë kënaqësinë e besimit të tyre.



Njëri prej suneteve më të rëndësishëm që në ditët e sotme pothuajse e kemi harruar është suneti i vizitës. Gjallërimi i këtij suneti është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që umeti të bashkohet dhe të marrë begati.



Besimtarët janë si një trup i vetëm

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu Teala thotë në suren Huxhurat: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.”** (Huxhurat, 10) Me të vërtetë besimtarët janë të lidhur me një rrënjë dhe një baze. Kjo rrënjë dhe bazë është besimi që vërteton jetën e përhershme. Për këtë arsye, vëllazërinë tonë në fe le ta mbajmë duke e pasur frikë Allahun për sa i përket çështjes së mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të besimtarëve. Në një vend ku ka vëllazëri, ka edhe butësi e mëshirë.

Nëse një rob nuk dëshiron edhe për vëllezërit e tij besimtarë atë që dëshiron për vete, nuk konsiderohet se ka arritur përsosmërinë në besim. I Dërguari i Allahut, (a.s.), është shprehur në një hadith fisnik: **“Nuk ka besuar ai që nuk dëshiron edhe për vëllezërit e tij besimtarë atë që dëshiron për vete.”** Ndërsa në një hadith tjetër fisnik ka thënë: **“Dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut burojnë nga besimi.”**

Nisur nga këto që thamë më sipër, dhembshuria ndaj njëri-tjetrit, dashuria ndaj njëri-tjetrit, ndihma ndaj njëri-tjetrit, mbrojtja e të drejtave të Islamit dhe lartësimi i fesë së Muhamedit (a.s.), në pedestalin e duhur në një formë të përshtatshme me sheriatin është detyrë për të gjithë myslimanët. Nisur nga ky aspekt, të gjithë besimtarët janë si një njeri apo trup i vetëm.

Sa bukur që e ka shprehur i Dërguari i Allahut, (a.s.), këtë çështje në këto hadithe fisnike:

“Do të shohësh se besimtarët janë si një trup në dhembshurinë ndaj njëri-tjetrit, në dashurinë ndaj njëri-tjetrit dhe në butësinë ndaj njëri-tjetrit!.. Kur një gjymtyrë e këtij trupi të ndjejë dhimbje, edhe gjymtyrët e tjera nuk flenë dhe përpëliten me dhimbjen që ndjen ajo.”

“Besimtarët janë si një ndërtesë (e ngritur me pjesë) të lidhura fort me njëra-tjetrën.”

“Besimtari do dhe duhet (për hir të Allahut). Prej

një njeriu që nuk do dhe nuk duhet, nuk ka mirësi.”

“Beto hem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, se nuk do të hyni në Xhenet përderisa të besoni. Përderisa të mos e doni njëri-tjetrin, nuk mund të jeni besimtarë (të përsosur). Do t’ju them diçka që nëse e bëni, do të duheni me njëri-tjetrin: Përhapeni selamin ndërmjet jush!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), nga ana tjetër na përgëzon me këtë hadith kudsij nga Allahu Teala: **“Ata që e duan njëri-tjetrin për Mua, ata që e vizitojnë njëri-tjetrin për Mua, ata që e nderojnë njëri-tjetrin për Mua dhe ata që i besojnë njëri-tjetrit dhe bëhen miq për Mua, do t’i përfshijë mëshira Ime.”**

Padyshim se lidhja fetare është më e fuqishme se lidhjet familjare dhe farefisnore.

Shërbimi ndaj fesë realizohet vetëm nëse myslimanët në të gjithë botën bashkohen rreth një qëllimi të njëjtë duke e mbrojtur umetin islam dhe sheriatin me të njëjtat ndjenja nga çdo lloj rreziku dhe duke e ngritur umetin drejt fitores. Umeri (r.a.), thotë:

“Një njeri që falet natën, agjëron ditën, e jep pasurinë e tij në rrugë të Zotit dhe lufton me heroizëm nëpër luftëra, nuk do të ketë asnjë dobi prej këtyre që bën nëse nuk e do për hir të Allahut atë që e do dhe nëse nuk e urren për hir të Allahut atë që e urren.”

Nëse myslimanët nuk do të bashkohen me njëri-tjetrin në formën që urdhëron Allahu Teala dhe nëse do të ndjekin një rrugë tjetër përveç asaj që na ka treguar Allahu (xh.sh.), Zoti na ruajt, do të thotë se do të rrokullisen në humnerën e poshtërimit.

Kur të bien në një gjendje të tillë, do të jenë të detyruar t’u binden armiqve, do të bien në kthetrat e tyre dhe detyrimisht do të jetojnë nën despotizmin e atyre.



Të nxjerrim MËSIM dhe jo ARMIQËSI

— Ali Riza Temel —

nga e kaluara

Sipas besimit tonë, secili prej nesh do të marrë shpërblimin apo ndëshkimin e veprës që ka bërë. Edhe faji është individual, edhe ndëshkimi është individual. Kjo e vërtetë shprehet kështu në librin tonë fisnik: **“...Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit...”** (En’am, 164) Ky ajet është përsëritur pesë herë në Kuranin Fisnik. Kjo tregon qartë rëndësinë e çështjes.

Në këtë botë të sprovës, qoftë individët, qoftë shoqëritë e kanë lënë skenën pasi i kanë ekzekutuar rolet e tyre të mira apo të këqija. Për këtë arsye, ata kujtohen me veprimet e tyre të mira apo të këqija.

Jeta dhe aventurat e njerëzve që kanë jetuar në të kaluarën janë mësim për ne. Pra, të lartësohemi duke bërë të njëjtat mirësi apo të poshtërohemi duke bërë të njëjtat ligësi... Edhe qëllimi i tregimeve të Kuranit Fisnik është nxjerrja e mësimëve nga historitë.

Është budallallëk t’i mbartim në ditët tona luftërat, armiqtë dhe përçarjet e së kaluarës dhe t’i

shndërrojmë në shkak për beteja dhe luftëra të reja. Nxjerrja e luftërave dhe përçarjeve të reja në vend që të marrim mësim nga ngjarjet e ndodhura në të kaluarën, para së gjithash është lehtësim i punës së armikut dhe shkatërrim me dinamit i bazës së miqësisë.

“Ata njerëz tashmë kanë kaluar. Ata do të kenë çfarë kanë merituar dhe ju do të kenë atë që meritoni e nuk do të pyeteni për veprat e tyre.” (Bakara, 134) Të gjykuarit e të kaluarës nuk është puna jonë. Të gjithë do t’i japin llogari Allahut Teala. Gjykata më e drejtë është “Gjykata e Madhe (gjykata në Ditën e Gjykimit)” dhe gjykatësi më i drejtë është “Allahu Teala”. Ai (xh.xh.), do ta japë vendimin e fundit dhe më të drejtin. **“...Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t’ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush.”** (En’am, 164)

Shndërrimi i kundërshtimeve në zënka dhe armiqtë përgjatë historisë islame, në përgjithësi është shfaqur në formën e Shiizmit dhe Sunizmit. Në themelin e kësaj zënke qëndron debati se kush do të duhej të ishte kalif pasi ndërroi jetë i Dërguari



i Allahut (a.s.). Kjo do të thotë që në një menyrë apo në një tjetër kalifati nuk ishte e drejta e Ebu Bekrit (r.a.), por e Aliut (r.a.). Kuji i bën dobi dhe çfarë dobie i bën debati i përditshëm rreth një çështjeje që në këtë apo atë formë ka marrë fund dhe shndërrimin e saj në zënka e akuzime? Dihet qartazi se sa na ka kushtuar një grindje e tillë si përgjatë historisë, ashtu edhe në ditët tona. Çfarë mund të ketë tjetër përveçse dëm nxjerrja e kundërshtimeve dhe armiqësive ndërkohë që mund të kapemi pas këtij parimi hyjnor? ***“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia...”*** (Enfal, 46)

Ata që pandehin se po përpiqen dhe luftojnë për çështjen e kalifatit të Aliut (r.a.), përse nuk sillen si Aliu (r.a.), për të mos i nxitur përçarjet dhe armiqësitë? Aliu (r.a.), ashtu siç është shprehur edhe Ali Sheriati, “ky djalë i ri ka duruar në mënyrë që umeti të mos dobësohej prej përplasjeve të brendshme e lojërave politike, në mënyrë që fiset beduine që gjendeshin në kurth në Medinë, e cila ishte qendra e vetme e Islamit mbi rruzullin tokësor, të mos shpërndaheshin me një komplot të befasishtëm që mund ta realizonte imperializmi Bizant dhe Persian. Ai heshti për një kohë 25 vjeçare derisa u zgjodh kalif dhe nuk lejoi që të dilnin përçarje.” Ata që e lavdërojnë Aliun (r.a.) dhe e ofendojnë Umerin (r.a.), a nuk marrin aspak mësim nga Aliu (r.a.)? Aliu (r.a.), i ndihmoi kalifët para tij dhe asnjëherë nuk shfaqti pabesi kundër tyre. Ndër katërmëdhjetë djemtë e tij, tre prej tyre e kanë pasur emrin Ebu Bekr, Umer dhe Osman. (Ibn Xhevzi, Sifatu’s-Safve, vëll. 1, fq. 309.) Për këtë arsye, armiqësia ndaj Ebu Bekrit dhe Umerit (r.a.), nga një aspekt do të thotë armiqësi ndaj Aliut (r.a.). Çfarë do të thotë që të jesh më Ali se Aliu? Si mund të mos i japin rëndësi

kësaj të vërtete vëllezërit tanë shiitë që gjendet e shënuar në veprën Nehxhu’l-Belaga, të cilën e konsiderojnë prej veprave më të nderuara? Aliu (r.a.), i ka thënë Umerit (r.a.): “Mos merr pjesë vetë në luftën e Iranit! Nëse vritesh ti, myslimanëve nuk u ngelet njeri ku të strehohen. Në vendin tënd emëro një komandant trim! Në këtë mënyrë, do të bëhesh streha dhe siguria e Islamit.” (Nehxhu’l-Belaga, fq. 172. A. B. Gëlpënarllë.)

Sociologu i famshëm nga Irani, Ali Sheriati, i cili u martirizua nga Savaku në moshën dyzet e katër vjeçare, e shpreh kështu qëndrimin pozitiv të Aliut (r.a.): “Aliu u tërhoq në shtëpinë e tij, heshti dhe nuk e ngriti shpatën kundrejt kundërshtarëve të tij. Pastaj dha besën, fali namaz pas tyre dhe u bë burim urtësie. Ai mendoi për të mirën e atyre. Kur forcat arabe dhe islame u mposhtën në luftërat e Iranit, Umeri tha: “Këtë herë edhe unë do të shkoj në luftë.” Por Aliu e ndaloi nga kjo duke i thënë: “Ti je prijësi i kësaj ushtrie. Nëse shkon dhe vritesh, shpërndahet e gjithë ushtria. Ti duhet të qëndrosh në qendër, në mënyrë që armiqtë ta kuptojnë se mbrapa ka edhe të tjerë nëse humbet ushtria.” Ky është mendimi strukturor i një njeriu që bënte vetëm mirë. Aliu edhe më vonë pati marrëdhënie të mira me ata. Ai pati miqësi me ata dhe për asnjë moment nuk lejoi që kundërshtimet ta dëmtonin unionin e ri apo që të përfitonin nga kjo gjendje njerëzitet që ishin hipokritë të brendshëm dhe armiqtë e jashtëm.

Edhe pse nuk është i mundur një konsensus i plotë ndërmjet Sunitëve dhe Shiitëve në besim dhe mendim, prapë se prapë është farz që të qëndrojmë të bashkuar kundrejt armiqve të përbashkët. Edhe pse Ali Sheriati ka rënë në disa gabime për shkak të ndikimit të mjedisit e kulturës ku është rritur, ka shfaqur sjellje mjaft të ndërgjegjshme dhe strukturore për sa i përket çështjes së veprimtimit në më-

nyrë të bashkuar të Sunitëve dhe Shiitëve kundrejt armiqve të myslimanëve. Mendimet e tij është e pamundur të mos pranohen: “Shoqëria islame, si një fuqi njerëzore, ka besim të përbashkët, qëllime të përbashkëta, fat të përbashkët dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, ka armik të përbashkët. Kjo shoqëri së bashku mund të formojë një fuqi, një kyç dhe një grusht. Kjo është shumë e natyrshme.” Edhe kjo anekdotë që e kemi marrë nga libri i tij me titull “Aliu” dhe që do ta japim këtu, është mjaft interesante:

Një shiit që thoshte: “Le të mposhten palestinezët!” – dhe që u pyet kur u mposhtën ata: “Përse dëshirove që të mposhten palestinezët?”, tha: “Ata kanë qenë armiq të Ehli Bejtit.” Zotëri i nderuar, kur kanë qenë ata armiq të Ehli Bejtit? Ku është Ehli Bejt, ku janë palestinezët? Çfarë faji kanë palestinezët për këtë? Mbi të gjitha, mos vallë është prej Ehli Bejt Ben Gurioni që mori hakun e Ehli Bejtit? Çfarë Shiizmi është ky shiizmi yt që e merr hakun me Mose Dajanin dhe Ben Gurionin? Ndërkohë që popujt myslimanë po bombardohen, këta thonë: “Ata po japin llogari për padrejtësinë që ia kanë bërë familjes së Pejgamberit (a.s.).” Zotërinj! Përse i shndërroni në ngjarje shoqërore këto ngjarje historike? Nëse ju jeni shiitë, kuptimi i kësaj duhet të jetë ky: “Ju duhet të ndiqni rrugën e Aliut, duhet të luftoni për atë që ka luftuar ai dhe jetën duhet ta flijoni për atë gjë që edhe ai e ka flijuar jetën e tij. Përndryshe, hedhja e të tjerëve nën këmbët e armikut të përbashkët apo të ndjerët e kënaqësisë nga fakti se ata po shtypen, nuk mund të jetë shiizëm i Aliut.” (Ali Sheriati, Aliu, fq. 168-9.) Shiizmi safevi që doli në pah me dashurinë ndaj Aliut (r.a.), e shndërroi Aliun (r.a.), në një legjendë me lavdërime të padobishme dhe të ekzagjeruara. Disa mund të mendojnë se dashuria ndaj Aliut (r.a.), do të bëhet shkak për ndërmjetësim në Ahiret, por një dashuri injorante nuk do të ketë dobi as në Ahiret.

Dashuria ndaj Aliut nuk e bën të detyrueshme armiqësinë ndaj Ebu Bekrit, Umerit dhe Osmanit. Në të vërtetë, gjendja që sundon më së shumti veçanërisht ndërmjet Shiizmit Safevi në ditët e sotme, më shumë është armiqësia ndaj Umerit dhe urrejta ndaj Ebu Bekrit se sa dashuria ndaj Aliut.

Mos vallë faji i Umerit është çlirimi i Iranit dhe përhapja e Islamit atje? Mos vallë është krim që të vendoset Islami në vend të adhurimit të zjarrit, pra, në vend të perandorisë perse, apo siç shprehet edhe Rabia b. Amiri, të shpëtohen njerëzit nga adhurimi i njerëzve dhe t’u jepet fund besimeve të humbura? Çfarë do të thotë që iranianët ta urrejnë emrin Umer ndërkohë që ata më së shumti duhet ta falënderojnë Umerin ngaqë u bë shkak që ata të

pranonin Islamit?

Përçmimi i vlerave të përbashkëta të myslimanëve është armiku i bashkimit. Ky është edhe shkak i parë i armiqësisë. Shiitët janë vëllezër, por përderisa e pranojnë Kuranin Fisnik si vlerë të përbashkët, është shumë e mundur të bashkohemi në sofrën e Kuranit edhe pse nuk mund të bashkohemi në çështje të tjera.

Siç ka thënë edhe Ali Sheriati: “Ndarja ndërmjet popujve myslimanë ka filluar kur fuqia islame arriti nga lindja e Evropës deri në kufijtë e Spanjës dhe kur formoi një pengesë të fortë para sulmeve të kryqëzatore që donin të plaçkitnin Lindjen në emër të fesë. Që nga fillimi i luftërave të kryqëzatore e deri në ditët e sotme, të gjithë popujt myslimanë janë përpjekur t’i shndërrojnë në një kafshatë të lehtë në emër të gjallërimit të prejardhjeve, fiseve dhe medh’hebeve të tyre. Në një raport që është prezantuar në Francë, thuhej: “Ne kemi zbuluar diçka të re. Algerianët ndahen në dy pjesë. Njëra pjesë e tyre janë berberijtë dhe pjesa tjetër janë arabët. Ne mund të nxjerrim përplasje ndërmjet këtyre dy grupeve.” Në pah u hodhën dy mendime. Njëri ishte berberizmi dhe tjetri ishte arabizmi. Ndërkohë që ata hanin njëri-tjetrin, Franca i sundoi ata për vite të tëra dhe i kolonizoi.

Pasi u dobësua racizmi, u nxitën ndarjet medh’hebore. Arma më e madhe e imperialistëve është fitneja dhe përçarja. Mbajtja në rënd të ditës e çështjeve të ndjeshme si alevizmi, shiizmi e sunizmi dhe përdorimi i ngjarjeve të dhimbshme si ngjarja e Qerbelasë si lëndë djegëse për të ndezur luftën ndërmjet Sunitëve e Shiitëve, është prej armëve më të forta të imperializmit.

Nxehja e ngjarjeve që kanë ndodhur përgjatë historisë duke i mbartur në ditët e sotme për t’i shndërruar në zënka, është budallallëk. Asnjëherë nuk mund të imagjinohet që një mysliman t’i nxisë ngjarjet e dhimbshme që i mërzhisin myslimanët dhe që e copëtojmë bashkimin e tyre. Këto ngjarje nuk duhet të bëhen objekt i akuzimeve të ndërsjella.

Veçanërisht në ditët e sotme, të gjithë ata që shqetësohen nga imazhi i myslimanit që bie ndesh me shpirtin e Islamit, me adhurimin ndaj Allahut dhe me të qenët umet i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), duhet ta lënë në një qoshe fanatizmin e racizmit, medh’hebit e prejardhjes dhe duhet të përpiqen për t’u takuar e bashkuar brenda kornizës së gjerë të “Umetit”.



Ata që e duan njëri-tjetrin

— Sadik Dana —

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Allahu ka robër të atillë që, edhe pse nuk janë prej pejgamberëve dhe dëshmorëve, pejgamberët dhe dëshmorët do t’i lakmojnë kur të shohin nderimin e tyre te Allahu në Ditën e Kiametit.”* Atij i thanë: *“Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?”* I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: *“Ata që i duan të vetmuarit vetëm për hir të Allahut duke mos pritur ndonjë shpërblim prej tyre. Fytyrat e atyre do të jenë dritë. Ata do të jenë në minbere prej drite. Ata nuk do të kenë frikë kur njerëzit do të frikësohen dhe nuk do të mërzhiten kur njerëzit do të mërzhiten.”*

“Ata do të lakmohen nga pejgamberët dhe dëshmorët” është një përshkrim i gjendjes së tyre të lakmueshme me anë të përngjasimit. Në këtë shprehje letrare është përdorur mënyra figurative. Kuptimi i cili synohet është: *“Nëse mund të imagjinohet një grup me këto cilësi, atëherë mund të jenë vetëm këta.”* Përndryshe, është e padiskutueshme që askush nuk mund ta arrijë gradën e pejgamberëve.

“Për ata ka sihariqe në jetën e kësaj bote.”

Në momentet e vdekjes engjëjt u vijnë atyre me mëshirë. Ndërsa në Ahiret, engjëjt i presin ata duke i përshëndetur me selam dhe duke u dhënë përgëzim për shpëtim. Përgëzimi më i madh që do t’u vijë atyre në Ahiret do të jetë hapja e perdeve nga Allahu i Madhëruar dhe realizimi i takimit me Të si një mëshirë prej të Lartësuarit kur të shkëlqejë drita e përherëshme dhe kur të zhduket errësira.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Atij që shkon për të vizituar një vëlla mysliman për hir të Allahut, një engjëll i thotë nga pas: “Edhe vetë je i mirë, edhe vizita jote është e mirë. Edhe Xheneti është përgatitur për ty si një vend i mirë.”

Abdullah ibn Umeri (r.a.), thotë:

“Nëse agjëroj përgjatë gjithë jetës, nëse e kaloj të gjithë natën me adhurim pa fjetur aspak, nëse e dhuroj të gjithë pasurinë time pjesë-pjesë në rrugë të Allahut dhe nëse vdes në këtë gjendje, por ndërkohë nuk kam në zemër dashuri kundrejt atyre që

i binden Allahut dhe urrejtje ndaj atyre që nuk i binden Atij, nuk mund të kem dobi nga të gjitha këto që bëj.”

Allahu Teala dërgon një engjëll në rrugën e atij që shkon për të vizituar vëllain e tij në fe për hir të Allahut.

Engjëlli: Ku po shkon?

Burri: Po shkoj të vizitoj filan vëllain tim.

Engjëlli: Mos ke ndonjë punë që do ta bësh me atë?

Burri: Jo.

Engjëlli: Mos ke lidhje farefisnore me atë?

Burri: Jo.

Engjëlli: Mos vallë ai ka diçka te ti?

Burri: Jo.

Engjëlli: Atëherë, përse po shkon ta vizitosh?

Burri: Atë e dua për hir të Allahut, andaj po shkoj ta vizitoj.

Engjëlli i thotë: Allahu Teala më ka dërguar këtu për të të njoftuar se edhe Ai të do ty dhe se ke fituar Xhenetin ngaqë e do atë njeri.

Jepi përparësi vëllait ndaj vetes tënde

Njëri prej kushteve të dashurisë për hir të Allahut Teala është që t’i japësh përparësi vëllait ndaj vetes në çdo çështje, qoftë fetare apo në lidhje me këtë botë, aq sa të kesh mundësi. Shenja që tregon se dashuria është e pastër për hir të Allahut, është fakti që të mos presësh gjë prej mirësive dhe të mos kesh ndonjë interes prej tyre. Nëse dashuria është e njollosur me një sëmundje të tillë, ajo mund të pastrohet vetëm me shërimin e asaj sëmundjeje. Ai që nuk e ka miqësinë dhe vëllazërinë të mbështetur në ndonjë interes të kësaj bote, mund të ketë vazhdimësi në vëllazërinë dhe miqësinë e tij.

VEPRIMET

që çënojnë vëllazërinë

— Dr. Mustafa Karabaxhak —

Në Kuranin Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), njerëzit nuk vlerësohen sipas racës, prejardhjes, pozitës sociale, pasurisë, gjinisë apo veçorive fizike të tyre. Tek Allahu Teala të gjithë njerëzit janë të barabartë. Koncepti i epërsisë është në proporcion me devotshmërinë që njeriu ka kundrejt Allahut (xh.sh.). Allahu na njofton kështu në Kuranin Fisnik, në lidhje me këtë çështje: **“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijsëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”** (Huxhurat, 13) Madje, e vërteta që njerëzit kanë gjuhë dhe ngjyra të ndryshme mund të shikohet si një mirësi e veçantë: **“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.”** (Rum, 22)

Allahu Teala e cakton qëndrimin që besimtarët duhet të kenë kundrejt qafirëve dhe kundrejt njëri-tjetrit në këtë mënyrë: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis**

tyre...” (Fet’h, 29) Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), e përkufizon në këtë formë qëndrimin e besimtarëve kundrejt njëri-tjetrit: **“Besimtarët i sheh si shembulli i një trupi për sa i përket dashurisë, mëshirës dhe butësisë kundrejt njëri-tjetrit. Nëse një gjymtyrë e atij ndjen ndonjë shqetësim, atë e shoqërojnë edhe gjymtyrët e tjera në pagjumësi dhe temperaturë.”** (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66-67.)

MOS U PËRÇANI!

Allahu i Madhëruar kërkon që besimtarët të jetojnë të bashkuar e në vëllazëri, të mos përçahen dhe të mos ndahen: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”** (Al Imran, 103)

Allahu nuk dëshiron që të përçaheni në këtë botë. Ky parim në përgjithësi vlen për të gjitha fetë hyjnore dhe në veçanti për fenë islame. Mendimi



islam, si një domosdoshmëri e të vërtetës hyjnore: **“Allahu është Zoti i të gjitha botëve.”** (Fatiha, 1), e ka pranuar si parim themelor sjelljen e mirë dhe ruajtjen e të drejtave kundrejt jo vetëm myslimanëve, por kundrejt të gjithëve. Qëllimi i një feje që thotë: “...Mos bëni të këqija e mbrapshti në tokë!”, që i mallkon ata që bëjnë të këqija e mbrapshti në tokë (R’ad, 25) dhe që thotë se ata do t’i privojë nga dashuria për fenë (Kasas, 77), është sigurimi i paqes mbi sipërfaqen e rruzullit tokësor.

VEPRIMET QË E PRISHIN BASHKIMIN

Disa prej veprimeve që e prishin unitetin, bashkimin dhe vëllazërinë tonë janë si më poshtë:

Përpjekja për të gjetur mangësitë e njerëzve dhe të vepruarit me paragjykim. I Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith fisnik thotë: **“Kini kujdes prej paragjykimit, sepse paragjykimi është mashtrimi më i madh. Mos u përpiqni t’i shikoni dhe dëgjoni mangësitë e njëri-tjetrit! Mos u mundoni të mësoni për jetën private të njëri-tjetrit! Mos e kini zili njëri-tjetrit! Mos e urreni dhe mos shfaqni armiqësi kundrejt njëri-tjetrit! O robërit e Allahut! Bëhuni vëllazër!”** (Buhari, Edeb, 57.)

PËRÇMIMI I TË TJERËVE

Allahu thotë në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.”** (Huxhurat, 11)

GARA NË LLASTIM

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: **“Umetit tim do t’i ngjitet sëmundja e umeteve (të mëparshme).”**, sahabët e nderuar e pyetën: **“Cila është sëmundja e umetit?”** Ai u përgjigj: **“Thyerja e rregullit shoqëror, llastimi, gara dhe lavdërimi kundrejt njëri-tjetrit në lidhje me këtë botë dhe largimi e smira kundrejt njëri-tjetrit. Pastaj në pah do të dalë padrejtësia dhe do të formohet anarki.”** (Hakim, el-Mustedrek, IV, 282, hadithi nr: 7390.)

HYRJA NË DEBATE TË PANEVOJSHME

Allahu Teala thotë: **“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia...”** (Enfal, 46) Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Nëse një popull ka rënë në humbje pas udhëzimit, kjo patjetër ka ndodhur për shkak të debateve të panevojshme që lindin urretje dhe mëri.” Pastaj tha këtë ajet fisnik: **“...A janë më të mirë idhujt tanë apo ai? Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm për shkak se duan të hahen, sepse janë popull grindavec.”** (Zuhruf, 58; Tirmidhi, Tefsir, 43; Ibn Maxhe, Mukaddime, 7.) Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë siç vijon edhe në një hadith që transmeton Abdullah ibn Abbasi (r.a.): **“Vazhdimësia në debat të mjafton si mëkat.”** (Ibn Maxhe, Bir ve Sila, 58.) Ndërsa Sulejmani (a.s.), e këshillon kështu birin e vet: **“Lëre grindjen dhe debatin, sepse dobia e tyre është e pakët. Mbi të gjithë, ato nxisin armiqësinë ndërmjet vëllazërve.”** (Darimi, Mukaddime, 29, hadithi nr: 309.)

TË QENËT ZEMËRNGURTË DHE I PRIVUAR NGA MËSHIRA.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: **“Ai që nuk shfaq butësi ndaj të vegjëlve dhe respekt ndaj të mëdhenjve nuk është prej nesh.”** (Tirmidhi, Birr, 15; Ebu Davud, Edeb, 58.) Ndërkohë që Allahu Teala i kërkon Musait (a.s.), që të sillet më me butësi ndaj Faraonit te i cili e pati dërguar, na e bën të qartë se edhe njerëzit rreth e rrotull të Dërguarit të Allahut (a.s.), janë mbledhur ngaqë ai është sjellë me butësi. Në një ajet fisnik thuhet: **“...Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...”** (Ali Imran, 159)

RACIZMI

Racizëm do të thotë ta mbrosh popullin tënd edhe pse ka bërë padrejtësi, të lavdërohesh me racën tënde, të pohosh që raca jote ka epërsi dhe t’i urresh e përçmosh ata që nuk janë prej popullit tënd. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në lidhje me racizmin: **“Nuk janë prej nesh ata që bëjnë racizëm. Nuk janë prej nesh ata që luftojnë për racizëm. Nuk janë prej nesh ata që vdesin duke bërë racizëm.”** (Ebu Davud, Edeb, 111.)

Allahu Teala thotë: **“Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide.”** (Saff, 4) Në këtë kuptim duhet të njihet vlera e bashkimit dhe unitetit. Nëse e humbim unitetin, bashkimin dhe vëllazërinë tonë duke e sulmuar njëri-tjetrin për shkak të debateve të vogla, do të pësojmë dëme të mëdha dhe do të bëhemi pishman. Atëherë pendimi nuk do të ketë ndonjë dobi.

Mirë mbetshi!..

“Lëre grindjen dhe debatin, sepse dobia e tyre është e pakët. Mbi të gjithë, ato nxisin armiqësinë ndërmjet vëllazërve.”



TEUHIDI

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Kuptimi leksikor i fjalës “tevhid” është “njësim”, ndërsa kuptimi terminologjik i saj është “njësimi i Allahut”. Shkurtimisht, teuhidi shprehet me fjalinë: “La ilahe il-lall-llah / Nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut”.

Besimi i teuhidit është pranim dhe vërtetim i një-simit të padiskutueshëm të Allahut Teala. Shpjegimi më thelbësor dhe më i qartë i teuhidit gjendet në suren Ihlas: **Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilin i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”** (Ihlas, 1-4)

Besimi i teuhidit e bën të domosdoshëm refuzimin e çdo lloj besimi jashtë teuhidit, sepse teuhid do të thotë pranim i njësimi të Allahut në uluhijet. Rezultati i natyrshëm i këtij lloj besimi është pranimi i të njëjtit njësim edhe në adhurim. Pra, të mos pranosh në adhurim (të mos vendosësh në vend të Tij apo të mos bësh ortak me Atë) dikë tjetër përveç Allahut. Parimin e kësaj e gjejmë në suren Fatiha, e cila është surja e parë e Librit tonë të Shenjtë: **“Vetëm Ty të adhurojmë!..”** (Fatiha, 5)

Besimin e teuhidit të tillë dhe informacionin ilu-minues në lidhje me rezultatin e tij e gjejmë në këtë bisedë që është zhvilluar ndërmjet të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe sahabit të nderuar, Muadh ibn Xhebelit (r.a.):

Muadh ibn Xhebeli (r.a.), transmeton se i Dërguari

i Allahut, (a.s.), i ka thënë:

“O Muadh! A e di ti të drejtën e Allahut mbi robërit e Tij?” Muadhi (r.a.), i tha:

“Atë e di Allahu dhe i Dërguari i Tij.” Pejgamberi ynë i nderuar i tha:

“E drejta e Allahut mbi robërit është që ata ta adhurojnë vetëm Atë dhe të mos i shoqërojnë ortak Atij në asnjë gjë.” Pastaj, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti Muadhin (r.a.):

“Mirë, a e di ti se cila është e drejta e robërve mbi Allahun?” Muadhi (r.a.), iu përgjigj:

“Atë e di Allahu dhe i Dërguari i Tij.” Nisur nga këto fjalë, Pejgamberi ynë i nderuar i tha:

“E drejta e robërve mbi Allahun është që Ai të mos i ndëshkojë ata që nuk i bëjnë shirk.”

Në disa transmetime të tjera, gjenden edhe këto shtojca:

Muadh ibn Xhebeli (r.a.), tha: “O i Dërguari i Allahut! A t’i përgëzoj njerëzit me këtë?” I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj:

“Mos i përgëzo! Përndryshe, do të bëjnë lëshime (në veprat e tyre).”

DY PIKA

Ky hadith fisnik, në formën më të shkurtër dhe të qartë, na shpjegon konceptin “e drejta e Allahut mbi robërit” nga aspekti i teuhidit e cila është që robërit ta adhurojnë Allahun dhe të mos i shoqë-

rojnë ndonjë të barabartë apo ortak në asnjë gjë. Gjithashtu, na shpjegon edhe konceptin “e drejta e robërve mbi Allahun”, e cila është që Allahu të mos i ndëshkojë robërit e Tij njëses. Padyshim se kjo është një mirësi dhe sihariq i madh.

Mirëpo në çfarë gjendjeje jemi ne myslimanët e sotshëm, sa i takon pranimit të Allahut dhe adhurimit vetëm të Tij? Kjo pyetje ka shumë rëndësi të shtrohet aq shpesh sa të merret një përgjigje pozitive.

Siç ka thënë edhe i ndjeri, Muhamed Ikbali: “Feja është dashuri.” Nxjerrja në pah e kësaj dashurie me besim dhe vepër, do të thotë zbatim i dispozitave të besimit të teuhidit. Ky hadith fisnik i mëposhtëm bën një deklaram të përgjithshëm që i përfshin të gjithë pejgamberët të cilët kanë qenë predikuesit e teuhidit:

“Apeli dhe thirrja më e rëndësishme e imja dhe e të gjithë pejgamberëve para meje ka qenë fjala ‘La ilahe il-lall-llah / nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është një dhe me të Cilin askush nuk është i barabartë.’”

Këtu, në mënyrë të veçantë, është e dobishme që të shpjegojmë diçka. Disa, duke sjellë për argument hadithin tonë, hadithin e Muadhit (r.a.) dhe transmetime të tjera të ngjashme me ato, pohojnë se fjala e teuhidit / shehadeti është vetëm “la ilahe il-lall-llah” dhe se nuk ka nevojë edhe për shtesën “Muhammedun rasulull-llah”. Ndërsa disa orientalistë e konsiderojnë si dobësi pranimin e profecisë së Pejgamberit që zë vend te shehadeti. Ndërkohë, ky pohim për dobësi që do të thotë “cenim i parimit të teuhidit të besimit të profecisë”, nuk mund të jetë i pranueshëm nga Islami, i cili i ka caktuar dhe vërtetuar në mënyrë të prerë konceptet dhe statuset “uluhijet-besherijet dhe uluhijet-ubudijet”. Ky mendim i papranueshëm që do të thotë atribut i dobësisë ndaj Krijuesit të Lartësuar, ky pohim që nuk e pranon asnjë mendje dhe ky opinion për ta ndarë shehadetin, kurrë nuk mund të merret në konsideratë.

Që nga lashtësia dihet si një e vërtetë se të gjithë pejgamberët kanë predikuar besimin e teuhidit. Në mënyrë mjaft të natyrshme, çdo pejgamber i ka bërë thirrje umetit të tij: “Unë jam një pejgamber besnik që jam dërguar te ju. Atëherë, kini frikë nga Allahu dhe mu bindni!” Edhe të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i është dhënë urdhri: “Thuaj: Nëse e doni Allahun, m’u bindni mua!” Kjo do të thotë se çdo pejgamber që ka predikuar teuhidin, shprehjes “la ilahe il-lall-llah” që është thirrja për në teuhid, menjëherë i ka shtuar edhe detyrën për t’ju bindur atij, sepse, çdo pejgamber që ka kërkuar bindje ndaj vetes, nuk mund ta pranojë atë bindje pa e pranuar dhe vërtetuar profecisë e tij dhe pa e përvetësuar shprehjen “la ilahe il-lall-llah”. Për këtë arsye, shprehja origjinale dhe e pandryshueshme e shehadetit është “la ilahe il-lall-llah”. Ngaqë profecia e të Dërguarit tonë (a.s.), do të jetë e vlefshme

deri në Kiamet, shehadeti nga aspekti i umetit të Muhamedit përbëhet nga fjalitë: “La ilahe il-lall-llah, Muhammedun rasulull-llah.” Kudo dhe kurdo që mund të thuhet shprehja “la ilahe il-lall-llah”, edhe nëse nuk thuhet pjesa tjetër “Muhammedun rasulull-llah” pranohet sikur është thënë, sepse, në themelin e besimit të teuhidit dhe dashurisë ndaj Allahut Teala, siç shpjegohet edhe në ajetin e 31-të të sures Al Imran, është pranimi i Pejgamberit si të Dërguarin e Allahut dhe pasimi i tij.

Deklarimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), se apeli dhe thirrja më e rëndësishme e tij dhe e pejgamberëve para tij është fjala “la ilahe il-lallah”, është bërë në mënyrë që kauza më e rëndësishme e njerëzimit, pra, parimi i njësitimit të Allahut, të vendoset nëpër zemrat e njerëzve dhe prej aty të reflektohet në jetën e përditshme. Padyshim se ky reflektim do të realizohet në një jetë plot gjallëri e cila ka për bosht besimin e teuhidit.

Përndryshe, nëse gjendja është siç është shprehur Ikbali: “Në të vërtetë, edhe pse vjen zëri i la ilahe il-lall-llah, ajo ka ikur nga zemra dhe ka ngehur vetëm në buzë.”, apo nëse gjendja është si në rastin kur Enes ibn Maliku (r.a.), u takua më një grup myslimanësh dhe u tha: “Te ju nuk shoh asnjë cilësi të cilën kam pas qenë mësuar ta shoh në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), përveç fjalës la ilahe il-lall-llah.”, domethënë, nëse besimi i teuhidit nuk reflektohet në vepra, do të thotë se është humbur cilësia “muhlisan min kalbih / me dashuri e sinqeritet nga zemra” që kërkohet në thirrjen e teuhidit. Nëse ndodh kështu, atëherë si mund të kemi pretendime për sihariqin e dhënë në hadithin fisnik? Në të vërtetë, ky problem kuptohet edhe nga e vërteta që i Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk i dha leje Muadhit (r.a.), për t’i përgëzuar njerëzit duke i thënë se mund të bëjnë lëshime në veprat e tyre. Një pohim i zhveshur nga vepra mund ta zvarrisë njeriun drejt një vetëbesimi të pabazë dhe ta mashtrtojë atë. Ndërsa puna që bëhet pa besimin e teuhidit, në të vërtetë, nuk ka asnjë lloj vlere.

Si përfundim mund të themi se nga përgëzimi në hadithin fisnik nuk mund të nxirret gjykimi për falje (lënie) nga detyrat e adhurimit ndaj Allahut Teala. Fjalët boshe të disave si: “Ne kemi arritur të vërtetën dhe kemi shpëtuar nga obligimet e shariatit.”, janë fjalë dhe shenja të devijimit dhe degradimit të tyre. Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se leje për ta lënë adhurimin nuk u është dhënë as pejgamberëve të mëparshëm, as të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili na e ka dhënë vetë këtë sihariq.

Kjo do të thotë se pohimi “la ilahe il-lallah, Muhammedun Rasulull-llah”, i cili është kusht i teuhidit, duhet të shprehet me një besim dhe sinqeritet të plotë. Gjithashtu do të thotë se duhet t’i kryejmë detyrat e adhurimit në përputhje me shembullin e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

NGA MESDHEU DREJT ATLANTIKUT

ADMIRALI OSMAN MURAT REIS SHQIPTARI

— Dr. Ardian Muhaj —

Inkuadrimi i viseve shqiptare në shtetin osman, si dhe islamizimi gradual i një pjese të shqiptarëve solli si pasojë përfshirjen e tyre në rrjedhat politike dhe kulturore të kësaj perandorie. Në këtë aspekt shqiptarët vazhdojnë të kontribuojnë në zbulimet gjeografike, në shtimin e njohurive të njerëzimit rreth botës që e rrethonte, në afrimin e popujve dhe në krijimin e urave të komunikimit ndërnjerëzor.

Në mesin e një numri të madh shqiptarësh që në kuadrin e Perandorisë Osmane kontribuan në historinë botërore shquhet edhe kapedan Murati i Madh. Murat Reisi, i Madhi (Morato Arraez el Grande i burimeve spanjolle) detari i famshëm i Mesdheut të shekullit XVI, ishte një trim dhe detar i pashoq, të cilin historiani Philip Gosse e konsideron si një nga detarët më të njohur të të gjitha kohërave.¹ Murati ishte i pari ndër kapedanët e pavarur osmanë, që e ushtronin detarinë më shumë për llogari të vet se sa të inkuadruar në flota ushtarake dhe emri i tij u bë aq i famshëm sa edhe ai i detarit anglez Francis Drake. Kjo edhe për faktin se edhe bashkëkohësit e tij evropianë e shquanin në mesin e një morie të tërë kapedanësh detarë që mbanin emrin Murat, me epitelin i Madhi. Në bazë të dëshmimeve të Diego de Haedos, Kapidan Murati ishte shqiptar. Që në moshën 12 vjeçare ai fillon të lundrojë nën urdhrat e kalabrezit Uluxh Ali, detar i vjetër dhe i njohur në Algjer. Ndërsa në vitin 1578 kishte mundur të zotëronte si pronë personale një flotilje të përbërë prej disa galeonësh. Bëma më e rëndësishme e këtij viti ishte kur mori galerën *Santangel*, në të cilën udhëtonte për në Spanjë Duka i Terranovas, ish zëvendës-mbret dhe kapiten i përgjithshëm i Sicilisë. Murat Shqiptari vazhdoi lundrimet, i mbrojtur dhe i mbështetur nga miku i tij, detari dhe diplomati

i madh shqiptari, Muhamet Arnauti. Pikërisht më 1585 Murat Raisi realizoi lundrimin më të famshëm të jetës, duke arritur të bëjë atë që asnjë detar tjetër mysliman, qoftë maroken qoftë osman nuk e kishte bërë më parë: kalimin e ngushticës së Gjibraltarit dhe realizimin e inkursioneve në Oqeanin Atlantik. Deri atëherë detarët osmanë lundronin në afërsi të brigjeve, përveç rasteve kur u duhej të kryqëzonin Mesdheun. Skuadrilja e Murat shqiptarit kaloi ngushticën e Gjibraltarit dhe lundroi duke përshkuar gjithë atë distancë që i duhej për të mbërritur në ishujt Kanarie. Një hapësirë kjo po aq e panjohur për osmanët sa ç'ishte një shekull më herët për evropianët. Murati kishte marrë me vete një detar nga Kanariet që thoshte se e njihnte itinerarin, por kur mbas shumë ditësh lundrim të mundimshëm me rrema, piloti kanarien e humbi orientimin, i deklaroi Muratit se kishte frikë se mos ishin shmangur dhe i kishin kaluar Kanariet. Përgjigja e Muratit i habiti të gjithë: «edhe pse nuk kam qenë kurrë, e kam të sigurt se ajo që thua është e pamundur. Prandaj, vazhdo në këtë drejtim».² Murati kishte të drejtë.

Ky episod e bën të qartë se Murati kishte dijeni hartografike e gjeografike të sakta rreth brigjeve të Afrikës dhe Oqeanit Atlantik. Kjo edhe për faktin se vepra e detarit osman Piri Reis, *Kitab-i Behriye*, e shkruar më 1526 dhe që mbështetej në harta origjinale të Kolombit mbi konfiguracionin e Atlantikut dhe të territoreve të sapozbuluara të Amerikës është një dëshmi monumentale e informacionit gjeografik që dispononin osmanët.³

2. Haedo, *Topographia e Historia General de Argel*, fl. 90. «le dixo el piloto que dudava no huuiesen passado muy adelante y errado el bjaie, pero el Morato le respondiò que no era posible, y siguiendo adelante descubrieron tierra en la Isla del Lançaloto».

3. Svat Soucek, «Piri Reis and Ottoman Discovery of the Great Discoveries», *Studia Islamica*, 1964, f. 134; the Ottomans were aware of and interested in the discovery of the New World, marked on Piri's map as "Vilayet Antilia." Abbas Hamdani, "Ottoman Response to the Discovery of America and the Neê Route to India", *Journal of the American Oriental Society*, 101, (1981), f. 327-329..

1. Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, nouvelle edition, Paris : Payot, 1952, f. 57; «Le premier grand pirate barbaresque indépendant fut Mourad. Il était, lui aussi, né chrétien de parents albanais». Roger Coindreau, *Les corsaires de Sale*, Paris : Institut des Hautes Etudes Marocaines, 1948, f. 25.

Ekspedita e kapiten Murat Raisit ishte një ndër ndërmarrjet më të guximshme në historinë e detarisë, mbasi ky lundrim atlantik u krye me anije që ishin të destinuara për lundrimin në Mesdhe, por jo në Oqean. Dallimi thelbësor mes të dy zonave është se në Mesdhe përdoreshin anijet me rrema, ndërsa në oqean rremat ishin të pafuqishëm për të përballuar dallgët dhe erërat e forta, prandaj përdoreshin anije me vela.⁴ Në vitin 1587 Murat Raisi ndërmerr sërish një inkursion drejt ishujve Kanarie në krye të 18 galeotave. Simbas burimeve bashkëkohëse ky inkursion ishte realizuar në marrëveshje me mbretëreshën e Anglisë që në të njëjtën kohë kishte dërguar edhe të famshmin Francis Drake që të sulmonte pozitat spanjolle në zonën e Gjibraltarit.

Murat Reisi ishte pajtuar me anglezët që dy vite më parë kur ndodhej në Vlorë dhe bashkëpunonte ngushtë në Atlantik. Këtë bashkëpunim me anglezët e francezët duket se e mbajti të pandërprerë edhe në vitet e mëvonshme. Madje, në sytë e tyre ai gëzonte një respekt të veçantë. Kjo vihet re edhe nga fakti se në fillim të vitit 1607 kur ambasadori francez De Breves e takon pak para nisjes për në More, ku do merrte postin e sanxhakbeut, me të ishte një pirat anglez i cili i puth dorën me respekt Muratit.⁵

Figura e tij ka qenë një nga personazhet më të spikatura të letërsisë spanjolle të “shekullit të artë”. Në literaturën spanjolle kapedan Murati i Madhi, del për herë të parë më 1599, në veprën e Lope De Vegas, *Festime në Denia*. Po ky autor në veprën *La Dorotea* e shquan Murat Raisin në mesin e katër detarëve më të famshëm. Ndërsa në veprën *Shtegtari në dheun e vet*, më 1604 ai e paraqet Muratin si një emër aq i njohur në brigjet spanjolle sa që atij mund t’i atribuoheshin me të vërtetë të gjitha llojet e piraterisë. Po kështu ai del edhe në komeditë *Fitorja tjetër e markezit të Santa Kruzit*, *Martesa e zbuluar*, edhe *Robërit e Algjerit*. Gjithashtu edhe Servantesi e përmend në dy prej komedive të tija, të botuara më 1615, me titull *Sulltana e madhe Zonja Catalina e Oviedos Hamamet e Algjerit*.⁶ Mirëpo

4. Ardian Muhaj, “Ottoman Corsairs in the Atlantic in the 16th Century. Murat Rais the Albanian and the First Ottoman Expedition to the Canary Islands”, në *Uluslararası Piri Reis ve Türk Denizcilik Tarihi Sempozyumu: 26-29 Eylül 2013 / İstanbul*, Ankara: Turk Tarih Kurumu, 2014, vëll. III, f. 261-270.

5. *Relation des voyages de monsieur de Breues...*, f. 324.

6. Lope de Vega, *Fiestas de Denia*, kap. II, Valencia, 1599, fl. 59-61. Lope de Vega, *La Dracontea*, kap. I, edic. Sancha, vëll. III, f. 189. Lope de Vega, *El Peregrino en su patria*, Impreso en Sevilla, por Clemente Hidalgo, 1604, fl.8v. Lope de Vega, *La nueva victoria del marqués de Santa Cruz*, ed. Real Academia, vëll. XIII, f. 47. Lope de Vega, *El desposorio encubierto*, Madrid, por la viuda de Alonso Martín, 1620, f. 226. *Obras de Lope de Vega*, Real Academia, nueva edición, vëll. IV, *Los cautivos de Argel*, jornada III, f. 259. *Comedia famosa de la gran sultana Doña catalina de Oviedo*, jornada I, në *Ocho comedias, y ocho entremeses nuevos nunca representados, compuestos por Miguel de Cervantes Saavedra*, dirgidas a don Pedro Fernandez de Castro, en Madrid, por la viuda de Alonso Martín, 1615, fl. 132. Cervantes, *Comedia famosa de los baños de Argel*, jornada I, Madrid, 1615, po aty, fl. 60v.



komentuesit e veprave letrare të cituara më sipër, kanë qenë në mëdysheje në se bëhet fjalë për një pirat real apo imagjinar.

Në vitin 1595 arrin të bëhet kryeadmiral i Algjerit dhe çdo pranverë pasi ia ngarkonte të gjitha detyrat zyrtare një zëvendësi, ai nisej për të lundruar. Duket se karriera e tij mbas fushatave në Atlantik dhe mbas detyrës së kryeadmiralitetit të Algjerit i ngjason një pelegrinazhi drejt vendlindjes së vet, Shqipërisë. Nga të dhënat historike rezulton se mbas Algjerit, që dërguar nga Porta e Lartë në Tuniz, ku në vitet 1603-1607 e gjejmë aty si admiral apo bejlerbe. Në vitin 1606 apo më 1607 ai emërohet bejlerbe i Moresë.⁷ Pak para nisjes së tij drejt Modonit të Moresë për të marrë detyrën e sanxhakbeut, tashmë në moshën 80 vjeçare, ambasadori francez në Stamboll, De Breves e takon në bordin e anijes së tij, duke na dhënë një përshkrim shumë interesant. Kjo duket se e vërteton dëshminë e anglezit Knight që e raporton vdekjen e tij në Vlorë, në moshën 104 vjeçare, më 1638. Në të vërtetë lidhjet me vendlindje i kishte mbajtur të pashkëputura gjatë gjithë kohës edhe pse jeta e trazuar prej detari e kishte përplasur në brigjet e shumta të Mesdheut e të Atlantikut. Më 1569 atë e gjemë në Durrës. Në pranverë të vitit 1585 dëshmohej në Vlorë ku ambasadori anglez dhe ai francez kërkuan nga Porta e Lartë ndëshkimin e tij për dëmet që u kishte shkaktuar. Ndërsa në vitin 1591 e gjejmë në Adriatik ku mes tjerash merr një anije në afërsi të Splitit me mallra e para të vlerësura në 15 mijë dukatë.⁸

7. İdris Bostan, *Adriyatik'te korsanlık. Osmanlılar, Uskoklar, Venedikler. 1575-1620*, İstanbul: Tımas yayınları, 2009, f. 51-54 dhe f. 71, shën. 88, jep si datë të emërimit të tij në këtë post shkurt 1607. Duket se xhamia dhe tyrbja e tij që edhe sot përbëjnë një atraksion turistik në Rodos janë përkujtim i kontributit të tij si sanxhakbe i Moresë. ListenRead phonetically Dictionary -

8. Letër e Sulltan Muratit III drejtuar bejlerbeut të Algjerit, ku thuhet se Bailiu venedikas ishte ankuar se Murad Reis, kishte marrë në Adriatik një anije nga Spliti me 15 mijë dukatë, në para e mallra, një anije nga Perasti, një barkë nga Kotorri dhe një fregatë nga Budva. ASV, *LST, busta 8*, 1591; M. P. Pedani Fabris, *I « Documenti turchi »*, dok. 1018, f. 258.



PYETJA PA PËRGJIGJE

Disa çështje në Kuranin Fisnik shpjegohen duke u bazuar në pyetjet e njerëzve. Të Dërguarit të Allahut (a.s.), pasi i thuhet: “Të pyesin për Kiametin, plaçkën e luftës, jetimët, muajt haram, infakun...” i jepet përgjigja me anë të shprehjes: “Thuaj!”¹ Në suren Isra, thuhet si më poshtë: **“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”**² Siç vihet re, në këtë ajet fisnik, me anë të fjalisë: **“...Ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”**, është shprehur qartë se përgjigja nuk do të jepet.

Siç shprehet edhe në ajetin fisnik, natyra e shpirtit është e pamundur të njihet, sepse shpirti është një çështje fshehtësie. Nisur nga kjo, thuhet: “Shpirti është një krijesë qiellore dhe përhapet në të gjithë trupin siç përhapet lëngu i trëndafilin në trupin e trëndafilin.” Krahas kësaj, dijetarët i kanë shpjeguar specifikat brenda të dhënave në këtë çështje dhe shpirtin e kanë përkufizuar si “faktori që mundëson jetën te gjallesat”. Nisur nga kjo, kur thuhet “shpirt i njeriut” synohet një un që i posedon cilësitë si gjallëria, vetëdija, mendja dhe perceptimi. Fakti që njerëzit janë të ndryshëm nga kafshët buron nga krijimi i ndryshëm i shpirtit. Edhe ndryshimi ndërmjet njerëzve buron nga e vërteta se kanë shpirta me grada të ndryshme. Për shembull, pejgamberët marrin lajme nga bota e gajbit. Kjo ka lidhje me faktin se ata posedojnë një gradë të lartë shpirtërore.

Dijetarët i kanë shprehur kështu cilësitë e shpirtit: “Shpirti është një sekret i Allahut dhe lëviz me shpejtësi duke marrë formën e trupit. Ai arrin në vende të largëta brenda një kohe të shkurtër. Kur të nxirret dhe të merret nga trupi, nga shpirti i besimtarit përhapet një erë e këndshme, ndërsa nga shpirti i qafirrit përhapet një erë e keqe. Ndërkohë shpirtat kanë cilësitë e tyre edhe nga aspekti i besimit dhe bindjes ndaj Allahut Teala. Disave u rëndon ana fizike, ndërsa disa të tjerëve u rëndon ana shpirtërore. Nisur nga ky këndvështrim, pejgamberët janë njerëzit me shpirta sublimë. Pas tyre vijnë të devotshmit dhe dijetarët.”³

Në Kuranin Fisnik fjala shpirt përmendet në njëzet vende.⁴ Në hadithet fisnike krahas fjalës shpirt përdoren edhe fjalët nefs dhe neseme. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, shkoi pranë trupave të politeistëve që ishin vvarë në Luftën e Bedrit dhe u tha: **“A e gjetët fundin e dhimbshëm që Zoti i lajmëroi më parë?”** Omeri (r.a.), e pyeti: **“A po u flet trupave që nuk kanë shpirt?”** Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: **“Ata i dëgjojnë jo më pak se ju ato që i thashë, por nuk mund të përgjigjen dot.”**⁵

Siç thuhet në tefsir, kur i vdekuri vendoset në varr, shpirti kthehet në trup në një formë që nuk mund ta kuptojmë dot. Pasi të përfundojë llogaria, ndjen ndëshkim apo mirësi sipas gjendjes së tij deri


1. Surja A'raf, 187; Surja Enfal, 1; Surja Bakara, 215, 217, 220, etj.

2. Surja Isra, 85.

3. Enciklopedia Islame e Vakfrit të Entit Fetar të Turqisë, neni i shpirtit, Sulejman Ulludag, vëll. 35, fq. 189.

4. Surja Hixhr, 28-30; Surja Sad, 71-72; Surja Mu'minin, 12-16, etj.

5. Buhari, Megazi, 8.



në Kiamet. Shpirti është ai që vazhdon ekzistencën edhe pas vdekjes, ai do ta përjetojë ndëshkimin ose shpërblimin në botën tjetër. Kështu, ajeti fisnik, i cili na njofton se besimtarët të cilët thonë: **“Zoti ynë është Allahu dhe pastaj bëjnë vepra të mira.”**⁶, engjëjt do t’u zbresin në momentet e vdekjes dhe do t’i përgëzojnë ata me siguri dhe Xhenet, gjithashtu na tregojnë se menjëherë pas vdekjes shpirtat besimtarë ndejnë mirësitë e Xhenetit, ndërsa shpirtat qafirë ndejnë ndëshkimin e Xhehenemit në një lloj mënyre. Edhe në hadithet e sakta gjenden shpjegime të tilla. Gjithashtu jemi të njoftuar se nga varri do të hapet një derë drejt Xhenetit apo drejt Xhehenemit.⁷

Sipas nesh, njeriu në këtë çështje ka dy dilema. E para: Përpjekja për të kuptuar natyrën e shpirtit. Kjo është një pyetje apo përpjekje e lashtë e njerëzimit, e cila nuk ka përgjigje. Siç është shprehur Imam Gazaliu në veprën e tij me titull “Ihja”: “Njeriu e ka të pamundur që ta perceptojë natyrën e shpirtit. Përpjekja për ta shpjeguar atë është në kundërshtim me të fshehtën e sprovës.” E dyta: Mosnjohja në përgjithësi e fazave të shpirti kur ai hyn në kallëpin e trupit. Njeriu nuk i jep rëndësi përparësisë që ka tasfija-tezkija/dëlirja shpirtërore dhe fokusohet vetëm te plotësimi i nevojave të trupit. Ndërkohë njeriu duhet ta dijë se përse dhe si është dërguar në këtë botë dhe jetën duhet ta bëjë sipas kësaj. Ai asnjëherë nuk duhet ta harrojë se shpirti është baza dhe se trupi është një kallëp apo mbartës i shpirtit. Siç është shprehur edhe Ibrahim Hakkë, njeriu gjithmonë duhet të mos e harrojë mebde dhe meadin e

shpirtit dhe të trupit, pra, se nga ka ardhur dhe ku do të shkojë.

Njeriu i është dhënë një amanet dhe sikur i është thënë kështu: “Ky amanet i çmueshëm që të është dhënë, nuk përbëhet nga ajo që shikon ti. Ki kujdes, pjesa që nuk e shikon dot është aq shumë e rëndësishme sa që nuk mund t’ia dish natyrën e saj. Kur të vijë koha, ajo do të të merret përsëri.”

Me të vërtetë, siç ka thënë edhe Mevlana: “Kallëpi i trupit është kurhani i dheut.” Kështu që ne, kur ta kuptojmë se kësaj pyetjeje nuk i është dhënë përgjigje në ajetin fisnik i cili përbën temën tonë, do të përparojmë edhe më shumë në kuptimin e rëndësisë së këtij amaneti.



KOHA ËSHTË E SHITRENJTË!

Në suren Nebe’, e cila flet për lajmin e madh, thuhet: **“Gjumin jua kemi bërë për prehje. Natën jua kemi bërë mbulesë, ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar.”**⁸

Në shumë ajete të Kuranit Fisnik tregohet “rëndësia e vlerësimit të kohës” duke e tërhequr vëmendjen te formimi e ndryshimi i natës e ditës dhe te aspekti i mrekullisë së gjumit.⁹ Prej këtyre që thamë më sipër kuptojmë se natën, të cilat janë një mrekulli e veçantë ngaqë zgjaten dhe shkurtohen sipas stinës, janë përgatitje për ditët. Ndërsa ditët që vijnë duke iu shtuar njëra-tjetrës, janë përgatitje për “Ditën e Madhe” e cila absolutisht do të vijë.

Këtu, nëse do ta shtjellojmë pyetjen: “Si duhet ta vlerësojmë kohën në përgjithësi dhe natën në veçanti?”, atëherë në mendje duhet të na vijë stili profetik i të jetuarit të ditës e natës. Siç e dimë, e gjithë jeta e Hz. Pejgamberit ka qenë ibadet ndaj Allahut, predikim i Islamit dhe mëshirë ndaj të gjitha krijesave. Gjumi i tij ka qenë me qëllim që të fitonte fuqi për kryerjen e detyrave. Për këtë arsye, ajo që ai ia ka mësuar umetit është që umeti të jetojë duke ia ditur vlerën kohës.

Disa miq të Allahut Teala nganjëherë kanë marrë masa të jashtëzakonshme për ta ruajtur këtë vetëdije. Ndër këta mund të përmendim Rebi ibn Hajsemin, i cili pati hapur një gropë të gjerë sa një varr në shtëpinë e tij, në mënyrë që ta shtonte këtë vetëdije. Kur lodhej, shtrihej dhe flinte aty. Kur zgjohej, thoshte këtë ajet fisnik: **“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!..”**¹⁰ Pastaj thoshte: “O Rebi! Vlerësoje kohën para se të vijë dita që nuk do të kthehesh pas.”¹¹

Përfundimisht mund të themi se çdo gjë që humbet, mund të gjendet. Përveç kohës.

8. Surja Nebe’, 9-11.

9. Surja Nebe’, 9-11; Surja Bakara, 47; Surja Nahl, 86, etj.

10. Surja Mu’minun, 99-100.

11. Përkthimi i Ihjau Ulumi’d-Din, vëll. 4, fq. 232.

6. p Surja Fussilet, 30.

7. Taberi, II, 39.



Seleme Ibn Hishami

- RADIJALLAHU ANHU -

— Mustafa Erish —

Seleme ibn Hishami (r.a.), është një sahab që ka marrë lavdërimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.): “Ai nuk është dezertor, por luftëtar trim.”

Ai u bë mysliman në vitet e para të Islamit dhe ishte një ushtar i besimit, që rezistoi me durim kundrejt torturave të familjes së tij politeiste.

Ai lindi dhe u rrit në Mekë. I përkiste Beni Mahzumeve, të cilët ishin krahu më i nderuar i fisit Kurejsh. Emri i tij është: Ebu Hashim Seleme ibn Hisham ibn el-Mugire el-Mahzumi el-Kurejshi. Ai është vëlla i armikut të përbetuar të Islamit, Ebu Xhehlit dhe i Harith ibn Hishamit, i cili u bë mysliman përgjatë çlirimit të Mekës. Është djali i xhaxhait të Halid ibn Velidit (r.a.). Nëna e tij Dubaa binti Amiri, është prej sahabeve poete dhe prej myslimaneve të para. Këto vargje që ka thënë në lidhje me Selemenë janë mjaft të famshme:

“O Allah! O Zot i Qabesë që respektohet dhe përshëndetet me selam!

Jepi fuqi dhe fitore Selemesë kundrejt të gjithë armiqve të tij!

O Allah! Jepi dy duar atij në të gjitha punët!

Me njërën të japë vazhdimisht dhe me tjetrën të nderohet.” (Usdu'l-Gabe, II, 531.)

Seleme ibn Hishami (r.a.), e pranoi Islamit në periudhën e Mekës. Ishin vitet e para kur drita e Islamit ndriçoi horizontet e Mekës. Zemrat dhe shpirtrat kishin filluar të ndriçoheshin me dritën e udhëzimit. Njerëzimi që kishte ngelur në errësirat e injorancës e të padrejtësisë dhe shpirtrat që kishin zënë ndryshk me primitivizëm, po shpëtonin nga padrejtësia dhe një nga një po arrinin paqen e po dilnin në dritë.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, po përpiquej t'ua çlironte zemrat njerëzve dhe t'i ftonte për në fenë e fundit, Islamit. Ai i paralajmëronte një nga një të afërmit e tij dhe përpiquej për t'i shpëtuar njerëzit nga kthetrat e tmerrshme të shirkut dhe kufrit.

Me dashurinë, mëshirën dhe butësinë e Islamit ndërmjet njerëzve u formua një vëllazëri e fortë dhe e shëndetshme. Prej lidhjeve të gjakut dhe farefisnisë që

më parë kishte ndërmjet atyre që qëndruan në anën e kufrit dhe atyre që qëndruan në anën e besimit nuk ngeli asnjë gjurmë. Babai politeist e konsideronte si armikun më të madh birin e tij besimtar. Vëllai jobesimtar e shikonte si hasmin më të përbetuar vëllain tjetër të tij që kishte zgjedhur Islamit.

Kjo tablo shikohej shumë qartë ndërmjet pesë bijve të Hishamit. Ndërkohë që Seleme dhe Harithi zinin vend pranë të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, Ebu Xhehli, Asi dhe Halidi që vinin nga i njëjti baba, ishin armiqtë kryesorë të Islamit dhe prijësit e kufrit e të shirkut. Këta të tre të mjerë vdiqën si qafirë në luftën e Bedrit. (Istiab II, 643; Isabe III, 130.)

Kur Ebu Xhehli e dëgjoji se vëllai i tij i madh, Seleme ibn Hishami (r.a.), kishte hyrë në besim, lidhja e tij e gjakut u shndërrua në hasmëri. Ai nuk e duronte dot faktin që një individ prej familjes së tij të kalonte në rreshtin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Për këtë arsye, aplikoi çdo mënyrë për ta bërë atë që të hiqte dorë, por të gjitha përpjekjet e tij shkuan dëm. A ishte e mundur që dikush i cili kishte shijuar kënaqësinë e besimit të kthehej e të pinte zeherin e kufrit? Sigurisht që nuk ishte e mundur.

Seleme ibn Hishami (r.a.), u torturua shumë nga politeistët. Ai nuk e duroi dot poshtërimin dhe torturën e vëllait të tij zullumqar. Andaj ngeli i detyruar të emigronte në Abisini me karvanin e parë. Të gjithë pjesëtarët e karvanit filluan ta zbatonin fenë dhe ta jetonin besimin e tyre atje. Ai kishte tre muaj që kishte emigruar nga vendi i tij. Ndërkohë dëgjoji një lajm të tillë: “Mekasit kanë pranuar besimin Islam dhe Velid ibn Mugire është bërë mysliman.” Nisur nga ky lajm, disa prej tyre u kthyen pas, por kur u afruan në Mekë, morën vesh se lajmi që kishin dëgjuar nuk ishte i vërtetë. Për këtë arsye, u ndjenë të zhgënjyer. Ata nuk u kthyen dot përsëri në Abisini. Edhe në Mekë ishte e pamundur të hynin pa qefil. Hyrja në Mekë do të thoshte praninë menjëhershme të torturave dhe poshtërimeve që politeistët do t'i shikonin të arsyeshme për ata.

Për ta shmangur këtë rrezik, disa prej tyre menduan të hynin në mbrojtjen e të afërmeve që gjendeshin në Mekë. Ndërsa disa të tjerë nuk pranuan të hynin në mbrojtjen e dikujt, hynë fshehurazi në Mekë dhe u fshehën për një kohë të gjatë, por prapë se prapë u

kapën nga politeistët. Seleme ibn Hishami, Velid ibn Velidi, Hisham ibn Asi, Abdullah ibn Suhejli dhe disa sahabë të tjerë u kapën prej mushrikëve dhe u futën në burg.

Armiku i përbetuar i Islamit, Ebu Xhehli po e torturonte vëllain e tij, Seleme ibn Hishamin (r.a.). E rrihte derisa lodhej, i thoshte ofendime nga më të rëndat, e linte pa ushqim e ujë dhe e bënte të vuante për ditë të tëra. Të gjitha këto padrejtësi ia bënte me mendimin se ndoshta mund t'i thyhet vendosmëria dhe të dezertojë nga feja. Ndërsa Seleme ibn Hishami (r.a.), i cili e kishte mbushur zemrën me dritën e besimit, kishte një besim që mund të sfidonte të gjithë univërsin dhe një dashuri të pashtershme për të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Këta tre sahabë nuk shfaqën as hezitimin më të vogël në çështjen e besimit. Ata qëndruan të fortë kundrejt torturave që iu bënë. Duruan!.. Rezistuan!..

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i cili e dinte gjendjen e rëndë të këtyre flijuesve të besimit dhe i cili e ndjente në shpirt vuajtjen që hiqnin ata, për një muaj me radhë është lutur për ata në çdo namaz të mëngjesit duke iu përgjëruar Allahut Teala: *"O Zot! Shpëtoje Velid ibn Velidin! O Zot! Shpëtoje Seleme ibn Hishamin! O Zot! Shpëtoje Ijash ibn Rebian! O Zot! Shpëtoje besimtarët e dobët!"* Pas kësaj lutjeje, menjëherë zbriti ky ajet fisnik që i përmendte ata: **"Ata nuk kanë fuqi për asnjë rrugëzgjidhje, nuk mund të gjejnë asnjë mënyrë."** (Nisa, 98)

Velid ibn Velidi që u përmend në hadithin fisnik është vëllai i Hazreti Velidit dhe biri i Velid ibn Mugires. Në luftën e Bedrit gjendej në rreshtat e politeistëve. Aty u kap rob dhe shpëtoi duke paguar çmimin për lirim e tij. Më vonë u bë mysliman, por prapë se prapë nuk e lanë të dilte nga Meka.

Këta tre sahabë që gjendeshin në duart e politeistëve mekas, ishin kushërinj të parë me njëri-tjetrin. Mugire ishte gjyshi i të treve. Pasi Velid ibn Velidi u bë mysliman dhe shkoi në Mekë, u kap dhe u fut në burg. Ijash ibn Rabia u mashtrua nga Ebu Xhehli përgjatë hixhretit. Këta tre sahabë tashmë gjendeshin bashkë. Të tre i kishin lidhur me njëri-tjetrin. Seleme ibn Hishami, Ijashi dhe Hishami, radijall-llahu anhum, nuk shpëtuan dot prej zinxhirëve edhe kur doli urdhri për të bërë hixhret në Medinë. Për këtë arsye, nuk morën pjesë dot në luftën e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut. (Ibn Sa'd, IV, 130-131.)

Me begatinë e këtyre lutjeve, Allahu Teala u dha atyre një rrugëzgjidhje. Pas pak kohe, Velid ibn Velidi (r.a.), gjeti një mundësi, u arratis dhe shkoi në Medinë. I Dërguari i Allahut (a.s.), u gëzua shumë kur e pa atë. Velidin e pyeti për gjendjen e vëllezërve të tjerë. Pra, për gjendjen e Selemes dhe Ijashit. Velidi e njoftoi se ata i kanë lidhur për këmbësh me njëri-tjetrin dhe se po përpëliten prej ndëshkimeve e torturave.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, dëshironte t'i shpëtonte nga duart e politeistëve këta dy sahabë të tij që kishin rënë viktimë. Për këtë arsye, u kthye nga sahabët dhe i pyeti: "Kush mund t'i shpëtojë ata dhe t'i sjellë në Medinë?" Ve-

lid ibn Velidi (r.a.), menjëherë u ngrit në këmbë dhe tha: "Unë mund t'i shpëtoj ata dhe të t'i sjellë ty, o i Dërguari i Allahut!"

Kur Velidi (r.a.), arriti në Mekë, hyri fshehurazi në qytet. Ai e mësoi nga një grua vendin ku gjendeshin Seleme ibn Hishami dhe Ijashi (r.a.). Velidi (r.a.), shkoi natën te vendi i atyre, ua preu litarin me të cilin i kishin lidhur, i hipi në devenë e tij dhe i nxori nga Meka. Kur mushrikët e kuptuan në mëngjes se ata kishin ikur, nuk i arritën dot edhe pse shkuan pas tyre. Kur Velidi (r.a.), arriti në Medinë bashkë me dy kushërinjtë e tjerë, gishtat e këmbëve i ishin çarë prej të ecurit dhe i ishin bërë krejt gjak. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i cili e dëgjoi se kishin shpëtuar dy sahabët e mrekullueshëm të tij, u gëzua pa masë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), pati qenë lutur për ata pesëmbëdhjetë ditë apo rreth një muaj. Në mëngjesin e Bajramit të Ramazanit, e pati lënë këtë lutje. Kur Umeri (r.a.), e pyeti për shkakun e kësaj, ai iu përgjigj duke i bërë këtë pyetje: "A nuk e di se ata kanë ardhur?" Pikërisht në ato momente, u hap rruga dhe Velid ibn Velidi (r.a.), po i sillte kushërinjtë e tij. Kur Velidi (r.a.), arriti te i Dërguari i Allahut, e dorëzoi shpirtin e tij (ndërroi jetë). Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), tha për atë: *"Ky burrë është dëshmor. Unë jam dëshmitar për këtë!"* (Ebu Davud, Vitri, 10/1441)

Seleme ibn Hishami (r.a.), tashmë u qetësua. Ai po përjetonte lumturinë e takimit me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ai e falte namazin pas Pejgamberit në Mesxhidu'n-Nebevi, i shërbente atij duke zënë vend në shoqërinë e afërt të tij dhe frekuentonte kuvendet fetare që mbante ai (a.s.). Seleme (r.a.), nuk i ndante aspak sytë nga Dielli i dy botëve, i Nderuari ynë (a.s.). Gjithashtu mori pjesë edhe në luftërat e tjera bashkë me të. Ai qëndroi në Medinë deri kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (a.s.).

Në një moment përgjatë luftës së Mu'tes, muxhahidët u detyruan të tërhiqeshin pas. Kur u kthyen në Medinë, disa persona filluan të thoshin "furrar / dezertues nga lufta" për ata. Seleme ibn Hishami (r.a.), u shqetësua shumë nga kjo fjalë. Për këtë arsye, nuk doli në xhami për të falur namazin për pak kohë.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e kuptoi gjendjen dhe tha për ata: *"Seleme dhe shokët e tij nuk janë "ferrarun / dezertues nga lufta", por janë "kerrarun / tërhequr pas për një sulm tjetër të ri"*. Pastaj kërkoi që Seleme ibn Hishami (r.a.), të dilte nga shtëpia. (Vakidi, II, 764-765; Ibnu'l-Esir, II, 284.)

Seleme ibn Hishami (r.a.), mori pjesë edhe në luftërat që u realizuan në anën e Sirisë në periudhën e kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.). Ndërsa në luftën Merxhis-suffer që u bë me Bizantët në vitin 14 hixhri / 635 e.s. e cila ndodhi gjatë kalifatit të Umerit (r.a.), ra dëshmor. (Ibn Sa'd, IV, 131.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu Teala na bëftë të gjithëve prej atyre që marrin mësim nga emocioni i besimit, besnikëria dhe durimi i Selemes ibn Hishamit (r.a.)! Amin!..

POPULLI I LUTIT DHE HOMOSEKSUALITETI

— Xhihan Tashtan —

Në përfundim të studimeve më të fundit, ka filluar të diskutohet fakti se disa njerëz janë gjenetiksht më të prirë ndaj homoseksualitetit.

Mund të themi lirisht se në ditët tona liria ka fituar imunitet të plotë. Një prej pikave më të diskutuara në vendin tonë, që mbrohet nga një numër i madh i njerëzve, është edhe homoseksualiteti. Frika që ka populli ynë ndaj këtij fenomeni merr shkak prej njohurive që kemi në lidhje me popullin e Lutit. Ngjarja që u përhap tek populli i Lutit është përmendur edhe në Kuranin Kerim dhe gjendja e njerëzve mizorë të Lutit është treguar me gjuhën e ajeteve. Disa njerëz që shikuan dy mysafirët e Lutit, e rrethuan shtëpinë dhe i bënë atij kërkesa të ndyra. Hz. Luti i ofroi vajzat e veta për martesë por ato iu përgjigjen: “A nuk ta kemi ndaluar ne që të presësh mysafirë?” (Hixhr, 70) duke nxitur zemërimin hyjnor... Kjo nuk është një ngjarje prej të cilës duhet të marrim vetëm mësimin e qartë për poshtërimin e njerëzve që bëjnë veprime të pamoralshme... Një shkak tjetër që e çoi këtë popull drejt shkatërrimit është edhe liria e të shfaqurit haptas të këtyre sjelljeve në publik. Sjellje që nuk u ndaluan prej askujt.

Sipas studimeve shkencore dhe në veçanti atyre gjenetike, njerëzit që kanë lirinë e realizimit të dëshirave të tyre fillojnë ta mësojnë trupin me një sjellje të tillë. Studiuesit që merren me lidhjet sociale mes njerëzve, kanë zbuluar se njerëzit që kanë sjellje homoseksuale prodhojnë sasi të mëdha të hormonit progesteron. Ky hormon prodhohet edhe tek njerëzit e tjerë dhe në periudha të caktuara shënon rritje dhe ka rol të rëndësishëm në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Studimet e bëra me disa njerëz homoseksualë tregojnë se vihen re sasi të mëdha të këtij hormoni. Ky hormon që ndikohet nga gjendja jonë shpirtërore dhe faktorët e jashtëm, është i domosdoshëm për feminitetin dhe mashkullorësinë. Mund të mendohet se homoseksualët vetë-krijojnë

një gjendje të favorshme për prodhimin e tepërt të këtij hormoni. Për këtë arsye, “liria e pakufizuar” mund të përgatisë terrenin e përshtatshëm për hapjen e një sjelljeje të tillë. Parashikohet se kjo ndikon edhe në prishjen e ekuilibrit hormonal, duke e bërë shumë të vështirë kurimin.

Në përfundim të studimeve më të fundit, ka filluar të diskutohet fakti se disa njerëz janë gjenetiksht më të prirë ndaj homoseksualitetit. Janë bërë studime me kromozomet X, që gjenden tek femra ose mashkulli dhe po shtohet mundësia e ekzistimit të një pjesë ADN-je që ndikon në gjenin homoseksual. Shumë studime po përforcojnë mendimin se në disa prej njerëzve homoseksualë mund të ekzistojë një predispozicion ndaj homoseksualitetit. Njerëz të tillë mund të jenë edhe rrotull nesh; njerëz që Allahu ua ka dhënë këtë sprovë me të cilën duhet të përballen gjatë gjithë jetës së tyre. Për këtë arsye, ne duhet të bëjmë kërkime të vazhdueshme në gjetjen e metodave shëruese për ta dhe duhet t’i shpëtojmë nga përjashtimi prej shoqërisë.

Duhen gjetur metoda shërimi për këta njerëz që nuk ua tregojnë dot shqetësimin e vet as njerëzve më të afërt dhe që mundohen t’i shtypin këto impulse që feja i cilëson si gjynahe. Mbase Ministria e Shëndetit mund të sjellë psikologë dhe mjekë të veçantë. Një shërbim i bazuar në ruajtjen e sekretit mund të bëhet shkak për të shpëtuar këtë botë dhe ahiretin e këtyre njerëzve. Sepse ne jemi prej atyre që “urdhërojmë të mirën, e ruajmë shoqërinë prej së keqes”, ne kërkojmë rrugët e bukura, “nuk vështirësojmë, por lehtësojmë”.

Burimi:

Testing the Affiliation Hypothesis of Homoerotic Motivation in Humans: The Effects of Progesterone and Priming. Archives of Sexual Behavior. Nëntor 2014

Sa herë që shikojmë lart në qiell, kuptojmë edhe një herë bukurinë unike të universit. Krijuesi i gjithësisë ka thënë në Kuranin Kerim: **“Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.”** (Mulk, 3-4) Çdo trup qiellor lëviz me rregullsinë e një ore. Gjatë lëvizjes nuk ndodh asnjë gabim. Prova më e afërt e kësaj rregullsie është sateliti ynë i vetëm natyror: Hëna. Ajo sillet rreth nesh por edhe rreth vetes. Duke qenë se periudha që bën për t’u sjellë rreth nesh është pak a shumë e njëjtë me atë që bën për t’u sjellë rreth vetes, ajo na tregon vazhdimisht vetëm njërën anë. Gjithsesi kur e shikojmë atë dallojmë disa zona më të errëta e disa më të hapura. Nëse e shikojmë Hënën me dylbi ose teleskop do të shohim se në sipërfaqe të saj gjenden disa gropa. Shkencëtarët këto gropa i quajnë me emrin: kratere.

Krateret më të mëdhenj kanë emra të përveçëm. Hëna nuk ka atmosferë si Toka jonë prandaj ajo nuk ka asnjë mbrojtëse. Ajo është e pafuqishme ndaj kërcënimeve të jashtme. Për këtë arsye, teksa numri i kraterëve në planetin tonë blu mund të numërohet me gishtat e njëres dorë, Hëna ka mijëra kratere. Kur e mësojmë këtë gjë kuptojmë se kemi një arsye më shumë për të falënderuar Krijuesin e Gjithësisë. Sikur as ne të mos kishim atmosferë kushedi si do të përfundonim!

Rrezja e mikeshës sonë të Bardhë është sa një e katërta e rrezes së planetit tonë. Distanca mes Hënës dhe Tokës është 385.000 km. Pra, nëse një astronaut në hënë ndez një dritë, ne do ta shikojmë vetëm pas një sekonde. Meqë ra fjala tek astronautët, le të flasim pak për udhëtimet në Hënë.

Në vitin 1950 USA dhe Bashkimi Sovjetik filluan një garë të fuqishme, qëllimi kryesor i secilit shtet ishte dërgimi i një mjeti hapësinor në Hënë. Garën

HËNA

NJË PJESË E JONA

Muaz Erdem



e fitoi Bashkimi Sovjetik që në vitin 1959 dërgoi mjetin e parë hapësinor në Hënë (Luna -9). SHBA nuk hoqi dorë dhe filloi përpjekjet për dërgimin e njeriut të parë në Hënë. Nuk kaloi shumë kohë dhe pas vështirësive të pafundme misioni përfundoi me sukses. Fjalja: “Ky është një hap i vogël për mua por një hap gjigand për njerëzimin.” i takojnë Neil Armstrongut, njeriut të parë që shkeli në Hënë. Në këtë mënyrë SHBA vendosi superioritetin e vet në fushën e udhëtimeve hapësinore. Pas kësaj u organizuan edhe 5 udhëtime të tjera në Hënë, të gjitha përfunduan me sukses.



“O ju që keni besuar! Me të vërtetë, pijet alkoolike

(që e mbulojnë mendjen dhe gjërat e tjera të ngjashme me to), **bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?” (Maide, 90-91)**


Gjërat që i bëjmë në mënyrë automatike duke i nxjerrë nga kontrolli i mendimit i quajmë zakone. Me të vërtetë, mekanizmi që mundësojnë zakonet ka një vend të rëndësishëm për lehtësimin e jetës sonë të përditshme. Vetëm se kur zakonet bëhen kronike deri në atë masë sa që ta pushtojnë të gjithë jetën, detyrimisht njeriu mbyllet ndaj të tjerëve dhe bie në një gjendje të papërputhshme me atë të shoqërisë. Nisur nga ky aspekt, zakoni është një fenomen i gabuar. Kurani Fisnik, i cili e vendos në qendrën e aktiviteteve njerëzore të menduarit dhe prodhimin e mendimit, sigurisht që nuk e lejon një qëndrim të tillë. Por njeriu e ka mundësinë për të reaguar ndaj paralajmërimeve pozitive që mund të bëhen, për të hequr dorë nga gabimi dhe për ta rivënë në funksion mendimin dhe vullnetin e tij edhe pse kjo e fundit është e vështirë. Krahas që jeta ka hyrë në monotoni, mendja dhe mendimi i njeriut nuk do të thotë se nuk ekzistojnë edhe pse mund të jenë pasivë. Ndërsa zakonet që njihen si zakone të këqija, që e sulmojnë drejt për së drejti shëndetin shpirtëror, që e nxjerrin plotësisht jashtë funksioni vullnetin, mendjen dhe që e zhveshin njeriun nga pozita e tij e nderuar, janë shkatërrues me çdo aspekt të tyre. Ja pra, në këtë artikull do të merret në qendër varësia ndaj alkoolit që i përfaqëson zakonet e tjera të këqija.

Zakoni i alkoolit ishte mjaft i përhapur edhe në periudhën kur erdhi Islami siç është i përhapur në ditët e sotme. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e filloi detyrën e predikimit të Islamit në një shoqëri që bashkëjetonte me alkoolin. Ndalea e alkoolit që erdhi në periudhën e Medinës, e arriti qëllimin e saj në një kohë të shkurtër. Për arritjen e këtij suksesi u bë shkak edhe gradualiteti, pra, përhapja në kohë e dispozitave në lidhje me alkoolin duke e shtuar dozën vazhdimisht në përputhje me natyrshmërinë e njeriut. Në ajetin e parë prej ajeteve që kanë të bëjnë me këtë çështje (Nahl, 67), u tregua në mënyrë indirekte se çështja e alkoolit do të vihet si dispozitë nga Kurani Fisnik. Më vonë, u nxor në pah e vërteta se mëkati i bërë

për shkak të alkoolit është më i madh se dobia e përfutuar prej tij (Bakara, 219) Pas pak kohe, u vendos ndalesa e parë e kufizuar në formën e “mosfaljes së namazi në gjendje të dehur”. (Nisa, 43) Në secilën prej këtyre fazave një pjesë prej sahabëve e patën lënë konsumimin e alkoolit. Më së fundi, alkooli u ndalua në formë të prerë me anë të ajeteve 90-91 të sures Maide që janë përmendur në krye të këtij shkrimi për të formuar temën e këtij të fundit. Sapo u dëgjua lajmi për ndalimin, fuçitë dhe enët me alkool u boshatisën. Nëpër rrugët e Medines u formuan përrenj të vegjël me pije. Atë kohë ishte viti 10 hixhri apo 632 gregorian.

Përgjatë rrjedhës së historisë e dimë se një tablo e ngjashme me këtë ka ndodhur edhe në disa qytete në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Kur konsumimi i alkoolit në këtë vend arriti tre fishin e shifrave të sotshme përgjatë viteve 1800, disa grupe prej popullit u shprehën se duhet të ndalohet pirja e alkoolit duke hedhur sloganet se alkooli është i dëmshëm për trupin dhe është mëkat. Pas shumë debateve të gjata, konsumimi, prodhimi, shitja, eksporti, importi dhe transporti i pijeve alkoolike u ndaluan në shkallë vendi me anë të një ligji (1919) dhe për zbatimin e ndalimit të alkoolit u ngarkuan me detyrë 1520 policë federalë. Kjo periudhë që përfshinte kohën ndërmjet viteve 1920-1933 u emërtua “Eksperimenti Fisnik” (The Noble Experiment). Fotografitë që i përkasin periudhës së zbatimit të ndalesës, reflektojnë skenat e derdhjes nëpër rrugë nga ana e policëve të ngarkuar me këtë detyrë të birrave të prodhuara në të zeze. Por ja që ndalesa, ndërkohë që mbështetej nga një pjesë e popullit, kundërshtohej një pjesë tjetër e tij. Për këtë arsye, njerëzit filluan të protestonin nëpër rrugë nën sloganin “We won’t beer/ duam birra”. Këto protesta morën fund me heqjen e ndalesës për pijet alkoolike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Cilido qoftë preteksti i çfarëdo lloj kundërshtimi, që mund të bëhet kundër ndalesës së pijeve alkoolike, prapë se prapë nuk ka dyshim që alkooli është një fatkeqësi për njerëzimin. Për këtë arsye, këtu



nuk e shohim të arsyeshme që t'i përmendim dëmet që alkooli i shkakton njeriut. Orvatjet e pabaza si "pak nuk të bën zarar" janë shumë larg të vërtetës. Këtë fakt e tregon qartë konsumimi i alkoolit që po shtohet shumë çdo vit dhe rezultatet e tmerrshme të këtij shtimi.

Ndalesa e alkoolit që solli Kurani Fisnik korri një sukses absolut në një kohë të shkurtër. Kjo korrije suksesi u realizua në sajë të përhapjes së zbatimit në kohë, por krahas kësaj ka edhe disa faktorë të tjerë të cilët duhet t'i kemi parasysh.

Shoqëria që u lartësua me dispozitat e Kuranit Fisnik përbëhej nga njerëz me personalitet, të edukuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.), të vetëdijshëm dhe që kishin ndjenja të larta shpirtërore në nënshtrimin ndaj Zotit që i përgjroheshin: "Na udhëzo në rrugë të drejtë, o Zot!" Ata hoqën dorë nga alkooli jo për ndonjë shkak material apo interes, por ngaqë e bëri haram Allahu i Madhëruar. Kur erdhi dispozita e prerë që e ndalonte alkoolin, Umeri (r.a.), shfaqti nënshtrim ndaj saj duke u shprehur: "Intehejna, Intehejna / hoqëm dorë, o Zot, hoqëm dorë!" (Nesai, Eshribe, 1.) Kur lajmi i ndalesës u përhap te të gjithë njerëzit, të gjithë i derdhën qypat me alkool që kishin. Për shkak të kësaj, nëpër rrugë u formuan përrenj të vegjël prej alkooli. Asnjë hezitim dhe asnjë pakënaqësi nuk u shfaq kundrejt kësaj ndalesë. Enes b. Maliku (r.a.), thotë: "Kur na lajmëruan se alkooli ishte bërë haram përgjatë një mbledhjeje që po u jepja alkool atyre që kishin marrë pjesë, më thanë: Menjëherë derdhe alkoolin që ka mbetur! Edhe unë e derdha. Pastaj nuk kemi pirë më alkool ndonjëherë tjetër." (Nesai, Eshribe, 2.)

Fuqia pas kësaj tabloje të mrekullueshme që nxorën në pah pasuesit e Islamit, i cili e vendosi këtë ndalesë, ishte sinjeriteti, ndërsa pas dështimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte mungesa e sinjeritetit. Numri i policëve të ngarkuar me detyrën për ta kontrolluar këtë ndalesë ishte vetëm 1520 në të gjithë atë vend të stërmadh, mund të konsiderohet si një fakt që e vërteton këtë. Ndoshta këtë e tregon edhe kjo shprehje e shkencëtarit të famshëm Julius Hirschit (1892-1962): "Muhamedi (a.s.), e ndaloi alkoolin me anë të Kuranit. Përgjatë shekujsh, shoqëri të mëdha njerëzore u mbrojtën nga dëmet e alkoolit. Ky rezultat nuk u arrit dot në Amerikën e ndritur të shekullit të 20-të krahas çdo

lloj propagande dhe paralajmërimeve shkencore." (Julius Hirsch, "Mbrotja e shëndetit – Libër mësimor", Stamboll 1938, Botimet e Universitetit të Stambollit, nr: 34, fq. 242.)

Çdo gjë që është në kundërshtim me cilësitë e krijimit (natyrshmërisë) së njeriut, është në kundërshtim edhe me Islamit që është "feja e natyrshmërisë". Kjo e vërtetë gjendet në bazën e ndalimit të çdo lloj pijeje që shkakton dehe dhe vartësi. I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk zgjodhi pijen dehëse, por zgjodhi qumështin kur iu paraqitën këto dy pije në miraxh. Si rezultat, ai u njoftua se veproi sipas natyrshmërisë njerëzore. Edhe ky fakt e vërteton atë që thamë më sipër. (Buhari, Ehadithu'l-Enbija, 22.)

Ndalimi i individit apo i shoqërisë për të mos pasur kontakt me alkoolit, dilte në pah si një mënyrë e rëndësishme për frenimin e zakonit të alkoolit në ftesën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Pejgamberi i nderuar ka thënë: "Unë nuk jam dërguar si mallkues." Por në të njëjtën kohë thotë: "Allahu e mallkoftë pijen, atë që e pi, atë që e servir, atë që e shet, atë që e merr, atë që e bën, atë që urdhëron të bëhet, atë që e mbart dhe atë që urdhëron për mbartjen e saj!" (Ebu Davud, Eshribe, 2.) Këtë hadith fisnik duhet ta shtjellojmë në kontekstin që thamë pak më lart.

Ajo që pranohet sipas shumicës së dijetarëve, pra, mendimi se vera nuk është e ndytë shpirtërisht, por fizikisht, duhet të shtjellohet në kontekstin e mësipërm. Prandaj, vera duhet të pranohej e ndytë fizikisht, në mënyrë që besimtari të vendosë një largësi reale me të. Ja pra, mospërhapja e pijeve alkoolike në shoqëritë islame përgjatë shumë shekujsh kur ka sunduar ndjeshmëria fetare ishte rezultat i të gjithë këtyre faktorëve. Kjo mundësi gjithmonë do të jetë para njerëzve për sa i përket ndalimit të alkoolit.

Ndërkohë ka edhe një shprehje të mbushur plot me "pasion" që thotë: "Kur vera zihet, e humb vetinë e të dehurit. Për këtë arsye, nuk ka ndonjë ndalesë për ngrëniën e ushqimeve të përgatitura me verë." Krahas dispozitës juridike të kësaj shprehjeje, këtu do të ishte me vend ta thoshim qartë se sa larg është ajo me frymën e Kuranit Fisnik dhe Traditës së të Dërguarit të Allahut (a.s.).



Abdullah ibn Amri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:


“Unë jam dërguar vetëm si mësues...”

(Ibn Maxhe, Sunnet, 1.)

“Po falnim namaz bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Kur teshtiu njëri prej xhematit, atij i thashë: ‘Jerhamukall-llah / Allahu të mëshiroftë!’ Befasisht të gjithë filluan të më shikonin ters. Kur u thashë: ‘Çfarë ndodhi? Përse më shikoni ashtu?’, filluan t’i rrihnin gjunjët me duart e tyre. Kur e kuptova se deshën të më bënin të heshtja, u nxeha, por sidoqoftë heshta. I Dërguari i Allahut (a.s.), e mbaroi namazin. Nëna dhe babai i qofshin falë! Unë nuk kam parë mësues që të mësonte më bukur se ai as para tij, as pas tij. Për Zotin, as nuk e vari surratin, as nuk më qëlloi, as nuk më kritikoi. Vetëm më tha: “Ky është namaz. Përgjatë namazit nuk flitet. Namazi është tesbih, tekbir dhe lexim i Kuranit.” (Muslim, Mesaxhid, 33.)

Muavije b. Hakem es-Sulemi (r.a.), i cili ishte prej sahabëve, kështu e mësoi nga i Dërguari i Allahut (a.s.), se nuk flitej në namaz. Edhe shumë sahabë të tjerë kanë kujtime të ngjashme me të, sepse e gjithë jeta e Hz. Pejgamberit ka kaluar me mësimin dhe edukimin e të tjerëve. Allahu Teala e zgjodhi atë si udhërrëfyes i udhëzimit në një kohë kur njerëzit pothuajse e kishin harruar njerëzillëkun, kur vlerat morale kishin degraduar dhe kur injoranca kishte shpallur sundimin e saj. Zoti (xh.sh.), thotë në Kuranin Fisnik: **“Po kështu,** (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) **ju kam sjellë një të Dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron** (nga gjynahet), **ju mëson Librin** (Kuranin) **e Urtësinë** (rregullat e fesë) **dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur.**” (Bakara, 151) Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, thotë: **“Unë jam dërguar vetëm si mësues...”** (Ibn Maxhe, Sunnet, 1.) Hz. Pejgamberi mori si rregull ajetin fisnik në të cilin thuhet: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!..”** (Nahl, 125) Ai u përpoq gjithmonë për ta zbatuar këtë detyrë në çdo kohë dhe në çdo vend me një gjuhë të ëmbël dhe fytyrë të qeshur.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut goftë mbi të, fliste ngadalë dhe qartë aq sa mund ta kuptonin dhe të mësonin ata që gjendeshin pranë tij. Fjalët nga buzët e tij (a.s.), dilnin një nga një. (Tirmidhi, Menakib, 9.) Kur e shikonte të nevojshme, i përsëriste fjalët dhe vepronte me durim dhe largpamësi. Hz. Pejgamberi, duke u shqetësuar prej bezdisjes që mund të ndjenin njerëzit, zgjidhte kohën më të përshtatshme për t’u folur atyre në vend se t’u mbante vaza (ligjërata) të njëpasnjëshme. (Buhari, Ilim, 11.) Ai përpiqej që mesazhet të cilat dëshironte t’i jepte të ishin ndikuese dhe influencuese. Për këtë arsye, nganjëherë i jepte duke treguar histori rreth ngjarjeve që u kishin ndodhur popujve të mëparshëm dhe nganjëherë i jepte duke paraqitur shembuj të veçantë siç e shohim në fjalën e tij: **“Besimtari u ngjan të mbjellave të gjelbra.”** (Buhari, Tevhid, 31.) Nganjëherë e fillonte bisedën duke u shprehur: **“A e dini se kush është i falimentuari?”** Në këtë mënyrë, e merrte të gjithë vëmendjen e të pranishmëve dhe e përgatiste mendjen e tyre për temën që do të shtjellonte. Ai u jepte rëndësi faktorëve vizualë dhe e përdortë shumë mirë gjuhën e trupit. Një grup që përbëhej nga të rinj që erdhën për të marrë informacion prej tij rreth Islamit, i porositi duke u thënë: **“Faleni namazin siç më shikoni mua duke e falur.”** (Buhari, Ezan, 18.) Ndërsa një herë tjetër, e shpjegoi duke vizatuar forma në rërë lidhjen ndërmjet shpresave që ka njeriu, vështirësive që i ka në këtë botë dhe exhelit/vdekjes. (Buhari, Rikak, 4.) Pyetjeve që i drejtoheshin, u jepte përgjigje duke marrë parasysh gjendjen e pyetësit dhe vepronte sipas parimit të lehtësimit. Kur Seleme b. Sahri (r.a.), i cili u bë pishman për një faj që e kishte bërë në muajin e Ramazanit, u përball me reagimet e ashpra të të afërmeve të tij kur ua tregoi situatën, nuk e mbajti dot veten pa u thënë kështu të afërmeve pasi shkuan te i Dërguari i Allahut (a.s.), pasi e diskutuan çështjen me të



dhe pasi ai u tregoi rrugën më të përshtatshme për shpagimin e gabimit: “Unë gjeta te ju logjikë të ngushtë dhe moskuptim. Ndërsa te i Dërguari i Allahut (a.s.), gjeta tolerancë dhe mirëkuptim.” (Ebu Davud, Talak, 16-17.) Të qenët tolerant ishte prej cilësive më dalluese në metodën e edukimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Hz. Pejgamberi i tërhoqi vëmendjen një beduini që bëri urinën në xhami (Ibn Maxhe, Taharet, 78.) dhe i qetësoi sahabët e tij që deshën ta sulmonin me zemërim duke u thënë: “*Ju jeni dërguar si lehtësues, jo si vështirësues.*” (Tirmidhi, Taharet, 112.) I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, edhe kur shikonte apo njoftohej se ishte bërë një gabim serioz, prapë se prapë nuk lëndonte asnjë, por e fillonte fjalën pa dhënë emër dhe duke u shprehur: “*Çfarë po u ndodh disave që...*” (Muslim, Fedail, 127.) Në këtë mënyrë e tregonte gabimin e bërë dhe nuk fliste rreth njerëzve që gabonin, por fliste rreth gabimeve të bëra. I Dërguari i mëshirës sillej edhe me më shumë butësi kur u mësonte diçka fëmijëve dhe të rinjve. Bisedën me të rinjtë e fillonte duke u shprehur: “Bir/bijë!..”, nganjëherë ua përkëdhelte kokën (Ebu Davud, Salat, 28.) dhe formonte një marrëdhënie të mbështetur në dashuri me ata. I Dërguari i Allahut (a.s.), u jepte atyre mundësinë për ta kuptuar dhe për ta rregulluar gabimin dhe nuk i largonte ata prej vetes duke reaguar me tepër seç duhet. Një herë, një të ri që i tha se dëshironte të bënte imoralitet e kishte pyetur: “A do dëshiroje që të bëhet imoralitet me nënën tënde?” Sikundër përgjigjes që i dha i riu në formën: “Sigurisht që nuk dua.”, të njëjtën pyetje ia bëri veç e veç edhe për vajzën, hallën, tezen dhe motrën e tij. Për çdo herë që ia bëri pyetjen, i Dërguari i Allahut (a.s.),

mori përgjigjen “jo”. Pastaj i tha të riut: “Askush nuk dëshiron që të bëhet imoralitet me nënën, me motrën apo me ndonjë të afërme tjetër të tij.” Pastaj u lut për faljen e mëkateve të atij djali të ri. (Ibn Hanbel, V, 256-257.)

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, përgjatë periudhës njëzet e tri vjeçare si pejgamber, ua mësoi sahabëve të tij mesazhet hyjnore me butësi dhe dashuri siç e “mëson një baba fëmijën e tij”. (Nesai, Taharet, 36.) Më e rëndësishmja është se ai (a.s.), ua mësoi fenë të tjerëve duke e përjetuar vetë. Pra, të gjitha mesazhet hyjnore i shndërroi në shembuj konkretë. Sa pari u besoi dhe i praktikoi vetë të gjitha urdhrat dhe ndalesat hyjnore. Pastaj priti që t’u besonin dhe t’i praktikonin edhe të tjerët. Ai u mësoi njerëzve se vdekja nuk është zhdukje dhe u tha atyre se njerëzit janë robër dhe vëllezër të barabartë të Allahu Teala. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, theksoi se epërsia ishte vetëm te devotshmëria dhe se dashuria ndaj Allahut Teala dhe të Dërguarit të Tij vinte para çdo gjëje. Ai u shpjegoi njerëzve se çdo gjë në natyrë është argument për ekzistencën e Allahut dhe se as edhe një gjethe nuk bie pa lejen e Atij. Në këtë mënyrë, së pari u ndërtoi mendjet dhe pastaj ua lartësoi shpirtat. Ata i edukoi me mirësi që do t’ua mundësonin të ndërtonin edhe këtë botë, edhe botën tjetër. Ata i mbarti në pikën më të lartë të civilizimit duke i pajisur me informacione që përfshinin çdo fushë të jetës duke filluar nga cilësitë më të larta të moralit e deri te çështjet më të thjeshta si rregullat e hyrjes në tualet. Mbi të gjitha, ua mundësoi atyre që të bëheshin një shoqëri shembullore për brezat e ardhshëm.



SHKOLLA E UNIVERSTIT

Gjithësia, Kurani dhe Njeriu - 4

Pas luleve, nëpër degët e pemës dalin gjethet.

Po ashtu, edhe gjetet të cilat shfaqin tone të ndryshme të ngjyrës së gjelbër, na falin qetësi dhe rehati shpirtërore, duke na bërë të sodisim një pamje tepër të veçantë. Gjetet janë si panele diellore për arritjen e fotosintezës. Në të njëjtën kohë, ato janë edhe ushqim për shumë krijesa përreth pemës, por edhe hije në klimat e nxehta...



MEDITIMET RRETH BORËS

Në stinën e dimrit bie borë. Përveç njëmijenjë urtësive që bart, ajo e zbukuron tokën me pamjen e saj të bardhë, si dhomën e një nuseje. Në stinën e dimrit, kur netët zgjaten dhe errësitat shtohen, ajo i rehaton soditësit me ngjyrën e saj të bardhë. Po sikur bora që bie prej qiellit të ishte në ngjyrën e tmerrshme të gjakut, ose në ngjyrën e zezë që të kujton zinë dhe papastërtinë, kushedi sa e vështirë do të ishte për ne! Njerëzimi do të çmendej!

Poshtë asaj bore të akullt, në gjirin e tokës ruhen me mijëra gjallesa pa ngrirë dhe pa ngordhur. Kur vjen pranvera dhe shkrin bora, mbi tokë nuk dalin kufomat e insekteve, por lloj-lloj krijesash. Allahu i Madhëruar, tregon me argumente se arti i Tij i veçantë nuk është i kufizuar me kushte. Për shembull, në stinën e dimrit ku shumica e bimëve nuk mund të mbijetojnë, Allahu ka krijuar luleborën që çel nën borë.

Lulebora... mirësi mbi mirësi...

“Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!”

Po të ishin lulet e tjera, do të thaheshin, do të ngrinin, e do të kalbeshin. Mirëpo, luleborat janë manifestimi i artit hyjnor në kushtet më të vështira. Edhe kaktuset që janë si depo uji në shkretëtirë, janë arti i Tij... Arte të veçanta në çdo stinë, në çdo rrethanë...

Allahu i Madhëruar, me fuqinë dhe artin e tij të pakufishëm, hap para nesh dritare për lloj-lloj meditimesh... Ndonjëherë, prej një muri apo prej një guri bën të mbijë një pemë fiku dhe duke e gostitur njeriun prej frutave të tij, Ai i jep atij edhe një mësim jete, që ai të mos dëshpërohet. Nisur nga kjo, mund të themi se njeriu duhet të përpiqet gjithmonë duke përdorur shkaqet. Kur ai i mbështetet plotësisht Allahut, ndihma hyjnore i shfaqet atij edhe në kushtet më të pamundura!..

Ka lule të tilla, që rriten vetëm në lartësi të mëdha... Ka fruta të tillë, që bëhen vetëm në klimë të veçantë... Fruta të veçantë për vende të ndryshme dhe mirësi që plotësojnë nevojat e njeriut...



Çdonjëra prej tyre është një mister më vete...

Le të meditojmë mbi një pemë frutore që prej një fare të vogël kthehet në filiz, nga filizi në fidan dhe nga fidani në një pemë:

Ajo ka një program që e përsërit çdo stinë. Ka një kalendar të vetin. Duket sikur brenda asaj peme prej së cilës nuk shohim gjë tjetër përveç drurit, ndodhet ndonjë kompjuter. Ndodhet një dhomë kontrolli dhe prej aty vijnë të gjitha urdhrat, të cilat zbatohen pa asnjë ndërprerje:

Kur vjen koha, pema në fillim çel lule, të cilat me ngjyrat, format dhe aromat e tyre janë myzhde për njerëzit në stinën e pranverës. Po ashtu, ato tërheqin edhe insektet dhe zogjtë që do të bartin farat e tyre.

Pas luleve, nëpër degët e pemës dalin gjethet. Po ashtu, edhe gjethet të cilat shfaqin tone të ndryshme të ngjyrës së gjelbër, na falin qetësi dhe rehati shpirtërore, duke na bërë të sodisim një pamje tepër të veçantë. Gjethet janë si panele diellore për arritjen e fotosintezës. Në të njëjtën kohë, ato janë edhe ushqim për shumë krijesa përreth pemës, por edhe hije në klimat e nxehta...

Më në fund, prej sythave që mbesin pas luleve, fillojnë të shfaqen fruta, të cilat megjithëse ushqehen prej së njëjtës tokë dhe ujë, ato kanë ngjyra, shije dhe cilësi të ndryshme.

Çdo pemë e thith ujin prej tokës sikur të ketë pompë në rrënjët e saj dhe e shpie atë deri në gjethen më të largët të saj. Madje, duke mos krijuar asnjë rrjedhje të ujit.

Të gjitha frutat janë të pajisura me lëkura apo lëvore të ndryshme. Një lloj fruti ka lëkurë shumë të hollë, një tjetër shumë të trashë si mushama, ndërsa një tjetër të fortë si copë druri... Kjo është pasuria e artit të bukur hyjnor... Këto lëkura apo lëvore janë pothuajse si një termos i cili ruan ushqimin që ndodhet brenda.

Në përgjithësi, frutat nuk mund të rezistojnë shumë pasi u është hequr lëkura. Ato fillojnë të tharohen, të prishen, të thahen, ose të nxihen. Në këtë gjendje, ato mund të ruhen pak më shumë në frigoriferë ose me anë të substancave kimike.

Mirëpo, shumë prej frutave mund të rezistojnë edhe me muaj të tërë brenda lëvores së tyre që është si termos. Ja pra, këto janë mistere që thellohen edhe më shumë kur meditohet mbi to.

Shumë prej frutave përmbajnë farën e llojit brenda vetes. Në këtë mënyrë, pema, e cila nuk ka mundësi të ecë, e të lëvizë, arrin të sigurojë vazhdimësinë e llojit të vet duke gëstitur krijesat me frutat e saj.

Kush është Ai që e ka shkruar këtë program të përsosur në mënyrë të veçantë për çdo lloj dhe ka vendosur brenda tyre farën?

Le të vazhdojmë të meditojmë mbi mirësitë e panumërta hyjnore:

A e kemi menduar ndonjëherë se çfarë mirësie është hija?

Allahu i Madhëruar urdhëron:

A nuk e ke parë ti se si Zoti yt e ka zgjatur hijen?! Sikur të kishte dashur, do ta bënte të pandryshueshme? Pastaj Ne e kemi bërë Diellin udhëzues të saj. (Furkan, 45)

Sikur Allahu i Madhëruar të mos e kishte caktuar ligjin ekzistues të rrotullimit të Tokës rreth Diellit, ose ta kishte krijuar sistemin tonë diellor me më shumë se një yll në qendër të këtij sistemi, siç edhe janë zbuluar të tillë në pjesë të ndryshme të universit, ose të mos kishte krijuar mundësi që do të formonin hije në tokë, siç janë pemët apo gjëra të ngjashme, duke e lënë tokën si një shkretëtirë, ne do të vuanim për pak hije.

Brenda oqeanit të këtyre mundësive të panumërta, njeriu duhet të mendojë edhe për trupin e vet:

MIRËSIA E SYRIT

Syri është një copë dhjami për afërsisht pesë gram. Ky organ i mrekullueshëm i trupit tonë, fotografon në mënyrë të vazhdueshme dhe imazhet e tij ruhen në memorien që gjendet në trurin tonë. Herë pas here, njeriu i hap ato imazhe dhe i sjell para syve për t'i kujtuar.

Po të thoshin, “*më jep syrin, merre gjithë botën!*”, kush do ta pranonte një gjë të tillë?

Po të thoshin, “*më jep veshin, bëhu shurdh dhe merr gjithë botën!*”, kush mund të hiqte dorë nga mirësia e dëgjimit?

Ne gëzohemi me këto mirësi, por jemi të detyruar që të meditojmë edhe çmimin e tyre... Sepse të gjitha këto mirësi e kanë një çmim. Dhe ky çmim, është falënderimi. Pra, këto mirësi duhet t'i përdorim jo në kundërshtim të vullnetit të Krijuesit, por për të fituar kënaqësinë e Tij. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tua-ja, e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”
(Nahl, 78)

Për atë që nuk falënderon, pra, për atë që nuk e përdor sipas qëllimit të saj mirësinë që i është dhënë, që e përdor syrin dhe veshin në punë të këqija, do të ketë një llogari shumë të rëndë në lidhje me atë mirësi. Dhe, llogaria që nuk arrihet të jepet për këto mirësi, do të jetë një shkatërrim për të zotët e saj. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Mos vallë keni menduar se Ne ju kemi krijuar kot dhe se nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)!?”
(Mu'minun, 115)

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”
(Kijame, 36)

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur!”
(Duhan, 38)

“O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi. E, që të ka mburjuar në çfarëdo forme që ka dashur!?”
(Infitar, 6-8)

Nisur nga kjo, nëse një njeri që vjen në këtë botë i verbër, ose i shurdhër, shpëton nga rënia në gjynah për shkak të kësaj të mete dhe nuk rebelohet për shkak të saj, kjo gjendje e cila në dukje është shkak hidhërimi, në të vërtetë, do ta çojë atë drejt lumturisë. Njerëz të tillë, do të gëzohen pamasë në botën tjetër:

Ata do të thonë: **“Mirë që kam qenë i verbër, i shurdhër, e nuk jam përlyer me gjynahe! Elhamdulilah!”**

Një prej manifestimeve hyjnore të mëshirës në krijim, është edhe ky fakt:

Allahu i Madhëruar, personave të cilëve nuk

u ka dhënë shqisën e shikimit, u jep një fuqi të veçantë tek shqisat e tjera. Veshi i një të verbri, ndjenja e prekjës, ose memoria e tij, është më e zhvilluar dhe më e fortë se tek njerëzit që e kanë shqisën e shikimit. Kjo është fuqia dhe bujaria e pafundme e Zotit tonë...

Kështu është edhe varfëria me pasurinë. Nëse një i varfër nuk ankohet prej gjendjes së tij dhe është i kënaqur me caktimin e Allahut, kjo mbase do të jetë shkak që ai të fitojë pasurinë e përjetshme në botën tjetër. Por, nëse ai i varfër bëhet i pasur në këtë botë, ka mundësi që pasuria t'ia rrisë egon, e cila do të lindë tek ai iluzionin e fuqisë/pushtetit dhe duke e shtyrë atë në indiferencë, rehati dhe kënaqësi të shfrenuar, do të bëhet shkak i shkatërrimit të lumturisë së përjetshme në botën tjetër. Përfundimi i Karunit dhe Bel'am bin

Bauras, me të cilët njihemi në Kuranin Fisnik, janë shembulli më i qartë i kësaj të vërtete. Sigurisht që edhe e kundërta e kësaj është e mundur.

Shkurtimisht, besimtari duhet të jetë i kënaqur me caktimin hyjnor, duke e konsideruar atë si një mundësi për fitimin e botës së përjetshme. Për këtë arsye, ai duhet të përpiqet të jetojë me durim, mirënjohje dhe dorëzim tek Zoti.

Në një ajet të Kuranit Fisnik urdhërohet:

“...Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni

një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini!”
(Bekare, 216)

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

“Gjendja e besimtarit është me të vërtetë për t'u admiruar, sepse çdo gjendje e tij është një mirësi për të. Një cilësi e tillë gjendet vetëm tek besimtari:

- Nëse ai gëzohet, falënderon. Dhe kjo, është një mirësi për të.

- Nëse e godet një fatkeqësi, ai duron. Dhe kjo, po ashtu është një mirësi për të.”
(Muslim, Zuhd, 64.)

Kjo, është gjendja dhe treguesi i një zemre që është e plotësuar dhe ka arritur njohjen e Allahut. Një zemër e paedukuar, e ka të pamundur ta kuptojë këtë.



Po sikur Allahu i Madhëruar të na krijonte si një prej krijesave të tjera, e jo si njeri?

GOSTITJA E TIJ

Kush mediton mbi këto, kupton se sa mundësi të pasura meditimi madhështor ka falur Allahu i Madhëruar.

Kur njeriu mediton edhe për shkakun e këtyre mundësive të mëdha, ai duhet të falënderojë edhe njëherë. Kjo, sepse krijimi i njëmijenjë mundësive dhe hallkave të njëpasnjëshme nxjerr në pah mirësinë e meditimit, i cili është çelësi i besimit dhe adhurimit që do ta shpëtojnë njeriun, është një prej ndihmave më të mëdha të Allahut ndaj robërve të Tij.

Në sajë të vullnetit dhe krijimtarisë së Allahut të Madhëruar, njeriut i është vënë në shërbim e gjithë kjo botë, pavarësisht pamundësive dhe rreziqeve që ai ka përreth.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”
(Xhathije, 13)

Përballë këtij krijimi, robi duhet të shtojë edhe meditimin, por duhet të jetë gjithmonë edhe në gjendje falënderimi ndaj Allahut për gjithë këto mirësi... Të gjitha këto, na tregojnë faktin se vënia e botës në shërbim të njeriut, është për shkak se ajo është krijuar si vend-sprove dhe mundësi meditimi për njeriun.

Allahu i Madhëruar na fton gjithmonë të meditojmë:

“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!

Qiellin, se si është ngritur?!

Malet, se si janë vënë të patundur?!

Tokën, se si është shtrirë?! (Gashije, 17-20)

Krijimi i devesë, është në përputhje me cilësitë e shkretëtirës ku ajo jeton. Allahu i Madhëruar ka krijuar gjallesa edhe në pole, edhe në fund të oqeanëve, edhe në majat e maleve, edhe në

shkretëtira dhe, tek secila prej tyre ka shfaqur mjeshtërinë e Tij në forma të veçanta.

Ajri që thithim në Tokë, nuk gjendet në çdo vend të hapësirës. Në atmosferën që rrethon Tokën, gjendet oksigjeni në masën e nevojshme për ne, e cila është përafërsisht 21%. Oksigjeni është një gaz i djegshëm dhe, nëse oksigjeni do të ishte pak më tepër i ndjeshëm në ndërveprimin me elementet e tjerë djegës, si karboni, atëherë në botë do të shkakttoheshin vazhdimisht zjarre sapo të ngriheshin pak temperaturat.

Nga ana tjetër, nëse niveli i oksigjenit do të ulej pak më tepër, damarët tanë do të fryheshin. Por nëse niveli i tij do të shtohet pak më shumë, atëherë damarët do të tkurrëshin menjëherë.

Dhe ky është një tjetër shkak për të marrë mësim!

Ne jetojmë mbi tokë në mënyrë të qetë dhe pa e vënë re. Mirëpo, poshtë kësaj toke ndodhet një oqean gjigand zjarri.

Ky oqean magme e shfaq veten herë pas here gjatë tërmeteëve të fuqishme dhe vullkaneëve. Mirëpo, në sajë të vendosjes së maleve si gozhda/kunja në koren e tokës, ne arrijmë të jetojmë mbi këtë oqean zjarri pa u tronditur e lëkundur.

Por le të meditojmë njëherë edhe mbi Diellin, që është burimi i jetës dhe prej të nxehtit dhe dritës së të cilit përfitojmë çdo moment.

OQEANI I ZJARRIT NË QIELLIN TONË

Distanca midis Tokës dhe Diellit, është 150 milion kilometra. Kjo distancë, me shpejtësinë e dritës mund përshkruhet vetëm në tetë minuta. Nisur nga kjo, mund të llogaritim edhe galaktikat, yjet dhe planetët e tjerë!

Është llogaritur se moshë e Diellit tonë është përafërsisht 5 miliardë vite. Nxehtësinë e vet, ai e merr prej oxhakut nuklear në qendër dhe vazhdon të digjet. Për të arritur të kuptojmë madhësinë e Diellit, mund të themi se, brenda tij, mund të vendosen 1 milion e 300 mijë planetë si Toka. Nxehtësia në sipërfaqe të tij, arrin 6 mijë centigradë, ndërsa nxehtësia në brendësi të tij, arrin 20 milionë centigradë.

*Gjithësia,
është si një lloj
komentimi i detajuar
i mrekullisë së Kuranit Fisnik.
Domethënë, Kurani Fisnik është
një univers i përbërë prej fjalëve,
ndërsa universi është një
Kuran pa fjalë.*



“Mos vallë keni menduar se Ne ju kemi krijuar kot dhe se nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115)
“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)
“O njeri, ç’të mashtroni ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi. E, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!”
(Infitar, 6-8)



Nisur nga kjo, mund të themi se, qendra e Tokës është një oqean zjarri, ndërsa Dielli në qiellin tonë, është një tjetër oqean zjarri edhe më gjigand... Mirëpo, Allahu i Madhëruar na dhuron një jetë me freski midis këtyre dy zjarreve.

Nëse njeriu e rafinon shpirtin e tij midis zjarrit të egos dhe shejtanit dhe përparon në njohjen e Allahut, ai do të shpëtojë prej së keqes së tyre.

Në sajë të fotosintezës që bën të mundur Dielli, ne furnizohemi me lule dhe fruta. Në çdo sekondë, Dielli shndërron 564 milion tonë hidrogjen në 560 milion tonë helium. Pjesa e mbetur prej 4 milion tonë e materialit të gazit, shpërndahet si energji dhe dritë.

Nëse i bëjmë llogaritë sipas masës që humbet, del se:

Dielli humbet 4 milion tonë material gazi në sekondë dhe 240 milion tonë në minutë. Mirëpo, materiali që ka humbur dielli deri më sot, është vetëm 1 e 5 mijta.

Drita e Diellit nuk arrin të ndriçojë të gjithë sistemin. Mirëpo, drita e tij vjen deri në atmosferën tonë sikur të jetë brenda një kabloje të izoluar mirë dhe pa rrjedhur aspak. Sapo prek atmosferën tonë, paketa hapet sikur shtypet çelësi i llambës dhe drita e tij fillon të përhapet, duke na shfaqur një botë plot ngjyra. Dhe kur rrezet që vijnë nga Dielli prekin tokën, ai na jep ngrohtësinë e tij, duke siguruar nxehtësinë e nevojshme për të gjitha krijesat. Secila prej krijesave është e varur prej këtij ekuilibri.

Kur ai prek gjethen, siguron rritjen dhe zhvillimin e saj. Ndërsa kur prek detin, ai avullon sasinë e nevojshme të ujit për të siguruar ciklin e shiut...

Dielli udhëton me një shpejtësi shumë të madhe prej 720 mijë km në orë. Por për ku? Nuk dihet!

Ndërkohë, Dielli ynë llogaritet të jetë vetëm një prej 200 miliardë diejve të tjerë që gjenden në galaktikën tonë (Rruga e Qumështit). Me miliardë shfaqje madhështore hyjnore si Dielli! Fuqia dhe mrekullia e pashoqe e krijimit! Mirëpo, një informacion që sot nuk është arritur të zbulohet, Allahu i Madhëruar na e jep si shembull në Kuranin Fisnik:

“Jo! Beto hem në vendin e yjeve! E, ky është betim i madh, veç sikur ta dinit!” (Uakia, 75-76)

Artin madhështor të Allahut të Madhëruar, ne mund ta kuptojmë vetëm brenda një kuadri të thjeshtë e të ngushtë të botëkuptimit tonë.

Ne themi se në det jetojnë peshqit. Por ligji hyjnor, në det ka vendosur perde të padukshme. Peshqit që jetojnë në shtresat e sipërme të detit, nuk mund të zbresin në shtresat e poshtme të tij. Edhe ata që jetojnë në shtresat e mesme, nuk mund të zbresin në shtresat më të ulëta. Po ashtu, edhe gjallesat që jetojnë në fund të detit, nuk mund të dalin në shtresat e sipërme. Secila prej tyre vazhdon jetën e vet në shtresat e padukshme në ujë.

Edhe në fund të detit, aty ku nuk arrin drita e diellit, jetojnë gjallesa dhe peshq të ndryshëm, të cilat Allahu i ka pajisur me lloje të veçanta sysh apo shqisash.

Për shembull, tek lakuriqët e natës dhe shumë krijesa të tjera, gjendet një sistem radari, të cilin njerëzit e kanë zbuluar shumë vonë. Çdo krijesë ka një mënyrë të veçantë jetese, duke filluar që

prej lindjes, rritjes, jetëgjatësisë, etj.

Për shembull, shtatzënia e kangurit dhe mënyra e ushqyerjes së të vegjëlve të saj, ka karakteristika shumë të veçanta. Të vegjlit që lindin pas një shtatzënie të shkurtër prej 30-40 ditësh, hyjnë në xhepin e nënës dhe aty ushqehen me qumështin e saj edhe për nëntë muaj të tjerë. Ky qumësht merr karakteristika të ndryshme në bazë të nevojës së të voglit. Në fillim ai është i pastër si ujë, ndërsa në muajt në vijim, ai bëhet i trashë dhe me yndyrë. Ndërkohë që një këlysh rritet, nëna mund të sjell në jetë edhe një këlysh tjetër. Për këtë arsye, në trupin e kangurit fillon të prodhohet qumësht edhe në bazë të nevojave të të sapolindurit, edhe në bazë të nevojave të atij që është më i rritur, duke ia ofruar atyre si në dy çezma të ndryshme. Por, nëse lind edhe një i tretë, këtë herë fillon të rrjedhë qumësht nga tre gjinj në tre cilësi të ndryshme.

Çfarë mrekullie! Çfarë fuqie madhështore!

Të gjitha janë manifestimet e madhësisë së Allahut!..

Sytë e krijesave po ashtu, janë të shumëllojshme... Disa gjarpërinj kanë sy të tillë, të cilët janë të imituar edhe nga kamerat termale. Ata e shohin prenë e tyre në errësirë në sajë të nxehësisë së trupit.

Shumë specie insektesh, kanë një lloj syri ku me qindra e me mijëra sy si hoje, bëhen një sy i vetëm. Çdo gjë pohon mjeshtërinë e Tij:

“...E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë...” (Neml, 88)

Siç shprehet edhe Zija Pasha:

“E madhëroj Allahun e Lartëmadhëruar, përballë artit të të Cilit mahniten mendjen dhe me fuqinë e të Cilit mbeten pa fjalë edhe dijetarët më të mëdhenj!..”

Me qëllim që njeriu të jetojë në mënyrë të përshtatshme, Toka është krijuar me forma gjeografike si lugina, fusha, male, etj. Nën Tokë vlon zjarri, por mbi të janë krijuar vreshta të gjelbër, kopshte, ara dhe kullota. Pema një mirësi më vete, e hija një mirësi më vete... Sa mirësi e madhe është bari, i cili në sytë tanë s'ka asnjë vlerë, por që me të ushqen bagëtitë të cilat na dhurojnë mishin dhe qumështin e tyre... Një sistem madhështor... Një harmoni e përpiktë...

Secila prej këtyre është një mirësi më vete. Çdonjëra prej tyre është një pamje e mrekullueshme që të bën të meditosh mbi Krijuesin, të dridhesh

nga frika e madhësisë së Tij dhe të shtyn drejt falënderimit ndaj Tij.

PËR NJË POPULL QË MENDON

Për shkak se njeriu jeton brenda këtij sistemi të përpiktë të gjithësisë që prej çastit që ka lindur, ai mësohet me funksionimin e tij në mënyrë korrekte.

Në kohën kur një aeroplan fillon manovrën e ngritjes, pasagjerët njoftohen:

“Nëse oksigjeni pakësohet, do të lëshohen maskat e oksigjenit dhe do të aktivizohen bombolat, të cilat duhen përdorur kështu!..”

Mirëpo, askush nuk shqetësohet duke menduar se, mbase nesër mund të bjerë niveli i oksigjenit edhe në Tokë. Asnjëherë s'kemi frikë se nuk vjen mëngjesi, nuk lind dielli apo nuk vjen pranvera. Mirëpo, ata që arrijnë të meditojnë, e dallojnë edhe sistemin madhështor që gjendet në këto mirësi. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar në shumë ajete fisnike urdhëron:

“...Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë!” (shih. Rum, 21; Xhathije, 13.)

Pra, për ata që dinë t'i shohin këto vitrina hyjnore, hapet edhe kuptimi i këtyre urtësive në mendjet e tyre. Sigurisht që kjo është në bazë të nivelit të zemrës. Ndërsa ata që shohin vitrinat e shejtanit, pra, zemrat që mbyten në gjynahe, janë të verbër dhe të shurdhër ndaj këtyre manifestimeve hyjnore.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë, e as nuk mund t'i bësh të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen tënde, kur të kthejnë shpinën!” (Neml, 80)

Kjo, sepse mohuesit e Allahut, janë si kufoma të gjalla.

Për shembull, le të meditojmë mbi më të pazëvendësueshmen e jetës sonë, ujin:

Pasi bien shirat dhe bora, dielli e avullon një pjesë të ujit që sjellin ato, duke e ngritur përsëri në qiell. Në qiell shëtit një masë uji e barabartë me Detin Mesdhe, i cili bie si shi aty ku dëshiron Allahu. Ky ujë, është i njëjti ujë që përsërit ciklin e shiut që prej kur është krijuar në Tokë. Ai është ushqim për bimët dhe shëtit në trupin e njeriut dhe krijesave të tjera. Ai ndotet, bëhet baltë, e më pas pastrohet duke avulluar dhe kthehet përsëri i pastër në tokë si mëshirë. Nëse do të shkruhej aventura e një gote uji, nuk do të mjaftonin me qindra vëllime.



EL-UEHHAB

AI QË JEP ME BOLLËK PA PRITUR GJË NË KËMBIM

— Ilir Hoxha —

Emri “el-Uehhab” i Zotit tonë të Madhëruar, tregon bujarinë e Tij të pakufishme dhe të pandërprerë ndaj robërve të Tij. Trupi ynë që është si një univers i vogël, ky univers gjigand që është i përshtatshëm që ne të jetojmë lehtësisht me këtë trup, familja ku kemi lindur dhe jemi rritur, dashuria dhe mëshira që ka treguar ajo për ne, fëmijët që janë e ardhmja jonë, mendja që pandehim se e posedojmë dhe çdo gjë që kemi, na janë dhuruar prej Allahut pa paguar asgjë në këmbim. Njerëzit nuk kanë bërë asgjë për t’i merituar këto mirësi të Allahut të Madhëruar. E në fakt, “el-Uehhab”, do të thotë të japësh pa prituri asgjë në këmbim, pa ndonjë arsye apo detyrim.

Emri “el-Uehhab”, është një kallëp që vjen prej rrënjës “hibe/dhurim” dhe shpreh ekzagjerim dhe përsëritje. Po ashtu, ky emër shpreh bollëk dhe vazhdimësi. Allahu është dhuruesi i vërtetë i pakufishëm dhe pakushte i çdo gjëje të vogël e të parëndësishme, e deri tek gjërat e mëdha e të rëndësishme. Për këtë arsye, kur të kërkohet diçka, duhet të kërkohet prej Tij dhe të gjitha nevojat i paraqiten Atij.


Po, Allahu i Madhëruar, është el-Uehhab dhe jep pa prituri asgjë në këmbim. Mirëpo, në mënyrën dhe kohën që dëshiron Ai... Sepse dhënia e Tij, nuk është një pagesë e merituar në këmbim të kryerjes së një detyre, por mirësi e Krijuesit të Madhëruar, i Cili është Alim (që di çdo gjë) dhe Hakim (që bën gjithçka sipas një urtësie). Ata që i besojnë dijes dhe urtësisë së Tij, nuk pyesin dhe nuk kundërshtojnë duke thënë “pse” për çdo gjë që Ai jep (ose nuk jep). Nëse të qenit e Tij el-Uehhab ndahet nga cilësitë e tjera të Tij, të cilat shprehin lavdi dhe madhështi dhe konsiderohet si një detyrim (Allahu na ruajttë), të çon në mendimin se Zoti ynë është

i detyruar të bëjë gjithçka që ne dëshirojmë, gjë e cila duhet ta bëjë njeriun të kontrollojë veten në aspektin e besimit.

Zoti i jep mirësi robit të Tij për shkak se është el-Uehhab, ndërsa robi e adhuron Zotin e vet me të gjitha cilësitë dhe emrat e Tij të bukur për shkak se është Krijuesi i vetëm dhe i pashoq që meriton adhurim. Për një njeri me mendje të shëndoshë, adhurimi i Allahut, është vetëm një falënderim i vogël për Sunduesin e vërtetë të të gjitha mirësive. Përveç kësaj, edhe rregullat e besimit, adhurimit dhe punës, që Allahu i Madhëruar kërkon që ne t’i zbatojmë, janë secila nga një mirësi më vete. Kjo, sepse ato janë shkaqe që Allahu të shtojë mirësitë e Tij mbi ne dhe të na dhurojë lumturinë e të dyja botëve.

Në Kuranin Fisnik, emri el-Uehhab përmendet në tre ajete. Në ajetin 8 të sures Al-i Imran, na mësohet t’i lutemi Allahut që të mos na i devijojë zemrat nga rruga e vërtetë dhe të na dhurojë mëshirë prej Tij, duke u strehuar tek emri i Tij el-Uehhab. Në ajetin 35 të sures Sad, na kujtohet lutja e Sulejmanit (a.s.), drejtuar Allahut, që t’i dhurojë atij një sundim që nuk e ka pasur dhe nuk do ta ketë askush përveç tij, duke u strehuar po ashtu në emrin el-Uehhab. Gjithashtu, ky ajet na mëson me gjuhën e një profeti se gjërat që mund t’i kërkohen Allahut janë të pakufishme. Ndërsa në ajetin 9 të sures Sad, lidhur me ata që e refuzonin profetësinë e Muhammedit (a.s.), thuhet se; **“A mos vallë ata i kanë në dorë thesaret e mëshirës së Allahut”**, duku u kujtuar se Allahu është el-Aziz dhe el-Uehhab.

Gjithashtu, fjala “heb”, që vjen prej fjalës “hibe” në mënyrën urdhërore, përmendet në shtatë ajete



dhe ka kuptimin “dhuro/jep”. Katër prej këtyre janë në formën e kërkesës për pasardhës të mirë, të bërë prej profetëve dhe robërve të devotshëm. (shih. Al-i Imran, 38; Merjem, 5; Furkan, 74; Saffat, 100.) Dy prej tyre janë në formën e kërkesës së sundimit nga ana e Sulejmanit (a.s.), të cilën e përmendëm më sipër dhe të kërkesës për mëshirë nga ana e dijetarëve që e kanë kuptuar thelbin e dijes. (Sad, 35; Al-i Imran, 8.) Ndërsa në ajetin 83 të sures Shuara, na jepet kërkesa e Ibrahimit (a.s.), i cili pasi e ka përkujtuar Zotin e vet në aspekte të ndryshme, i është lutur Atij që t’i dhurojë urtësi dhe ta bëjë pjesë të robërve të mirë.

Çështja kryesore që tërheq vëmendjen tonë në këto shtatë ajete, është kërkimi i gjërave të tilla, arritjen e të cilave nuk e ka në dorë njeriu, siç janë mëshira, urtësia, sundimi dhe pasardhësit e mirë. Dhe kjo tregon se emri el-Uehhab është një mbështetje hyjnore ku robi mund të strehohet në çështjet për të cilat ai është i pafuqishëm. Ashtu siç është e pamundur që robi t’i arrijë me përpjekjet e veta këto kërkesa, ashtu nuk ekziston as edhe një autoritet tjetër përveç Allahut që të mund t’i sigurojë këto.

Ata që dëshirojnë të dhurojnë mirësi ndërmjet njerëzve dhe ia arrijnë kësaj, janë një manifestim i emrit el-Uehhab të Allahut, sepse ndonjëherë, mirësitë dhe begatitë që Allahu dëshiron t’ia japë robërve të Vet, ua dërgon në sajë robërve të tjerë. Në fakt, Allahu është Ai që i jep “dhënësit” mundësinë dhe dashurinë për të dhënë dhe “marrësit” forcën për të përfituar prej atyre mirësive. Ndërkohë që këta njerëz ndajnë mirësitë e Allahut me robërit e Tij, nuk synojnë asgjë tjetër -përfshi këtu edhe afërsi apo mirënjohje shpirtërore-, përveç kënaqësisë së Zotit të tyre. (shih. Insan, 9-10.) Botëkuptimi i tyre

në lidhje me dhënien, është i njëjtë me dorëzimin e një amaneti të zotit të vet. Siç thotë edhe Imam Gazaliu: “Kush dhuron apo tregohet bujar me synim që të nderohet, lavdërohet apo të shpëtojë prej fjalëve të njerëzve, ai nuk është asgjë më tepër se një punëtor i atyre gjërave që dëshiron të fitojë. Bujar i vërtet, është ai që bëhet i dobishëm për njerëzit, edhe nëse nuk do të përfitojë asgjë prej tyre.” Në fakt, ashtu siç është mirësi e madhe të bëhesh një dorë që jep, ashtu është edhe të japësh vetëm për hir të Allahut.

Mistikët, të cilët zbuluan fuqinë që ka “dhënia” në përmirësimin e shpirtit, duke e bërë atë të rifitojë respektin, me shekuj të tërë e kanë përdorur dhënien pa pritur gjë në këmbim si një edukim të egos dhe një mënyrë terapie. Në studimet neurobiologjike të zhvilluara në ditët tona, është evidentuar se në trurin e njerëzve prodhohen hormone dhe enzima që lidhen me lumturinë kur ata dëshirojnë të bëjnë dikë të lumtur, duke siguruar kështu sakrifikimin e një kënaqësie afatshkurtër për të arritur një kënaqësi tjetër afatgjatë.

Ata që nuk u japin rëndësi të tjerëve dhe që janë të fokusuar vetëm në suksesin dhe interesat e veta, nuk mund ta kuptojnë se jeta në të njëjtën kohë është edhe ndarje me të tjerët. Për shkak se ata nuk e kanë shijuar kurrë qetësinë shpirtërore që të jep dhënia, duke u përpjekur gjithmonë të arrijnë ato që dëshirojnë vet, ata i shohin si rivalë njerëzit e tjerë dhe asnjëherë nuk mund të shkrihen dot me botën përreth tyre.

Njeriu që arrin të bëhet dorë që jep pa pritur asgjë në këmbim, shpërblehet me fitimin e dashurisë dhe respektit të njerëzve.

Shpresa për më të mirën, PËRGATITU PËR MË TË KEQEN

— Nuredin Nazarko —

Qenia njerëzore për nga natyra është qenie që mezi pret të zbulojë atë çfarë e ardhmja ka rezervuar. Nga djegia e dëshirës së padurimit ka edhe syresh që rendin të takojnë “parathënësit” e fatit që me mënyrat e tyre konstruktive t’u dëftojnë se ç’ka për t’u ngjarë. Kaq e fortë është kjo dëshirë sa që nuk shohin se me çfarë instrumente kërkojnë të njohin të ardhmen e tyre. Mjafton të dëgjojnë prej tyre se do t’u prijë e mbara dhe nuk kursehen në shpërblimin ndaj tyre. As vetë nuk janë aq të bindur ndoshta se e mbara do t’iu prijë. Është shpresa që ushqen njeriu që kërkon gjithmonë mirë për veten ajo që e bën t’iu besojë këtyre mjeshtrave “fatsjellës”. Kështu njeriu na dëfton dhe njëherë se për të shpresuar se e mira do ta ndjekë në të ardhmen e panjohur është gati ta hedhë tej edhe dinjitetin e vet si qenie njerëzore dhe t’i besojë llumit të një filxhani kafeje, një fije peu të përdredhur që lexohet nga një zonjë e madhe, disa kombinacioneve prej letrash apo dhe të tjera gjëra të kësaj natyre.

Të shpresosh për mirë është e natyrshme. Shpresa se ajo çfarë vjen do të jetë më e mirë se ajo që lë pas është bashkëshoqëruese e përhershme e njeriut në përkohësi. Për ta mbërritur atë që dëshirohet me padurim njeriu shtrydh energjitë e tij, sakrifikon rininë e tij, vetëm e vetëm që të mundet ta prek

më të mirën gjendje, që shpresat e veta t’i shohë të realizuara. Kryejnë punë nga më të shumëllojshmet, gjenerojnë mënyra nga më të ndryshme për të bërë para me shpresën se e ardhmja do të jetë më e mirë se e kaluara. Nuk duan t’ia dinë se çfarë kostosh duhet të paguajnë, mjafton që shpresat të realizohen.

Shpresues i madh është njeriu. Ndoshta ky shpresim është një nga të mirat që mbart njeriu brenda vetes, edhe pse ndonjëherë e baltos me gjëra të paqëna “fatsjellëse”. Është mirësi shpresimi, sepse mban gjallë përpjekjet për të zbuluar më tej veten, për të zbuluar më tej projektin që mban brenda vetes. Të shpresosh për më të mirën nuk je duke bërë ndonjë mëkat. Vetëm se duhet të kuptosh ç’është realisht e mira. A është e mirë vetëm sigurimi i mirëqenies materiale? Apo duhet ta shohim të mirën si diçka sublime, si gjënë që tejkalon përfytyrimet tona të zakonshme për të?

Shpresimi për më të mirën është ylli polar që na bën të orientohemi në anën e duhur të horizontit për të mos humbur udhë. Në netë të kthjellëta ylli polar aty është gjithmonë, i shqueshëm për ata që sytë e zemrës dhe të mendjes i çojnë drejt qiellit. Po aty është edhe në netë të mbushura me re apo të rënuara me mjegull. Në pritje për ta ndjekur.

I palëvizshëm dhe i paluhatshtëm në shkëlqimin e vet. Prandaj me shpresën që në netë të mbushura me re dhe të rëndura nga mjegulla të gjejmë rrugën e duhur, nuk duhet braktisur shpresa për prezencën e yllit polar tek ne. Kush e braktis këtë shpresë ka hyrë në udhën e pakrye të paudhësisë.

Por përtej faktit që duhet të shpresojmë për më të mirën, nuk duhet të lëmë jashtë vëmendjes se për të mbërritur tek kjo e mirë duhet të përballemi më prezencën e diçkaje tjetër, e cila na tërheq teposhtë me peshën e saj që të humbim shpresën nga gjetja e rrugës së njëmendtë që duhet të ndjekim. Dhe kjo diçka është padyshim e keqja dhe gjithë instrumentet që ajo përdor. Përballja me të keqen dhe gjithë vështirësitë e tjera që lidhen me të janë diçka e pashmangshme. Në një çast apo në një tjetër njeriu nuk mund ta evitojë përplasjen me të. Kjo është krejt e sigurt, ashtu siç je i sigurtë që për të jetuar duhet të mbushesh me oksigjen.

Mirëpo njeriu kur shpreson për më të mirën shpesh harron se rruga drejt së mirës është e mundimshme, e lodhshme dhe e djersitshme. Duke shpresuar për më të mirën harron se në rrugën që duhet të shkelë duhet të largojë ferrat, gjembat, plehurat që të shpëtojë prej pasojave që vijnë prej mbartjes së tyre. Kjo mungesë vëmendje bën që fortësia e goditjeve që do të marrësh nga e keqja dhe instrumentet e saj të jetë dërrmuese, sepse ke rendur në një terren të molepsur i pavetëdijshëm për rrezikun e infektimit nga molepsja. Dhe ndërkohë që infektosh nuk

e kupton aspak sesi ajo të thith shpresën për më të mirën dhe të devijon drejt fanitjeve të së mirës, duke të mbushur mendjen se fanitjet janë realiteti që ke shpresuar të arrish në jetë.

Dhe që të mos mbetesh një i sëmurë kronik nga molepsja me të keqen duhet ta parapërgatitësh veten për stuhitë që do të ndeshësh përpara se ato të vijnë e të zënë vend në qiellin tënd. Përpara se të shpresosh për më të mirën dhe të ëndërrosh ndonjëherë edhe me sy hapur për arritjen e saj, duhet të zgjohesh dhe të ngjeshësh armaturën mbrojtëse nga goditjet e rrufeve, vetëtimave, shpatave, shigjetave të helmuara. Duhet të marrësh antidotin përpara se të pish kupën e helmit që do të të shërbejnë, më shpesh ata që të rrethojnë me oborrtarizëm dhe përkulje servilësh.

Kjo parapërgatitje kërkon mbi të gjitha vullnet për të duruar. Shpreso dhe parapërgatitu me vullnetin për të duruar zjarrin e betejave që do kalosh në mejdan. Hyr në betejë duke shpresuar më të mirën, fitoren, dhe harroji plagët që do të kullojnë gjak përpara se të hysh në betejë. Kujtohu t'i kurosh pasi ke dalë nga beteja se beteja të tjera të presin. Ruaje vullnetin për të duruar të paprekur, sepse është garanci që edhe në çastet më të vështira është ura më e palëkundshme që mban në këmbë shpresën për më të mirën.

E pathënë, e pazgjedhur më mbeti shpresa ime më e madhe! Dhe më vdiqën të gjithë përfytyrimet dhe kënaqësitë e rinisë sime!

Si durova? Si u shërova, si i mbijetova ato plagë? Si u ngjall shpirti im prej varresh të tillë?


Unë kam diçka të pacenueshme, të pavarroshme, diçka që shkëmbinjtë dërrmon; ky quhet vullnet.

E heshtur e pandryshuar viteve mbeti. Vullneti im plak të ecë me këmbët e mia; i pazemër, mizor dhe i pacenueshëm është fundit i tij.

I pacenueshëm unë jam veç në thembër. Akoma ti rron, dhe i barabartë me veten qëndron, o shembull durimi! Edhe njëherë rrugën e çave mes të gjithë varreve!

Rron akoma tek ti ajo që s'm'u zgjidh gjatë rinisë dhe si rini dhe jetë akoma ti këtu rri, mbi gërmadha verdhacake varresh duke shpresuar.

Po ti je ai që të gjithë varret gërmadha i bën; të përshëndes, o vullneti im! Se veç ku ka varre, ka edhe ngjallje. (Nietzsche, F. (2001), Kështu foli Zarathustra, Tiranë: Phoenix, f. 94)



ÇDO IDE KËRKON TË BËHET SISTEM, SISTEMI KËRKON PLANIFIKIM DHE PASTAJ RËNIA

— Edison Çeraj —

Simbolet si armë

Çdo ngacmimi që vjen prej mjedisit natyror dhe social, qenia njerëzore i përgjigjet me ndryshime në funksionimin fiziologjik (ndryshimet në frymëmarrje, në tensionin e gjakut, rrahjet e zemrës, tendosja e muskujve etj.), me regjistrim ndjenjash (dhimbje, gëzim, frikë, pikëllim), me interpretimin njohës (tezat, hipotezat, teoritë, filozofia) dhe si përfundim jep vlerësime (e mirë, e moralshme, e pamoralshme, e bukur, e shëmtuar, e këndshme e kështu me radhë).¹

Kjo vlen për individin, jo për turmën pasive, që si e tillë është e detyruar të marrë çdo gjë që i jepet si të mirëqenë, madje pa bërë asnjë dallim ndërmjet të mirës dhe të keqes, të moralshmes dhe të pamoralshmes, origjinalit dhe kopjes e kështu me radhë.

1. Shushnjik, 2017.

Nuk ka arsye që ndaj simboleve (ideve), ashtu si ndaj ngacmimeve apo cytjeve specifike që vijnë prej mjedisit kulturor, qeniet njerëzore të mos reagojnë pothuajse në të njëjtën mënyrë. Në këtë pikë shqyrtime do të na thonë se njeriu jeton në botën e fjalës si objekt, ashtu siç jeton në botën e sendeve si objekte. Ai/ajo që dëgjon një orator apo lexon një libër është thelluar në të njëjtën mënyrë në një botë të krijuar prej fjalëve dhe fjalive, si në botën reale, e krijuar prej karrigeve, tavolinave dhe trotuareve. Mos vallë normat që mbretërojnë në një familje, të cilat mund të kuptohen vetëm përmes interpretimit, nuk janë në të njëjtën mënyrë pjesë e mjedisit, ashtu si orenditë shtëpiake apo peizazhi?

Një supozim shkencor thotë se qëndrimet e individit dhe grupeve ruajnë një lidhje të fortë simbolike, strukturore dhe funksionale me rrethanat e jashtme, dhe është e nevojshme që këto të fundit të ndryshohen, nëse synohet ndryshimi i këtyre

qëndrimeve. Nëse ndryshimi i qëndrimeve mund të pritet vetëm si pasojë e ndryshimeve të rrethanave të jashtme², nuk ka ndonjë arsye se pse një organizim i ri i simboleve (parastrukturim) të vlerësohet si ndryshim i jashtëm, që sipas logjikës së shëndoshë, do të ketë ndikim të fortë në qëndrimet e vjetra.

Njeriu i kohës sonë jeton në kohën e simboleve dhe mund të themi se jeta e tij varet nga interpretimi i këtyre simboleve. Simbolet janë mjedisi i vërtetë jetësor i tij. Duke qenë se simboli shënon diçka konkrete (dukuri, marrëdhënie, situatë), – ndërkaq njerëzit kanë përvoja me këto gjëra, që janë të ruajtura te këto simbole – qoftë edhe atëherë kur nuk mungon vetë objekti, qenia njerëzore reagon falë simbolit, që në këtë rast zëvendëson objektin dhe ky reagim bëhet sikur ai të ndodhej aty.³ Prandaj, me një përdorim të shkathët të simboleve (ideve) arrihet i njëjti ndryshim (në ndjenja, qëndrime dhe sjellje) që arrihet me ndryshimin e rrethanave natyrore dhe sociale.

Tani përballemi me çështjen e pritur: dikush analizon manipulimin e njerëzve përmes manipulimit të ideve (simboleve), ndërkohë që ne e dimë se sipas Marx-it nuk janë idetë fuqitë lëvizëse të historisë, por revolucionet. Mos ndoshta po u jepet ideve ajo fuqi që sipas Marx-it nuk e kanë? Pra, a nuk po i atribuohet manipulimit fuqia nëpërmjet ideve, që në të vërtetë nuk e ka? (Shushnjq, 2017)

Pavarësisht faktit se klasikët e marksizmit kanë shkruar për rolin, fuqinë dhe pamundësinë e ideve në histori⁴, sot është e nevojshme që të paraqiten disa fakte në lidhje me fuqinë e ideve (simboleve) në formimin e mendimeve, bindjeve dhe sjelljeve të njerëzve.

Sot, edhe ekonomistët, të cilët qëndrojnë më afër qëndrimit të determinizmit ekonomik, e pranojnë se idetë shkencore luajnë një rol vendimtar në prodhimin e punës – dy e treta e produktivitetit varet prej zbatimit të ideve shkencore në prodhim. Më tej, burimet e pasurisë së një shoqërie nuk duhen

2. "There are many varieties of "behaviour modification" and many different formulations, but they all agree on the essential point: behaviour can be changed by changing the condition of which it is a function." (B. F. Skinner, *Beyond Freedom and Dignity*, Alfred A. Knopf, New York, 1972, p. 150)

3. Shushnjq, 2017. Për aq sa mjedisi njerëzor vjen duke u bërë simbolesh, – në kuptimin që njeriu të jetë i rrethuar prej simboleve – largimi prej vetë gjërave është po aq i madh dhe përvoja e drejtpërdrejtë zëvendësohet me mësimin e simboleve.

4. Në studimet klasikëve të marksizmit hasim fare rrallë qëndrime të ndryshme për sa i përket rolit dhe fuqisë së ideve në zhvillimin historik të shoqërisë. Marx-i shkruan: "Arma e kritikës, gjithsesi nuk mund ta ndërrojë kritikën e armës; forca materiale duhet justifikuar me forcën materiale, por vetë teoria shndërrohet në forcë materiale kur përfshin të gjitha masat." (1953, f. 80) Në një vend tjetër: "Këtu, sikurse në përgjithësi tek ideologjët, duhet parë se ata i vendosin sendet medoemos në kokë dhe e vlerësojnë ideologjinë e tyre si një fuqi krijuese, si dhe si qëllimi i të gjitha raporteve njerëzore, ndërkohë që ajo është vetëm shprehje dhe simptomë." (1964, f. 147)

kërkuar të dhuntitë e natyrës apo të rastit, të numrit të banorëve, të madhësisë e fuqisë punëtore apo të sasisë e kapitalit të investuar, por ekskluzivisht të frymës njerëzore dhe të aftësisë e shndërrimit të ideve e reja në realitet praktik. E dimë shumë mirë se dija është pushtet – me gjasë pushteti i pushtetve.

Edhe ata që e kundërshtojnë fuqinë e ideve në modelimin e ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve janë të detyruar që t'u njohin ideve fuqinë e madhe në çastin kur i kontrollojnë, censurojnë apo i ndalojnë ato me të gjitha mjetet. Fakti se çdo qeveri i kontrollon apo përpiqet t'i kontrollojë mjetet e komunikimit masiv, siç kontrollon fuqinë ushtarake, në fakt është një pohim më vete se tek ato ndodhet forca e re, sepse përmes tyre mund të përhapen ide për të ndikuar mbi ndjenjat, bindjet dhe sjelljet reale të masave. Nëse shumë marksistë nuk e pranuan rolin parësor të ideve në zhvillimin historik të shoqërisë, atëherë ata duhej ta hidhnin poshtë edhe rolin e socializmit si ide me të cilën jetojnë shumë vende, pa përmendur vende të tjera që po e kërkojnë.

"Në fillim socializmi luftonte për ekzistencë. Në anën tjetër i qëndronte borgjezia, që besonte të forcat e veta, që e mbronte liberalizmin me guxim dhe përpikëri, si një sistem holist për të kuptuar ekonominë dhe politikën. Socializmi ia doli. Tashmë, në mbarë botën e civilizuar, ai ka mbrojtur të drejtën e vet për ekzistencë. Tani ai po lufton për pushtet." (Lenini)

Domethënë, tashmë e dimë se socializmi nuk ia doli, pasi e zuri pushteti, pra ra pre, pavarësisht eksperimenteve në trajtë projektesh për ta mbajtur në këmbë dhe pavarësisht remineshencave të nostalgjikëve të zhgënjyer nga jeta.

Idetë bëjnë dallimin. Çdo ide që mëton shtrirje, domethënë pushtet konkret (për shembull, pushtet ekonomik, dhe nuk ka se si të ndodhë ndryshe), e ka të brendashkruar ligjësinë e përçarjes së njerëzve. E thënë ndryshe, "o me ne ose kundër nesh". Një ide do të ketë "sukses" për aq sa mëton që një ditë të inaugurojë një sistem, një *modus vivendi*. Dhe kur kjo ditë vjen, bashkë me të ka ardhur edhe dita e vdekjes së saj, sepse nëse dimë diçka me siguri nga e kaluara është pikërisht fakti që qenia njerëzore nuk duron dot asnjë sistem (nëse nuk e rrezon në kohë, do ta bëjë pak me vonësë), sepse çdo sistem nuk është gjë tjetër veçse planifikim, dhe çdo planifikim për natyrën njerëzore është pamundësi e kulluar.

Të ardhmen nuk mund ta dijë askush. Por, ne akoma nuk jemi çliruar nga e ardhmja. Çlirimi nga e ardhmja është premisë për lirinë. Ja pse Mann-i thoshte se "liria është një hiç – i gjithë problemi është çlirimi".



Njeriu që ëndërron për **MEKËN** — Basma Atassi — e vjetër

Sami Angaviu nuk pranon ta quajë Mekën një qytet, sepse Meka e tij nuk mund të shndërrohet kurrë në një metropol, sado thellë të ngulën turjelat, apo sado e ashpër të jetë beteja mes qiellgërvish-tësve dhe reve.

Meka është një “shenjtërore,” thotë ai. “Është shtëpia e Zotit, streha e njerëzve, vendlindja e Islamit.” Është shenjtërorja e ngritur nga arkitipi i muslimanit të përsosur, profeti Ibrahim, shton ai.

Dhe për këtë arkitekt të pasionuar, të gjallë, është në të njëjtën kohë vendi i rrënjëve të tij, objekti i dashurisë së vet. I ati i Angaviut ishte një *mutavef*, një udhërrëfyes për pelegrinët që ndërmerrnin udhëtimin spiritual të haxhit. Si një djalë, ai do ta ndihmonte atë, nganjëherë duke mbajtur këpucët e pelegrinëve për t’i shpëtuar ata prej humbjes në hapat e Xhamisë së Madhe.

Shtëpia e tyre gjendej në Shaab-ı Ali, në mëhallën që thuhet të ketë qenë në vitet 600 vend ndenje për Muhammedin, Profetin e Islamit, e një pasardhës i profetit Ibrahim. Ai e kujton atë si një mëhallë të

ngushtë, por plot lëvizje, që një kohë i bënte vend një prej tregjeve të hapura më të ngarkuara në Mekë, “*Suku’l-Lejl*”-it (tregut të natës). Rrugicat e saj kundërmonin nga temjani dhe erëzat, thotë ai.

Por shtëpia e familjes Angavi u shkatërrua gjatë viteve 1950, ndërsa familja sunduese e vendit, es-saudët, nisi ta zgjerojë Xhaminë e Madhe, me qëllim që ta rriste numrin e haxhinjve që ajo mund të nxinte. Është një program zgjerimi që ka vijuar që prej asaj kohe, duke e transformuar zonën që Angaviu e njihte dikur si shtëpi.

Arkitekti nxiti debat në vitin 2006, kur i tha një kanali televiziv rajonal se aty ku dikur kishin qenë vendet historike, shtëpia e Profetit Muhammed dhe shkolla më e vjetër e Islamit, *Daru’l-Erkam*-i, tani kishte rrugë dhe objekte publike. “Këto vende kanë qenë gjithmonë të njohura për mekasit,” thotë ai, duke shtuar, “dhe tani unë po përiqem të përdor harta të vjetra dhe të reja për t’i gjetur në mënyrë shkencore këto vende historike.”

“Unë pata mundësinë ta caktoj dhe të bëj gërmime

në shtëpinë e Sejjide Hatixhesë (gruas së parë të Profetit Muhammed), dhe zbulova gjurmë ndërtime që kishin ekzistuar para periudhës abaside (në shekullin e tetë). Unë përdora libra dhe harta të vjetra për të lokalizuar shtëpinë e Profetit, dhe gërmova e gjeta gjurmë dyshemesh që ekzistonin gjatë periudhës abaside.”

“I fotografova këto vende dhe ua paraqita autoriteteve zbulimet e mia,” vazhdon ai. “Por mendoj se autoritetet i donin këto hapësira për t’u bërë vend adhuruesve.”

Haxhi është një nga shtyllat e Islamit, me çdonjë prej 1.5 miliardë muslimanëve anembanë botës të obliguar fetarisht për ta kryer atë së paku një herë në jetë nëse është në gjendje nga pikëpamja financiare, fizike dhe shpirtërore. Arabia Saudite lejon aktualisht rreth 1.5 milionë njerëz të vijnë në vend gjatë periudhës së haxhit, duke caktuar përqindje të ndryshme shifrash për nacionalitete të ndryshme. Shumë njerëz presin me dekada në listat e gjata që t’u vijë radha. Në fakt, me normën aktuale, një muslimani i duhen 500 vite për të siguruar mundësinë për të vajtur në Mekë.

Arabia Saudite ka ngulmuar prej kohësh se është e angazhuar t’ua japë më tepër muslimanëve mundësinë për të kryer haxhin. Dhe për këtë qëllim iu fut zgjerimit të katërt të Xhamisë së Madhe, zgjerimit më të madh në historinë e xhamisë. Pas përfundimit, zgjerimi do të krijojë hapësira faljeje për dy milionë adhurues në një rast të caktuar.

LËNIA E MEKËS

Familja e Angaviut lëvizi dy herë të tjera brenda Mekës, ndërsa qyteti vazhdonte të transformohej. Më pas ata u vendosën në Xheda, një qytet në Detin e Kuq, që shërben si portë hyrjeje për shumë prej pelegrinëve.

Angaviu që shumë i ri për ta kuptuar arsyen e lëvizjes. “Thjesht e gjeta veten në një tjetër shtëpi të re,” kujton ai. “Por një gjë për të cilën isha tepër i vetëdijshëm që fakti se ndalova së shikuari Xhaminë e Madhe.”

Xheda është një hapësirë ku janë përzier ide dhe njerëz. Muslimanë nga e gjithë bota kanë kaluar përmes qytetit; ca duke ndaluar, për ta bërë atë shtëpi të tyre. Dhe pikërisht në këtë mjedis hodhi shtat dashuria e të riut Angavi për arkitekturën.

Arkitekti tashmë 65-vjeçar filloi ta ndërtojë shtëpinë e tij me duart e veta në mesin e viteve 1980. E gjendur në një lagje të qetë të Xhedës, ajo kërkoi 15 vite për t’u mbaruar.

E vendosur mes një duzine vilash që nuk dallojnë nga njëra-tjetra, dhe nën një palmë gjigande, krijimi i tij spikat si një kremtim i arkitekturës tradicionale të Hixhazit, emri i lashtë për pjesën perëndimore të

Arabisë Saudite, që përfshin Xhedën dhe qytetet e shenjta të Mekës dhe Medinës. Ndërsa pelegrinë nga e gjithë bota janë lëshuar në rajon, gjurmët e vendeve të tyre kanë ardhur me ta. Ndikimet nga Levanti, Jemeni, Afrika Lindore dhe India mund të gjenden të ngulitura në ndërtesat e saj; dhe brenda shtëpisë së Angaviut, me koralin e saj të bardhë dhe muret e gurit në të verdhë shkretëtire, me dyert dhe dritaret e gdhendura, e me verandat e zbukuruara.

Fasada prej guri në hyrje të shtëpisë së tij është nga Meka, dhe rreth 350-vjeçare. Ajo u shpëtua nga një shtëpi që po shkatërrohej në vitet 1980. “Kjo ishte një nga pjesët e fundit historike të mbetura nga Meka,” thotë ai, ndërsa më pret tërë përzemërsi brenda.

Shkatërrimi po ngjiste me një shpejtësi të tillë, shpjegon ai, sa askush nuk mendonte të shpëtonte rrënojat.

Porta prej druri është gjithashtu nga Meka. Ai e gjeti atë në një treg në Xheda rreth njëzet vite të shkuara. “Shitësi e pa që unë mezi prisja ta bëja timen atë, prandaj e shiti me një çmim të kripur,” kujton ai me një ngërdheshje.

Larmia e Hixhazit reflektohet në çdo qoshe brenda tempullit të Angaviut.

SKICIMI I MEKËS

“Ideja e ndërtimit të kësaj shtëpie nuk synonte të qenit diçka ndryshe apo e veçantë,” shpjegon ai. “Ideja ishte të vija në zbatim filozofinë time në jetën reale.” Është një filozofi që ai e quan *el-Mizan*, apo balanca.

Në rrënjë të kësaj është besimi i tij se projekti dhe stili bashkëkohor mund të ekzistojnë në mënyrë harmonike me natyrën dhe traditën.

E pajisur teknologjikisht, por e projektuar sipas traditës, shtëpia ngjan të jetë mishërim i kësaj teorie. Dhe është pikërisht çka ai imagjionon për Mekën; qytetin që dikur ishte një luginë e zhveshur mes malesh shkëmbore dhe të qendëruar nga xhamia më e shenjtë në Islam, e në arkitekturën e së cilës mund të gjenden shenjat e kulturave dhe qytetërimeve shumë të ndryshme.

Por në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, ndërsa bumi i naftës e solli teknologjinë moderne në Arabinë Saudite, arkitektura karakteristike islame e Mekës filloi të zhdukej. Ndërtimet tradicionale që kishin mbijetuar për qindra vite, përgjatë periudhave abaside, omejade dhe otomane, u zëvendësuan me rrokaqiejt.

Nga 15 mëhallat e vjetra të Mekës, 13 janë shkatërruar plotësisht. Shtëpi, kafene, dyqane, e madje vende arkeologjike paraislame, thjesht janë zhdukur. Dhe në vend të tyre është ngritur diçka që pak prej banorëve e pranojnë.

Siç tha gazetari kashmiras, Besharat Pir, në 2012-ën, pas vizitës së tij në Mekë, se qyteti modern duke sikur ishte ndërtuar nga një popull pa histori apo traditë.

“Gjatë asaj kohe, ndërsa njerëzit po mblidhnin para, unë po mblidhja të dhëna,” shpjegon Angaviu në dhomën e miqve, ku një tavolinë xhami mban brenda saj një shatërvan të vogël prej guri, një karakteristikë e e një shtëpie të vërtetë Hixhazi, me zhurmën e ujit që çurqon dhe vendos ritmin e vendit.

Në vitin 1975, me t’u kthyer nga SHBA-të dhe Gjermania, ku përfundoi studimet pasuniversitare në arkitekturën islame, Angaviu hapi një qendër në Xheda për të ruajtur mjedisin natyror dhe islam të vendeve të shenjta të Mekës, të vendlindjes së Muhammedit, dhe të Medinës, që mbante xhaminë dhe varrin e Profetit.

Qendra, e cila tërhoqi duzina dijetarësh nga e tërë bota, kreu studime gjeologjike, arkeologjike dhe antropologjike. Ata përvijuan gjithashtu strategjitë për t’i administruar shërbimet e duhura për plotësimin e nevojave të numrit gjithnjë e në rritje të pelegrinëve, ndërsa respektohej natyra dhe historia e dy vendeve. “Haxhiologji,” pëlqen ta quajë atë Angaviu. Më pak se një dekadë më vonë, ai dha dorëheqje nga qendra, duke besuar se ajo ishte përfshirë nga kaosi burokratik që e paralizoi punën e saj. “Unë marr frymë dhe ëndërroj për Mekën dhe Medinën,” thotë ai. “Pikërisht kur lashë qendrën që momenti kur shëndeti im nisi të marrë tatëpjetën.”

Në hyrje të shtëpisë së Angaviut janë dy harta të mëdha: njëra e tregon Mekën përpara bumit të ndërtimeve, tjetra e paraqet atë në gjendjen aktuale. Ai i ka bërë me shenjë vende të ndryshme me rëndësi historike, si xhamitë dhe shtëpitë e sahabeve të Profetit; shumë prej tyre janë tani nën hotele apo nën qendra tregtare. “Puna hartografike që po bëj kërkon qeveri,” shprehet ai. “[Por] unë po e bëj vetë.”

Që nga vitet 1980 janë shkatërruar më tepër se 95 për qind e vendeve historike të Mekës, me shumë prej tyre që datojnë në vitet e para të Islamit, në shekullin e shtatë, duke hapur rrugën për kulla dhe hotele me pesë yje. Pastaj, sigurisht, kemi Kullën e Sahatit të Mekës, e cila është 46 herë më e lartë se Qabja aty pranë, kubikja e zezë, e konsideruar të jetë struktura më e shenjtë në Islam, e rreth së cilës muslimanët sillen për të shprehur harmoninë në adhurimin e Zotit. Rezultati është therës.

Shkëlqimi i qiellgërvishtësve reflekton në fytyrat e adhuruesve, vinçat bëjnë hije në dyshemetë me mermer. Dhe ishte një nga këto vinça që u rrëzua mbi territorin e xhamisë në shtator, duke vlarë më shumë se 100 njerëz. “Ky është mishërim i prishjes në *el-Mizan*,” pëshpërit Angaviu, duke bërë gjeste

me dorën e tij, sikur të drejtonte një orkestër, për të theksuar çdo fjalë.

Ai e quajti kullën e sahatit “budallaqe”, i paaftë për ta fshehur neverinë për strukturën, pavarësisht faktit se ajo ishte projektuar nga një mik i vjetër dhe ish-koleg në Qendrën Kërkimore të Haxhit, Mahmoud Bodo Rasch, një arkitekt gjerman i kthyer në Islam katër dekada të shkuara dhe i përfshirë në një numër projektesh në qytetet e shenjta.

Angaviu i kishte mëshuar idesë së ngritjes së ndërtesave shkallë-shkallë, me më të shkurtrën të vendosur më pranë qendrës së Mekës. Ai dëshironte që hotelet të ndërtoheshin milje larg dhe të përmirësohej transporti. “Edhe kur Profeti Muhammed erdhi nga Medina për të kryer haxhin në Mekë, ai qëndroi në një zonë të quajtur Abtah, që ishte pesë kilometra larg xhamisë,” shpjegon Angaviu.

Për shumë banorë të Mekës, zgjidhjet e bazuara në buldozerë dhe në dinamit përbëjnë një rrezik jo vetëm për strukturat, por për diçka njëherësh më personale dhe më universale: për kujtimet e fëmijërisë, të shtëpisë dhe të kujtesës kolektive islame.

“Është shembulli i parë i lakmisë që e mund besimin,” thotë Mexhid esh-Shibiu, mekasi fisi i të cilit u shërbeu pelegrinëve për shekuj, edhe përpara fillimit të Islamit.

“Toka rreth Xhamisë së Madhe në Mekë është një prej më të shtrenjtave në botë. Prandaj ndërtuesit, Zoti i udhëzoftë, do të ndërtojnë sa më lart të munden mbi të,” thotë esh-Shibiu, i cili ka fotografi bardhë e zi të Mekës dhe të të parëve të tij, që e veshnin kubiken e shenjtë dhe e pastronin pjesën e brendshme të saj me ujë trëndafil.


Angaviu këmbëngul se nuk dyshon në qëllimet e udhëheqësve të vendit për t’u siguruar lehtësirat më të mëdha të mundshme pelegrinëve. Por ai shton, “mjete nuk justifikon qëllimin.”

Ai kërkon që qeveria ta mbështesë atë në misionin e tij për të shpëtuar atë çka është ende e shpëtueshme nga Meka që ai njeh dhe dashuron, dhe po nxit që ndërtimi të ndalojë për pak muaj, për të lejuar një rivlerësim të shkallës së dëmit.

“Në dashtë Zoti, unë mund të gjej zgjidhje shken-core për Mekën dhe për pelegrinazhin që janë në linjë me *el-Mizan*-in,” thotë ai. “Unë jam dikush që ëndërroj për Mekën, në ëndrra dhe zgjuar.”

“Unë dua të jepet një mundësi,” flet ai. “Dhe Profeti Muhammed thotë se nëse keni një filiz në duar, e është e mundur ta mbillni atë përpara se të vijë Dita e Gjykimit, duhet ta mbillni.”

Por a beson ai vërtet se ka ende shpresë për Mekën e ëndrrave të tij, kur prej historisë së saj është zhdukur aq shumë tashmë?



ZGJUARSIA E EBU HANIFES

Imam Azami ishte shumë i zgjuar dhe kishte një mendjemprehtësi që u gjente zgjidhje praktike çështjeve. Si shembull për këtë, transmetohet një ngjarje e rëndësishme.

Kur dikush po ndërronte jetë, Imam Azamin e caktoi kujdestar. Imami shkoi te kadiu i asaj kohe, Shubrumeja, i tregoi për situatën dhe i kërkoi që t'ia aprovonte kujdestarinë. Atij i tha:

“Kur ai ndërroi jetë, unë nuk gjendesha aty. Këta dy veta janë dëshmitarë se filan person më ka caktuar kujdestar.”

Nisur nga kjo, Shubrumeja e pyeti Ebu Hanifen:

“A mund të betohesh se këta dy veta po dëshmojnë të vërtetën?” Imam Azami iu përgjigj:

“Unë nuk kam qenë aty... Andaj nuk më takon të betohem.”

Kur Shubrumeja i tha:

“Në këtë çështje krahasimi yt është i gabuar”, Ebu Hanifja ia ktheu:

“Si është e mundur? Nëse një të verbri ia ndajnë kokën përgjysmë dhe nëse dy dëshmitarë dëshmojnë se kush ia çau kokën, a mundet që i verbri të betohet se ata po dëshmojnë të vërtetën? Ju po më kërkoni të betohem për diçka që nuk e kam parë!”

Shubrumeja nuk gjeti dot fjalë për të thënë. Andaj gjykoi për aprovimin e kujdestarisë dhe e miratoi.

NJË THËNIE

“Bujaria është një roje që e mbron njeriun nga përçmimi.”

(Osmani -r.a.-)

NJË LUTJE

“(O Zot!) Jepu begati mirësive që më ke dhënë! Më mbro nga e keqja e gjërave që ke caktuar të realizohen! Sepse, kur Ti cakton, askush nuk mund të thotë ndonjë fjalë për caktimin Tënd!”

(Darimi, Salat, 214; Tirmidhi, Vitri, 10.)

FAKTE INTERESANTE

- Shumica e gurëve të çmuar përbëhen nga elemente të ndryshme. Vetëm diamanti përbëhet nga karboni.
- Sasia e kripës nëpër oqeanë është aq e madhe saqë mund t'i përfshijë të gjitha kontinentet deri në 150 metra thellësi.
- Ndërrimin e orës e ka vendosur Benjamin Fraklini për të përfituar nga drita e ditës.

Falënderoje ALLAHUN

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: “**Zoti ka caktuar: kush më falënderon, Unë do t’ia shtoj të mirat dhe kush do t’i mohojë mirësitë e mia, dijeni mirë, se ndëshkimi Im është i ashpër**”.

Natyra njerëzore është e dobët. Njeriu mund të bjerë në gradat më të ulëta të moralit mirëpo të gjitha edhe mund të mbahen. Por mendoj se cilësia më e ulët është kur tjetri ta mohon të mirën. Nëse shikon një person në rrugë, i cili bën sikur s’të njeh edhe pse ti i ke bërë një të mirë dhe i ke qëndruar pranë, është shumë e rëndë të mundohesh ta përtpësh sjelljen e këtij personi. Është mungesë burrërie dhe tregues i dobësisë njerëzore kur njeriu e harron të mirën.

A nuk ka ardhur koha të pyesim veten tonë: “Mos ndoshta jemi nga ata, të cilët e kanë harruar të mirën, megjithëse e urrejmë diçka të tillë?” Kush më shumë se Allahu (xh.sh) ka bërë të mira mbi ty?! Kush meriton të falënderohet më shumë se Zoti i gjithësisë. Beto hem në Allahun se Atij i takon falënderimi më i madh, sepse edhe prindërit e tu janë nga mirësitë që Allahu t’i ka dhënë ty.

Ndoshta njeriu me punët e përditshme, me hallet dhe problemet e jetës bie në këtë gabim, por që nuk mund të justifikohet. Cilësia më e ulët e njeriut është të jetë jobesimtar, ndërsa fjala “**jobesimtar**” në Islam nuk do të thotë se ti ke gjetur argumente që nuk ka Zot, por do të thotë që ti i ke mbuluar (je

përpjekur t’i mbulosh) të mirat e Zotit. Fjala kufër (mosbesim) do të thotë ta mbulosh të mirën dhe të mos e tregosh atë edhe pse e ke në vetën tënde.

Mirësitë që na ka dhuruar Allahu (xh.sh), janë të panumërta:

- **Uji:** Ne kemi problem se uji na vjen në një orë të caktuar dhe ikën në një orë të caktuar. Por po ta mendosh në rang botëror, çështja është shumë më e komplikuar. A e mendon se si vjen ky ujë në tokë. Po sikur uji të mos dilte nga toka? Po sikur i gjithë uji mbi sipërfaqen e tokës të ishte i kripur? A mos kemi gjë në dorë për ta ndryshuar këtë? Allahu (xh.sh) thotë në Kuran: “**Mendoni sikur Allahu ta bënte ujin të depërtonte thellë në tokë, ku do të gjenit ujë për të pirë**”. Vetëm Allahu është Ai, që e nxjerr ujin e pastër nga toka, prandaj vetëm Atë duhet të falënderojmë për këtë mirësi të madhe.

- **Ajri:** Të gjithë e dimë se pa oksigjen nuk ka jetë. Mendo pak sikur pemët të kryenin të njëjtin proces si njeriu, pra të merrnin oksigjen e të nxirrnin dyoksid karboni. Atëherë të gjithë njerëzit do të vdisnin nga mungesa e ajrit. Por Zoti i gjithësisë ka caktuar, që pemët të marrin dyoksid karboni dhe të nxjerrin oksigjen. Prandaj le ta falënderojmë Allahun (xh.sh) për këtë mirësi të madhe.

- **Ushqimi:** Mendo se si Zoti ka vendosur në fytn tënd një valvul, e cila një herë i hap rrugën ajrit, një herë i hap rrugën ushqimit. Por nëse ngatërrohet



një herë, gati sa nuk mbytemi dhe të gjithë e kemi përjetuar një gjë të tillë. Ti e fut kafshatën në gojë e nuk e merr vesh se çfarë ndodh me ushqimin tënd, por ushqimi ka një rrugë shumë të gjatë për të bërë derisa të arrijë atje ku duhet. Prandaj Allahu nuk e harron këtë ushqim por i urdhëron organet e trupit ta përpunojnë atë, derisa ky ushqim të kthehet në energji për ty.

- **Nata dhe dita:** Sikur dita të ishte pa fund, ku do ta gjeje një moment për të pushuar? E kemi provuar të gjithë se gjumi i ditës nuk është kurrë si gjumi natës. Po sikur nata të ishte pa fund, çfarë do të bëhej me jetën tonë? Prandaj le ta falënderojmë Allahun edhe për këto mirësi.

Këto janë disa prej mirësive të Zotit dhe njeriu përfiton prej tyre edhe sikur të jetë jobesimtar, sepse Zoti është i mëshirshëm me të gjithë njerëzit, madje edhe me ata që e mohojnë Atë.

Zoti thotë në Kuran: **“...dhe nëse mundoheni t’i numëroni të mirat e Zotit, nuk do të arrini ta bëni këtë”**. Prandaj njihi të mirat e Zotit tënd dhe mos u bëj njeri i lig, që harron mirësitë e Tij. Zoti na tregon, se Ai është i mëshirshëm me njerëzit, sepse njerëzit nuk i meritojnë të gjitha këto mirësi. Ndërsa në një ajet tjetër Zoti thotë: **“...por njeriu është shumë i padrejtë dhe mohues”**. Prandaj natyra njerëzore është e tillë, që harron të falënderojë, prandaj duhet të jemi gjithmonë të vëmendshëm e të mos hutohemi nga problemet ditore, të cilat mund të na bëjnë t’i harrojmë mirësitë dhe begatitë që na ka dhuruar Zoti.

Falënderimi për të mirën është cilësia më e lartë, është shenjë burrërie dhe besnikërie. Ndërsa harresat

është shenjë e dobësisë së njeriut. Kush falënderon Allahun (xh.sh), Ai i sjell begatinë. Zoti betohet dhe thotë në Kuran: **“Zoti ka vendosur një ligj: nëse falënderoni Allahun, Unë do t’ua shtoj të mirat, por nëse mohoni, dijeni se ndëshkimi Im është i ashpër”**.

Ibrahimi (a.s) ishte shumë bujar. Ai vërente se të mirat e Zotit i shtoheshin çdo ditë, prandaj tha: “O Zot! Pakësoji të mirat ndaj meje, sepse kam frikë se nuk do të arrij t’i shlyej gjithë këto mirësi”. Zoti i tha: “O Ibrahim! Pakësoje ti bujarinë, t’i pakësoj Unë të mirat, sepse kur njeriu falënderon për të mirën që i Jap, Unë nuk mund t’ia ndaloj mirësitë”. Ibrahimi (a.s) ishte bujar, por Zoti ishte edhe më bujar se Ibrahimi (a.s). Prandaj nëse doni bereqet e begati, atëherë falënderojeni Allahun (xh.sh) dhe do ta shihni se Zoti është bujar e i mëshirshëm me robërit e Tij.

Lind pyetja: “Si ka mundësi, që njeriu të bjerë kaq poshtë e të harrojë të mirat që i ka dhënë Allahu”? Nëse dikush na pyet: “Si je”, ne në vend që të falënderojmë Zotin, fillojmë e ankohe mi për ato gjera që nuk i kemi, a thua se njeriu që kemi përballë do të na i zgjidhë krejt hallet tona. Kjo nuk është gjë e mirë dhe janë disa shkaqe që të çojnë në këtë pozitë:

1- Shkaku kryesor pse njerëzit ankohen është, se ata i quajnë veshjen dhe ushqimin si gjëra normale dhe elementare, pra sikur Zoti e ka për detyrë t’ua japë ato të mira. Falënderimi vjen vetëm atëherë kur na jepet një e mirë e madhe si: makinë, shtëpi etj.

Një person mendjemadh dhe i pasur shkoi tek një dijetar, i cili desh i ta verë në një provë të vogël.

Kështu që dijetari i tha: “Mendo sikur je në mes të shkretëtirës dhe po vdes, ndërsa pranë teje gjendet vetëm një person, i cili mund të të japë ujë. Nëse ai të thotë: “Do të të jap ujë, vetëm nëse më jep gjysmën e pasurisë”, çfarë do të bëje”? Personi u përgjigj: “Po, do t’ia jepja gjysmën e pasurisë, sepse jeta është më e shtrenjtë se pasuria”. Dijetari vazhdoi: “Po sikur pas kësaj të bllokoheshe dhe të mos kishe mundësi për të dalë jashtë, a do ta jepje gjysmën tjetër të pasurisë vetëm për të shpëtuar nga ky hall i madh”? Burri mendjemadh tha: “Po, do ta jepja edhe gjysmën tjetër të pasurisë”. Atëherë dijetari i tha: “A e shikon se gjithë pasuria jote vlen vetëm sa një pikë ujë. Prandaj mos prit sa të sprovohesh, por falënderoje Zotin kur je mirë dhe kur je keq.

2- Gjithashtu njerëzit nuk e falënderojnë Allahun (xh.sh), sepse shikojnë vetëm për më të mirën. Islami nuk thotë, të rrish në gjendjen që je. Ti synoje më të mirën, por mos harro ata që janë më keq se ti, sepse duke synuar më të mirën, njeriu harron të falënderojë Zotin për atë që Ai i ka dhënë dhe ankohet vazhdimisht. Ndalu për një moment dhe shiko njerëzit që janë më keq sesa ti dhe atëherë do ta vlerësosh mirësinë që të ka dhënë Zoti. Profeti (a.s) na mëson se kur kalojmë pranë dikujt që është i sëmurë, i çmendur apo i paralizuar duhet të themi: “Falënderoj Zotin që më ka ruajtur mua nga ato sprova me të cilat ka provuar shumë të tjerë”.

3- Njerëzit nuk e falënderojnë Allahun, sepse nuk i njohin cilësitë dhe ligjet e Zotit. Allahu ka vendosur si ligj, që pasaniku më i madh sot, mund të bëhet fukara për 24 orë dhe anasjelltas.

Tregohet se një grua besimtare ishte martuar me një burrë të pasur. Teksa po hanin bukë, dëgjuan zërin e një fukarai që po i binte derës. Burri del tek dera i nxehur dhe e përzë fukarain ashtu siç nuk i takon një njeriu normal. Kaloi koha dhe ky pasanik u varfërua deri në atë gradë, sa që nuk pati para të mbante gruan e tij, prandaj u divorcua prej saj. Kjo grua martohet me një njeri tjetër. Teksa çifti i ri po hante darkë, përsëri troket dera. Gruaja del të shikojë se kush është, por shtanget kur shikon, se fukarai që kishte ardhur për të lypur diçka ishte ish burri i saj. Kështu ajo fillon të qajë. Burri i saj e pyet: “Pse po qan”, ndërsa ajo ia kthen: “Ai fukara që rri tek dera, është ish burri im”. Atëherë burri pyet gruan: “A më njeh se kush jam unë”? “Jo”, - ia kthen ajo. Burri vazhdon: “Unë jam ai person, që erdha tek shtëpia juaj për të kërkuar një kafshatë bukë, ndërsa burri yt më përzuri”. Ky është ligji i Allahut (xh.sh). Prandaj ju ftoj të jeni bujarë, të ndershëm

dhe falënderues ndaj Zotit të gjithësisë, se vetëm Ai e shpërblen më së miri falënderimin.

Falënderimi është cilësia më e lartë. Gjithashtu duhet ta dimë mirë se Allahu (xh.sh) NUK KA NEVOJË PËR FALËNDERIMIN TONË. Nëse njerëzve u mbetet merak se përse ti e ke harruar nderin që të kanë bërë, Zotit nuk i mbetet merak pasi Ai i tillë është, Dhurues i madh dhe Bujar i pashoq. Allahu (xh.sh) thotë në Kuran: “...**dhe kush falënderon, e ka për veten e tij, por kush mohon, e ka për veten e tij**”. Ndërsa Profeti (a.s) ka thënë: “**Pasha Zotin e gjithësisë! Sikur të gjithë njerëzit dhe xhindet të ishin si besimtari më i mirë, kjo nuk do t’i shtonte asgjë Zotit në sundimin e Tij. Por Sikur të gjithë njerëzit dhe xhindet të ishin jobsimtarë, Zotit nuk i pakësohet asgjë nga sundimi i Tij**”.

Këtu lind një pyetje e madhe: “Si mund ta falënderoj Allahun (xh.sh)”? Falënderimi arrihet në tre forma:

1- **Falënderoje Zotin me zemër**: Të gjithë kemi ndodhur në situata të vështira dhe e kemi parë se si ka ardhur ndihma e Zotit. Prandaj le ta falënderojmë Zotin me zemër. Këtu fillon falënderimi.

2- **Falënderoje Zotin me gjuhë**: A nuk mendoni se ka ardhur koha ta reformojmë gjuhën tonë, fjalët që themi?! Gjatë ditës themi shumë fjalë, por sa prej tyre janë për Zotin, sa e falënderojmë Zotin me gjuhë? Të gjithë kemi halle e probleme dhe rrimë e ankohemi, por mos iu anko njeriut, sepse mund të arrijë puna deri aty, sa t’i ankohesh njeriut për Zotin dhe kjo është poshtërsi. Por nëse ke një problem, lutju Zotit të gjithësisë, se Ai do të t’i përgjigjet. Mendoj se kemi nevojë të mësojmë shprehjen e Profetit (a.s): “**Zotit i takon falënderimi në çdo lloj gjendjeje**”.

3- **Falënderoje Zotin me vepra**: Ne i bëjmë të gjitha këto adhurime, jo vetëm se jemi të dobët, por i bëjmë në shenjë falënderimi ndaj Allahut (xh.sh). Ai që na dha gjithë këto mirësi, kërkon prej nesh ta vëmë ballin në sexhde, jo se Ai ka nevojë për këtë, por ne kemi nevojë për këtë sexhde, për t’i lidhur zemrat me Allahun (xh.sh), për t’i dhënë gjallëri jetës tonë. Dijeni fare mirë, se kur Zoti e dëboi shejtanin nga Xheneti, ai u betua se do ta humbiste njeriun dhe tha: “O Zot unë do të mundohem që t’i largoj njerëzit nga falënderimi yt”.

Lus Zotin të na bëjë njerëz falënderues! Zoti na bëftë nga ata që shijojnë të mirat që Allahu ua ka dhënë dhe falënderojnë Zotin për këtë! Lus Zotin, që t’i lidhë zemrat tona me madhëstlinë e Tij! Zoti na e shtoftë besimin, na bëftë prej të sinqertëve dhe na bëftë nga banorët e Xhenetit!

Amin!..

— Rushan Kavallë —

Pastë e thjeshtë me kakao

PËRMBAJTJA:

- 1 kuti pandispanjë (kek për pastë) me kakao
- 2 kuti krem kakao
- 2 vezë
- 2 gota qumësht
- Gjysmë gote uji sheqer pluhur
- Gjysmë pakete margarinë,
- 80 gr çokollatë
- Pak kakao për t'ia hedhur sipër



PËRGATITJA

Shtrohet pandispanja dhe zbutet me qumësht. Dy pako me krem kakaoje i përziejme me një gotë qumësht duke i sjellë në një masë të trashë dhe masën e shtrojmë mbi pandispanjë. Dy vezët i rrahim mirë me mikser, pastaj i shtojmë sheqerpluhurin dhe vazhdojmë t'i rrahim. Shkrijmë mbi sobë gjysmë pakete margarinë. Pasi margarina shkrin plotësisht, ulim temperaturën dhe i shtojmë çokollatën. Pasi shkrihet edhe çokollata, e përziejme mirë, pastaj e hedhim te vezët e rrahura dhe e përziejme derisa masa të bëhet homogjene. Kjo përbërje hidhet dhe shtrihet mirë mbi pandispanjën së cilës më parë i patëm shtruar krem kakao. E vendosim në këtë mënyrë pastën në frigorifer dhe e lëmë aty për 4-5 orë. Pas kësaj i hedhim sipër kakao dhe e servirim.

Pogaçe në formë luleje

PËRMBAJTJA:

- 1 gotë qumësht (i vakët)
- 1 gotë vaj
- 1 lugë gjelle kos
- 2 vezë (të verdhën e njërës vezë për të lyer pogaçet)
- 2 lugë gjelle sheqer
- 1 lugë çaji kripë
- 1 lugë gjelle maja
- Miell sa të nevojitet

PËR MBUSHJE:

- 4 patate (të grira)
- 1 qepë
- Vaj
- Majdanoz
- Piper i zi, kripë



PËRGATITJA:

Para se të hedhim miellin, përzihen të gjitha përbërjet e lëngëta. I hedhim pak nga pak miellin dhe majanë, duke përfutur një brumë të butë. Grihet qepa hollë dhe skuqet në një tavë me vaj deri sa të marrë ngjyrë të kuqërremtë. Hidhen pastaj edhe patatet e grira dhe përzihen së bashku. Pasi i hedhim edhe erëzat, kripën dhe majdanozin, e heqim nga zjarri dhe i lëmë të ftohen. E ndajmë brumin në toptha të vegjël dhe i hapim me shkopin e kuzhinës në petë me përmasat e një limoni. Në anët e tyre vendosim përbajtjen dhe pjesën tjetër të brumit e presim në formë shiriti dhe mbështjellim rulo. Pastaj u japim formë hëne dhe i radhisim në tepsinë e lyer me vaj. Pasi brumi vjen pak në tepsinë, i lyejmë pogaçet me të verdhë veze dhe u hedhim sipër susam. Pastaj i pjekim në furrë në temperaturë 200 gradë. Ju bëftë mirë!

Fëmijët KUPTOJNË

— Betyl Balltaxhë —

Sipas studimeve të bëra në fushën e zhvillimit dhe psikologjisë së fëmijëve, fëmija që kur është 4 muajsh është në gjendje që të perceptojë emrin e vet. Ndërsa kur mbush 7 muajsh, ai ka aftësinë për t'i shprehur nevojat e veta me anë të veprimeve. Për shembull, ato i hapin krahët drejt jush kur kanë nevojë që t'i përqafojnë. Kur janë 9 muajsh, ato reagojnë kur ia përmendni emrin, ndërsa gjatë periudhës 12-15 muajsh, ato përdorin pasthirrma të shkurtra për të treguar nevojat që kanë. Ndërsa kur janë 36 muajsh, ato e kuptojnë krejt mirë një fjali si: “Shko në dhomë dhe merr çantën.”

Sado që përpiqemi që ta fshehim, fëmija e percepton gjendjen tonë shpirtërore (gëzimin, hidhërimin, zemërimin etj). Por në të shumtën e kohës nuk i jep dot kuptim. Kjo mund të sjellë konfuzion emocional dhe mungesë besimi.

Diskutimet e bëra në sy të fëmijëve, shkaktojnë sjellje agresive dhe mbyllje në vetvete. Fjalët që të rriturit i thonë njeri-tjetrit perceptohen nga fëmija i cili krijon një analogji me gjendjen emocionale të atij momenti. Përdorimi i fjalëve që poshtërojnë dhe ulin personin tjetër, zë vend të rëndësishëm në kujtesën e fëmijës. Prindi, kur i dëgjon këto fjalë prej fëmijës së vet, habitet shumë dhe reagon. Ndërkohë, kjo është eksperiencë e veçantë për fëmijën, i cili vetëm me një fjalë ka arritur që të tërheq vëmendjen e të rriturve. Fëmijës që i pëlqen ky eksperiment, vazhdon t'i përdorë këto fjalë dhe në të ardhmen ka shumë mundësi që të ndërtojë një të folur të tillë, të ngjashëm. Kur jemi në prani të fëmijës, duhet të bëjmë kujdes që të shmangim fjalët fyese për njerëzit e tjerë; fjalë si: fqinji i shëndoshë, drejtori budalla, shoku acarues... Studime të shumta kanë arritur në përfundimin se fëmijët e moshave 8 deri në 10 vjeç arrijnë që ta kuptojnë të folurën me nënkuptim dhe shprehjet e ekzagjeruara. Pra, le të bëjmë kujdes kur flasim në prani të fëmijëve. Në veçanti, duhet

të evitojmë bisedat me nënkuptim në lidhje me tema si: seksualiteti, dhuna dhe fyerjet.

NËSE FËMIJA IM PËRDOR NJË FJALË TË KEQE, A DUHET T'IA TREGOJ KUPTIMIN E SAJ?

Shpjegimi apo mos shpjegimi i kuptimit të një fjale zhargoni ose fyese, lidhet drejtpërdrejtë me moshën e fëmijës. Nëse i shpjegoni kuptimin e një fjale të ndyrë, fëmijës të moshës 4 vjeçare, ai mund ta kuptojë ose jo. Prandaj, në vend të shpjegimit mund ta paralajmërojmë fëmijën me këto fjalë: “ajo që the është fjalë e keqe, më ka mërzitur, nuk dua që ta përsëritësh.” Në çdo rast prindi duhet të jetë shembull për fëmijën, kjo është e vlefshme edhe në kontrollimin e zemërimit dhe në mënyrën se si debatojnë. Ato duhet të përpiqen që diskutimet e tyre t'i bëjnë në ambiente larg fëmijës, në këtë mënyrë fëmija do të ndikohet më pak. Fëmija i ndan grindjet e prindërve në varësi të forcës së diskutimit. Sikurse kemi grindje të thjeshta në lidhje me punët e përditshme, ashtu kemi edhe grindje të forta që bëhen shkak për mërzë të mëdha. Sipas studimeve, grindja e madhe, për fëmijët, nënkupton katastrofë të vërtetë, sepse ai e shikon si shpërndarje të familjes, botës së tij. Fëmija dridhet nga frika e humbjes së njërës ose të dy prindërve, frikë kjo që shumëfishohet nga zhurma e dymëve që përplasen, fyerjeve që fluturojnë sa nga njëra anë në tjetrën si dhe dhuna fizike që mund të shikohet në disa raste. Fëmija që nuk i jep dot kuptim sjelljes së prindërve të vet që zakonisht janë të dhembshur e të dashur, në mënyrë të pandërgjegjshme, fillon që ta kërkojë fajin tek vetja. Prindërit duhet të bëjnë shumë kujdes që të mos e vënë fëmijën përballë pyetjes së rrezikshme: “Pa më thuaj, cili prej nesh ka të drejtë?!”

Zakonet dhe traditat tona na kanë mësuar që të tregojmë respekt për më të mëdhenjtë, jo vetëm

kur jemi në prani të tyre por edhe kur nuk jemi. Për këtë arsye kujdesi në këtë temë do të forcojë lidhjet familjare. Nëna dhe babai duhet të kenë kujdes që të mos thonë fjalë fyese ndaj prindërve dhe familjarëve të bashkëshortit (vjehtëri, vjehtëra, axha, daja, halla, tezja).

Nga ana tjetër, diskutimet konstruktive janë të dobishme për fëmijën i cili duke i dëgjuar mëson se si t'i shpreh mendimet e veta në mënyrë të kulturuar. Një prej sjelljeve kryesore që fëmija do të mësojë nga prindërit është edhe kultura e të shprehurit. Në këtë mënyrë, fëmija që në moshë të vogël mëson se mund t'i shprehë mendimet pa pasur nevojën për të ngritur zërin.

Si përfundim; fëmijët që në momentin e lindjes, janë shumë më të ndërgjegjshëm se sa ne mund të mendojmë. Për këtë arsye, duhet të bëjmë shumë kujdes sepse ato na shohin neve si të rriturit prej ku duhet të marrin shembull. Ne jemi përgjegjës për karakterin e ardhshëm të fëmijës.

NËSE FËMIJA PËRDOR FJALË ABUZIVE OSE FYESE

Së pari, nuk keni përse të shqetësoheni menjëherë. Fëmija nuk do ta kuptojë dot pse ju reagoni kaq fuqishëm për një fjalë të thjeshtë. Nga ana tjetër, në momentin që përdoret kjo fjalë, mos qeshni në asnjë mënyrë dhe mos e ktheni në temë dëfrimi. Në një rast të tillë fëmija do të mendojë se po bën diçka qesharake që e ndihmon për të fituar vëmendjen e të tjerëve, prandaj do e përsërisë atë. Reagimi më i duhur është ky: “Mbase je zemëruar por ne nuk i përdorim këto fjalë.” Mund të jetë e dobishme edhe t'i flitet fëmijës për impaktin që ka fjala e tij tek të tjerët dhe t'i kujtohet se çfarë do të ndjente ai sikur dikush tjetër t'i thoshte të njëjtën gjë.



Mirë se erdhe E DASHUR BEBE

— Dr. Fatma Bajraktar Karahan —

Lindja e një fëmije vjen së bashku me padurimin, vështirësitë dhe merakun. Ajo është fillimi i një jete të re. Çdo i sapolindur është burim shprese për familjen e vet, por edhe për të gjithë botën. Ai është si një stoli e çmuar. Foshnja është një botë më vete që Allahu e dërgoi në tokë. Pavarësisht duarve e këmbëve të vogla, syve që akoma nuk janë qartësuar dhe gjuhës që nuk ka filluar akoma të kryejë funksionin e të folurit; ai është më i fuqishëm se njerëzit e rritur. Lidhja e tij me Zotin është e re. Mbase për këtë arsye, ai ka aromë xheneti. Dëshmitarët e kësaj mrekullie të krijimit përjetojnë njëkohësisht dy ndjenja të ndryshme që i bëjnë të qajnë e të qeshin në të njëjtën kohë. Teksa ndahen dy zemra që ishin brenda të njëjtit trup, askush nuk mund ta di me siguri, nëse bebja e vogël qan nga dhimbja e mbushjes së mushkërive me ajër apo nga ankthi i ardhjes në këtë botë të vështirë... Teksa lindja e tyre është burim lumturie për të tjerët, vdekja e tyre është një zjarr i tmerrshëm. Ato që vdesin pa lindur, ato që vriten, ato që vdesin akoma pa iu vendosur një emër... Ato kthehen në një dhimbje të turpshme... Ndërkohë që ato do të ishin shpëtimtarët e botës.

EDHE BEKIM EDHE PËRGJEGJËSI

Në shtëpinë ku vjen një fëmijë, vjen lumturia. Në fakt lumturia nuk vjen vetëm. Fëmija që është mysafiri i ri i familjes sjellë me vete përgjegjësi të madhe. Ai është mysafir i veçantë dhe i çmuar, dhe si i tillë meriton parapërgatitje të rëndësishme. Ndryshe prej asaj që mund të mendohet, parapërgatitjet nuk kanë të bëjnë vetëm me dhomat e zbu-kuruara, rrobat dhe gostitjet. Përgatitja më e mirë

është një botë më e bukur, me më pak gënjeshtër, zili e negativitet. Po, shtëpia parapërgatitet për fëmijën, po bota si të mos e bëjë të njëjtën gjë? Në këtë mënyrë bebja kthehet në përgjegjësi dhe sprovë të vërtetë. Specialisti i Qendrës Fetare Dr. Ylfet Gërkyly na kujton ajetin Kuranor: **“Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju. Allahu ka shpërblim të madh.”** (Tegabun, 15) dhe shton se fëmijët, stolia e botës dhe drita e syve tonë, në të njëjtën kohë janë bekim i paçmuar dhe sprovë për ne. Çdo fëmijë duhet pranuar si një dhuratë e vyer që na ka bërë Zoti, por nga ana tjetër nuk duhet të harrojmë se, e drejta e fëmijës ndaj prindit është të edukohet në mënyrën si na e ka këshilluar Krijuesi ynë.

Nëse kujtojmë hadithin e Pejgamberit tonë: **“Fëmija ka të drejtën e vet tek prindi.”** (Muslim, Sijam, 183) kuptojmë se detyra e prindërve fillon shumë para lindjes së fëmijës. Në fund të fundit çdo gjë që prindi ha, pi, shikon dhe flet do të ndikojë tek fëmijët që do të vijnë në jetë. Ndikimi është më i fortë veçanërisht kur fëmija është në barkun e nënës. Në krijimin e çdo organi të ri shtohet ndikimi. Për shembull, kur fëmijës i krijohen veshët, prindërit duhet të bëjnë shumë kujdes me fjalët që thonë. Fëmija nuk ka përse të dëgjojë grindje, sharje e fjalë të këqija akoma pa ardhur në këtë botë. Asnjë prind nuk ka të drejtë që ta helmojë gjakun e fëmijës me zakone të këqija dhe as t'i ndot qelizat e pastra me gjëra të papastra.

Dr. Ylfet Gërkyly thotë se prindërit duhet të ndjehen falënderues që në momentin kur mësojnë se do të bëhen me fëmijë dhe duhet të gëzohen

pavarësisht gjinisë së fëmijës. Mos të harrojmë se Kurani Kerim na këshillon që të gëzohemi për lajmin e ardhjes në jetë të fëmijës, pa dallim gjinie. (Nahl, 58-59). Sigurisht që falënderimi për një bekim kaq të madh nuk mund të mbetet me kaq. Fëmijës duhet t'i vendosim një emër të bukur duke marrë parasysh që me të do të thirret në Ahiret. (Ebu Davud, Edeb, 61), Nëse është e mundur bëhet një kurban (Tirmidhiu, Edeb, 63, Edahi, 19) në shenjë falënderimi. Vendosja e emrit është një edukim më vete. Pejgamberi (a.s.), i lexonte në veshin e djathtë të të sapolindurit ezanin ndërsa në të majtin i lexonte ikametin dhe më pas i vendoste emrin. Në këtë mënyrë, fëmija i sapolindur në kontaktin e parë me botën e jashtme, njihet me emrin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij...

POZITA SI NËNË E SI BABA

Kjo krijesë e vogëlth, ka nevojë për kujdes dhe shërbim, por në të njëjtën kohë ajo ka edhe fuqi të madhe ndryshimi. Ajo ka aftësinë që një grua ta bëjë nënë dhe një burrë ta bëjë baba. Me qenien e tij, ai bën një njeri gjysh e një tjetër gjyshe. Ai ndryshon një shtëpi të tërë. Ky ndryshim nuk vjen vetëm me lumturi e gëzim, por edhe me shqetësimet e lodhjet e veta. Ky ndryshim ndikon tek jeta e përditshme. Mysafiri i vogël ka ndikim edhe tek marrëdhëniet mes familjarëve. Për shembull, nëse në familje është edhe një fëmijë tjetër, ai bëhet motër e madhe ose vëlla i madh. Interesi i familjes dhe dashuria e familjarëve ndryshon, sepse qendra e të gjitha këtyre bëhet fëmija i vogël, por duhet bërë shumë kujdes që kjo dashuri e madhe të jetë e kontrolluar në mënyrë që të mos prishen ekuilibrat e familjes. Ja se çfarë mendon Psikoterapisti Dr. Timur Harzadin në lidhje me mënyrën se si duhet të sillemi me fëmijët e tjerë më të mëdhenj: "Prindërit duhet t'i përgatisin fëmijët e mëdhenj për ndryshimet që do të sjellë foshnja e sapolindur. Mos të harrojmë se është krejt normale që fëmijët e mëdhenj të ndjehen xhelozë për pak kohë. Në një situatë të tillë duhet bërë kujdes që të mos e gjykojmë ose ta ngacmojmë fëmijën. Në një kohë që dihet se fëmijët e vegjël nuk i shprehin dot qartë ndjenjat e tyre. Për këtë arsye mund të bëjnë prapësira si lagia e rrobave e gjëra të ngjashme. Zakonisht këto probleme nuk zgjasin shumë. Parapërgatitjet e prindërve e lehtësojnë mjaft këtë periudhë. Prindërit duhet të jenë shumë të kujdesshëm që të mos lënë pas dore fëmijët e tjerë. Disa prej aktiviteteve që mund të zhvillohen janë edhe leximi i librave, zhvillimi i lojërave dhe bërja e pazarit. Nëse bebjë kalon kohë si me babain ashtu edhe me vëllain (motrën) e vet,

ai arrin të krijojë njohje shpirtërore. Sigurisht që një gjë e tillë do të jetë e mirë për të tria palët." Specialisti Dr. Harzadin tregon se ardhja në jetë e një fëmije të vogël, bën që disa prej nevojave të pjesëtarëve të tjerë të familjes të mos plotësohen dot. Në disa raste, vështirësitë që sjell pjesëtari i ri i familjes bëhen shkak për grindje në mes çiftit, por një gjë e tillë e bën të voglin të ndihet keq. Shumë familje arrijnë që t'i kapërcejnë këto probleme në mënyrë natyrale.

Sigurisht që do të duhet kohë për të caktuar role të reja dhe për të ndarë detyrat, por kalimi është i suksesshëm vetëm nëse bëhet me mirëkuptim, dashuri dhe kujdes.

Nuk ka dyshim se ardhja në jetë e një fëmije, mbi të gjitha lodhë nënën. Shtatzanisë dhe lindjes i shtohen edhe përgjegjësi të reja, pa bërë asnjë pushim. Sipas Islamit, gjatë asaj që quhet periudha e lehonës, si fëmija ashtu dhe nëna kanë nevojë për kujdes të veçantë. Sipas Dr. Ylfet Gërgyly: "Në bazë të tipareve fizike dhe kushteve të ambientit mund të ketë variacione, por lehonja –në literaturën Islame quhet nifas- e gruas zgjat afërsisht 40 ditë. Gjatë kësaj kohe, gruaja nga njëra anë ka gjakderdhje ndërsa nga ana tjetër punon gjatë gjithë kohës për të plotësuar nevojat materiale e shpirtërore të pjesëtarit më të ri të familjes. Ajo përpiqet vazhdimisht që ta përballojë me sukses këtë tempo kaq të lartë. Mos të harrojmë se e ndodhur në një periudhë kaq delikate, gruaja ka nevojë për ndihmën e bashkëshortit dhe të gjithë të afërmve të tjerë prandaj duhet të përpiqemi shumë që t'ia lehtësojmë peshën e madhe që ka mbi supe." Psikoterapisti Dr. Harzadin e shpreh rëndësinë e rolit të burrit në këtë mënyrë: "Pjesëtarët e tjerë të familjes duhet t'i vijnë në ndihmë nënës. Këshillohet që babai të ketë një rol aktiv në mënyrë që kjo periudhë të kalojë pa probleme. Nëse burri krijon afërsi me beben dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, gruaja do ta ketë më të lehtë kapërcimin e kësaj periudhe."

Nëse gruaja dhe burri i marrin përsipër përgjegjësitë e tyre që para se fëmija t'i hap sytë në këtë botë, ato do të fitojnë pozitën e të qenit prind. Nëse arrijnë t'i kryejnë detyrat e tyre me drejtësi, kënaqësia e tyre do të bëhet shkak që fëmijët të futen në Xhenet. Le të kujtojmë fjalët e Resullullahut: "*Nëna dhe babai janë shkaqe për hapjen e dyerve të Xhenetit...*" (Tirmidhiu, Birr, 3) Bebjë që i jep poste kaq të larta gruas dhe burrit, është një bekim dhe amanet i rëndësishëm. Për këtë arsye, çdo lindje është një lajm i mirë dhe ngjarje që meriton falënderim të sinqertë.

Sallata me Fruta



Sallata me fruta është alternativa më e përshtatshme për të përmbyllur siç duhet një vakt të mirë e të bollshëm.

Sallata me fruta përgatitet lehtë, është freskuese në shije dhe sjell shumë kënaqësi për shqisat.

Por sallata me fruta nuk është diçka që mund ta përgatisësh symbyllur.

Ajo që duhet të dini është se jo të gjitha frutat përshtaten mirë me njëra tjetrën.

Një sallatë e mirë frutash kërkon fantazi, por duke njohur vlerat dhe kundërvlerat e frutave.

Principet bazë të një sallate frutash të shijshme por mbi të gjitha të shëndetshme janë:

MOS BASHKO FRUTAT ME ACIDITET TË LARTË ME TË ËMBLAT.

Frutat me aciditet të lartë si qitro, portokalli ose agrume të tjera, ananasi, shega, molla e thartë, kumbulla dhe luleshtrydhet nuk duhen kombinuar me frutat e ëmbla si rrushi, banania, hurma, fiku e kumbullat e thata.

KUJDES ME ACIDITETIN

Agrumet si qitro janë të vështira për stomakun.

Në këtë rast, ato mund t'i kombinoni me boronicat.

Mollët e ëmbla, kajsitë, qershitë, mangoja, nektarina, dardha dhe frutat e pyllit janë neutrale mund të kombinohen si me frutat me aciditet të lartë ashtu edhe me të ëmblat.

PJEPRI DUHET KONSUMUAR VEÇMAS

Nuk dihet akoma zanafilla e përfshirjes së pjeprit nëpër sallata frutash, por është diçka e gabuar.

Pjepri dhe shalqiri kanë përmbajtje të lartë ujore ndaj treten më shpejtë se frutat e tjerë.

HIQNI DORË NGA SALLATA STANDARDE E FRUTAVE

Një sallatë tipike me pjepër, mollë, ananas, banana dhe luleshtrydhe ngadalëson tretjen.

Hiqni dorë prej saj dhe më mirë konsumoni boronica dhe mjedër.



Në verë, nëse preferoni të hani fruta, përqendrohuni tek shalqiri që ul temperaturën e frutave.

Mango është një zgjedhje tjetër ideale sepse është i pasur me vitamina dhe antioksidantë.

KOS DHE MJALTË

Nëse dëshironi mënyra të shëndetshme për të pasuruar sallatën me fruta zgjidhni kosin, mjaltin ose lëngjet e frutave.

MOS PËRZIENI FRUTA ME PERIME

Frutat dhe perimet treten në ritme të ndryshme.

Frutat treten më shpejt, madje në momentin që mbërrijnë në stomak janë pjesërisht të tretura.

Frutat përmbajnë më shumë sheqer, gjë që mund të pengojë tretjen e perimeve.

Për të njëjtën arsye portokalli me karotën nuk duhen përzier bashkë sepse shkaktojnë urth.

MOS PËRZIENI PROTEINËN ME NISESHTE.

Bananet nuk duhen përzier me patatet ose bizelet, rrushi i thatë me spinaqin e të tjerë sepse tretja ndryshon sipas kategorive.

Për tretjen e proteinave, nevojitet një bazë aciditeti, ndërsa për niseshtenë nevojitet alkalina.

KUR FRUTI TË VJEN NË NDIHMË.

Nëse e keni tepruar me kripën, të nesërmen konsumoni një frut me përmbajtje të lartë ujore siç është shalqiri për të nxjerrë jashtë kripën.

Nëse keni ngrënë shumë makarona, të nesërmen hani mollë.

MUNGESA E MAGNEZIT NË ORNGANIZËM

Magnezi luan një rol thelbësor për sistemin imunitar, nervat, muskujt, zemrën dhe kockat. Ai është i përfshirë në më shumë se 300 reagimet biokimike të trupit.

Mungesa e magnezit ndikon fort në veshkjen e çdo organizmi të gjallë dhe vlen për bimët dhe sidomos për njerëzit.

Për këtë arsye, duhet të mësoni më shumë për mungesën e magnezit, simptomat, shkaktarët dhe faktorët e rrezikut.

MUNGESA E MAGNEZIT DHE SHENJAT QË JEP ORGANIZMI

Ndonëse shumë njerëz nuk marrin sasi të nevojshme të magnezit nëpërmjet ushqimit, pamjaftueshmëria e mirëfilltë e këtij minerali është e rrallë.

Kjo vjen falë veshkave, të cilat mbajnë nën kontroll sasinë e kësaj kripe minerale që shkarkohet nëpërmjet urinës.

Ndaj nëse ndiheni të shëndetshëm, me siguri nuk jeni të prekur nga pamjaftueshmëria e magnezit.

Por nga ana tjetër, disa probleme shëndetësore, pirja e tepruar e alkolit, disa medikamente dhe një regjim jo i shëndetshëm ushqimor e bëjnë mungesën e magnezit të pashmangshme.

Ajo që shumë prej njerëzve përjetojnë në rastin e këtij minerali quhet si Sindroma e Nivelit të Përshtatshëm të Magnezit.

SHENJAT QË JEP ORGANIZMI KUR MUNGON MAGNEZI JANË SHUMË TË RËNDËSISHME

Nëse keni dhimbje dhe shtrëngime muskujsh, mërzi të vazhdueshme, energji të dobët dhe prob-

leme me gjumin, duhet të kryeni analizat për të kontrolluar nivelin e magnezit në trup.

RREZIKU NGA SASITË E PAKTA TË MAGNEZIT

Njerëzit që vuajnë nga diarea ose problemet me tretjen janë më të rrezikuar nga nivelet e ulëta të magnezit.

Njerëzit e prekur nga diabeti i tipit 2 kanë sasi më të ulëta të magnezit për shkak të urinimit të shpeshtë.

Të moshuarit kanë më pak magnez në organizëm se të rinjtë, sepse ata kanë më shumë gjasa të vuajnë nga sëmundjet kronike.

Për më tepër, medikamentet që ato konsumojnë ulin nivelet e magnezit, por nga ana tjetër, moshja ngadalëson përthithjen e magnezit në stomak.

Pamjaftueshmëria ndaj magnezit vërehet kryesisht tek ata që abuzojnë me alkolin.

BURIMET USHQIMORE TË MAGNEZIT

Rekomandot të ushqyerit me ushqime të pasura me magnez.

Gratë e moshave 19 deri në 30 vjeç kanë nevojë për 310 mg magnez në ditë.

Gratë e moshave mbi 30 vjeç kanë nevojë për më shumë.

Të gjitha barishtet e gjelbra, farat dhe arrorët janë burimet më të pasura me magnez.

Zgjidhni bajamet, arrat, farat e susamit, kungullit dhe linit janë ideale. Ushqime të pasura me magnez janë edhe fasulet e zeza dhe bananet.

PËRPLASJE YJESH QË DO TË SHIHET NGA BOTA NË 2022

Në univers, veçanërisht në galaktikën tonë, ka një numër të madh sistemesh me shumë yje ku dy ose më shumë yje rrotullohen përreth njëri-tjetrit. Në shumë nga këto sisteme, yjet përplasen me njëri-tjetrin. Një dukuri që ka qenë e njohur për astronomët për një kohë të gjatë. Por shkencëtarët thonë se një përplasje që ka ndodhur pothuajse dy mijë vjet më parë, do të mund të shihet së shpejti me sy të lirë.

Para 1 mijë e 800 vjetësh, në shekullin e tretë, Perandoria Han e Kinës ishte e ndarë në tre mbretëri, qytetërimi Maja kishte hyrë në periudhën klasike, Roma ishte në një gjendje anarkie ushtarake dhe në botë mbizotëronte paganizmi. Në këtë kohë, një shpërthim i fuqishëm ndodhi në qiell, dy yje u përplasën me njëri tjetrin në plejadën e Cygnusit.

Por askush nuk mundi ta shihte një gjë të tillë. Shpërthimi ndodhi 1 mijë e 800 vjet vite drite larg, që do të thotë se ndriçimi që u përftua nga ajo përplasje yjesh, do të arrijë tek ne 1 mijë e 800 vjet më vonë.

Kjo do të ndodhë në vitin 2022, sipas përlogaritjeve të një grupi shkencëtarësh dhe studentësh në Kolegjin Calvin në shtetin e Miçiganit. Astronomi Larry Molnar, që kryesoi grupin parashikon se shkëlqimi i shpërthimit do të jetë një nga objektet më ndriçuese në qiellin e natës, për një kohë të gjatë.

Dy yjet janë aq pranë njëri-tjetrit saqë sikur prekin njëri-tjetrin”, distanca mes yjeve është e barabartë me 1.5 e diametrit të tyre dhe atyre u duhen vetëm 11 orë që të shkojnë përreth njëri-tjetrit. Ato mund ta bëjnë këtë në mënyrë të qëndrueshme për miliona vjet, por në rastin e këtij ylli, rezultoi se periudha orbitale po shkurtrohej gjithnjë e më shumë dhe ritmi po përshpejtohej. Përplasia do të çlirojë një energji të jashtëzakonshme dhe një yll i ri do të lindë. Kështu krijohen yjet e rinj dhe shtresa përreth tij shpërthen, çlirohet dhe kthehet në mjegullnajë, që shkëlqen për një kohë shumë të shkurtër, por pas një fare kohe përhapet, bëhet transparente dhe e humb shkëlqimin dhe ajo që mbetet për t'u parë në brendësi është si një bërthamë gjigante.

DËGJOHEN SINJALE NGA LARGËSITË E UNIVERSIT

Shpërthimet e shpejta të valëve të radios u zbuluan për herë të parë në vitin 2007, dhe që atëherë ato janë regjistruar 18 herë, por vetëm një nga këto sinjale përsëritet disa herë.

Pas sinjalit të parë të zbuluar nga teleskopi Parker në Australi, shkencëtarët analizuan një sinjal të përsëritur për të zbuluar origjinën e tij.

Ekspozimet janë jashtëzakonisht të forta edhe pse ato zgjasin shumë shkurtër, midis 30 mikrosekonda dhe 9 milisekonda, dhe lëshojnë një sasi mjaft të madhe energjie, ekuivalente me atë që dielli ynë liron në një ditë.

Si burim i tyre, vitin e kaluar u detektua një galaktikë xhuxhe në largësi prej tre miliardë vit drite, dhe shkencëtarët tani kanë zbuluar disa nga kushtet e

pazakonta në të cilat krijohen këto shpërthime.

Shpërthimet janë shumë të polarizuara dhe vijnë nga një mjedis që përmban një fushë shumë të fortë magnetike. u zbuluan sinjale me një frekuencë më të lartë deri tani. Kur valët e radios kalojnë nëpër fushën magnetike, ato vijnë në rotacionin e tyre, një fenomen i njohur si efekti Faradej ose rotacioni. Rrotullimi është më i fortë se fusha magnetike, por këto janë shpërthimet më të forta që janë matur ndonjëherë. Kjo tregon se sinjalet vijnë nga afërsia e ndonjë vrime masive të zezë ose nga mjegullnajat e fuqishme, mjegullnajat ndëryjore apo retë mbushura me hidrogjen, helium dhe gazra të tjerë jonizues në të cilën yjet janë lindur, thuhet në studimin e publikuar në revistën Nature.

ÇFARË PO NDODH ME VRIMËN GJIGANTE NË SHTRËSËN E OZONIT?

Vrima gjigante në shtresën e ozonit të Tokës nuk do të mbyllet plotësisht për më shumë se gjysmë shekulli, por shkencëtarët e NASA-s kanë dëshmi se vrima po zvogëlohet.

Në fillim të viteve 1980, shkencëtarët zbuluan se spërkatjet për flokë, gjërat e ftohta dhe kimikatet e tjera lirojnë substanca që mund të dëmtojnë dhe në fund të shkatërrojnë ozonin.

Në fakt, klorofluorokarbonet (CFC) në fund të rrugës së tyre takohen me molekulat e ozonit, dhe rrezatimi diellor liron gazin e klorit nga CFC. Nën ndikimin e klorit, molekulat e ozonit treten, dhe prej tyre krijohen molekulat e zakonshme të oksigjenit. Në këtë mënyrë shkatërrohet shtresa e ozonit.

Duke përdorur të dhënat satelitore nga viti 2005

– 2016, shkencëtarët e NASA-s kanë përcaktuar se nivelet e klorit në shtresën e ozonit janë ulur me pothuajse 1 për qind çdo vit.

Kjo është hera e parë që shkencëtarët kanë qenë në gjendje të matin përbërjen kimike brenda vrimës së ozonit dhe të vëzhgojnë zvogëlimin e saj. Ky është një lajm i mirë për njerëzimin, por shkencëtarët theksojnë se është e nevojshme të kalojë dekada që vrima e ozonit të zhduket plotësisht.

“Klorofluorokarbonet (CFC) mund të jetojnë 50 deri në 100 vjet dhe të qëndrojnë më gjatë në atmosferë. Prandaj, kur flasim për vrimën e ozonit, ajo do të zvogëlohet deri në vitin 2080, dhe atëherë do të bëhet një vrimë e vogël,” tha Ann Douglas, shkencëtar dhe bashkautor i studimit.

SISTEMI DIELLOR PO ZGJEROHET

Dielli po e zvogëlon tërheqjen mbi planetet, orbitat e të cilëve po zgjerohen gjithnjë e më shumë, njësoj sikur sistemi diellor të ishte duke u fryrë, sipas një studimi të publikuar në revistën “Nature Communications” dhe i koordinuar nga Antonio Genova që punon për qendrën e NASA-s, “Goddard Space Flight Center” dhe Institutin e Teknologjisë të Masaçusetsit (MIT) në Boston.

“Që orbitat e planeleve po largohen nga Dielli dhe, por tani ky fenomen është matur në detaj, falë të dhënave të mbledhura në shtatë vite në planetin Merkuri nga misioni ‘Messenger’ i NASA-s, të dhënat

tregojnë se çdo vit Merkuri largohet nga Dielli me rreth 0,5-1 centimetër ndërsa Toka me 1,5 centimetra”, thotë Antonio Genova.

“Megjithatë ky fenomen nuk duhet të shqetësojë, nuk ekziston rreziku që lidhja me Diellin të shpëputet. Bëhet fjalë për një efekt të vogël, por i rëndësishëm për të kuptuar se si sistemi diellor ka evoluar dhe vazhdon të evoluojë”, vazhdoi Genova.

Sipas përfundimeve të këtij kërkimi NASA ka treguar se arsyeja e largimit vjen për shkak se Dielli po humbet masë.



Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive


4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Në të vërtetë,
besimtarët
janë vëllezër...”

(Huxhurat, 10)

ISSN 2227-3611



9 772227 361004

0 1